


E MIRA DHE E KEQJA

MUHAMMED MUTEVELI SHARAVIU



Muhammed Mutevel-li el Sharavi

E mira dhe e keqja

“Zëri Ynë”
Prishtinë, maj 2005

Titulli i origjinalit
الخير و الشر
El-Hajr ve Sherr

Përktheu dhe përshtati
Muhammed Jusufi

Recensent:
Ajni Sinani

Copyright © “ Zëri Ynë”

Hyrja e Autorit

Në emër të All-llahut Mëshiruesit të Përgjithshëm, Mëshirëplotit

Pas madhërimit të All-llahut xh.sh., i dërgojmë salavate dhe përshëndetje më të mirit të të gjitha krijesave, zotëriut tonë, të dërguarit të All-llahut, Muhammedit s.a.v.s.

Lus All-llahun që këto libra t'a pasurojnë, rrisin, dhe lartësojnë kur'anotekën tonë, të bëhen ndriçuese të rrugës së udhëzimit dhe nur në zemrën e njerëzve, drejt dritës së imanit.

Dhashtë All-llahu i Madhërishëm, që të vemi drejt suksesit në këtë botë dhe shpëtimit në jetën e pasosur.

Muhamed Mutevel-li esh Sharavi

Kapitulli i parë

E bukura në univers

E mira dhe e keqja janë dy prej temave më të debatuar, të cilat kanë shkaktuar polemika të shumta. Shkaku kryesor i këtyre polemikave është mosnjohja e saktë e qëllimit të jetës së qenies njerëzore. Shumica dërmuese e dijetarëve, duke përjashtuar një numër të vogël, kanë përcaktuar se kjo jetë (e kësaj bote), të cilën është duke jetuar njerëzimi, është qëllimi final. Shkaku i stërlodhjeve është ky vizion i gabuar, pasi njerëzimi është duke pasuar herë një ideologji, e herë një tjetër. Ata që e perceptojnë jetën e kësaj bote, si qëllimin e tyre të vetëm, do t'a kalojnë jetën e tyre me shumë peripeci të ndryshme. Këto

vështirësi, atyre u vijnë nga All-llahu i Lartësuar dhe, së fundi, ata nuk do të fitojnë asgjë në ahiret (botën tjetër).

Pabesimtari nuk pretendon ndonjë kënaqësi tjetër, ai nuk disponon ndonjë alternativë tjetër, për të, me këtë jetë merr fund gjithçka. Ky është rezultati përfundimtar i tij, pasi ai nuk beson në ekzistencën e ahiretit, pra nuk beson se ka jetë të përherëshme ose të amshueshme. Këtij personi, pasionet, ambiciet dhe veprat e jetës i përfundojnë në këtë botë. Por, sikur t'a përdorte vetëm pak logjikën, ai do t'a kishte kuptuar se kjo botë nuk i takon vetëm qenies njerëzore. A thua pse? Sepse jetën, të cilën po e jetojmë ne tani, ose të cilën ai e jeton, e ka përpiluar mbi teori jo të sakta dhe supozime të ndryshme. Duket qartë, se ato i ka bazuar në trillime jobindëse. Ai pra, fatkeqësisht, jetën e ka mbështetur në supozime dhe iluzione. Shpresat e njeriut për të jetuar dhe shijuar këtë botë, shkojnë deri në moshën gjashtëdhjetë-shtatëdhjetë vjeçare, ose pak edhe më tepër. Por, ç'është e vërteta, kemi disa prej qenieve njerëzore, që vdesin në këtë botë menjëherë. Kemi prej tyre që vdesin pas një ore, ose pas një dite. Kemi prej tyre që vdesin pas një jave ose pas disa muajve, gjithashtu, kemi edhe prej tyre që vdesin në kohën e adoleshencës, e kështu me radhë, prej atyre që ndërrojnë jetë në mosha të ndryshme...

Shumica e njerëzve, në të shumtën e rasteve, shpresojnë të jetojnë disa dekada. Por, kjo logjikë apo formë e të menduarit, nuk do të duhej të ishte vizioni i tij përfundimtar, sepse atij mund t'i vijë vdekja në çdo moment, siç e theksuam më sipër. Askush nuk mund t'a sigurojë atë, ose t'a njoftojë për ditët ose vitet e mbetura të jetës së tij.

Njeriu, vetëm në ahiret, do të mund t'a njohë bindshëm veten e tij, sepse ai, atje, është i përjetshëm – nuk vdes. Atij, që ishte i mirë në këtë botë, nuk do t'i humbasë e mira e tij, ndërsa atij, që ishte keqbërës, nuk do të anashkalohej dhe t'i harrohet keqbërësia e tij.

Çdo gjykim do të konsiderohej jo i plotë, nëse njeriu nuk e merr parasysh edhe gjykimin në ahiret. Vetëm atëherë, kur ne ta kemi vendosur jetën mbi këto binarë, mund të themi se kemi bërë një gjykim të drejtë dhe të vërtetë.

Por ç'ti bëjmë injorancës sonë, kur ne, në të shumtën e rasteve, jetën e sendërtojmë vetëm mbi binarët e kësaj bote dhe, mbi këtë bazë, sjellim ligje dhe rregulla për të bukurën dhe të shëmtuarën. Shikuar nga ky prizëm, kuptohet se gjykimet tona ngrihen mbi qëllimin, e jo mbi mjetin. Kur dikush na i shpaguej mundin në këtë botë, ne këtë e konsiderojmë si një gjë të mirë, ose kur dikush na sjell zemërim, ose na ndalon prej ndonjë veprimi që ne duam t'a bëjmë, ne këtë e konsiderojmë si një gjë të keqe. Përderisa, kjo është doktrina e të menduarit tonë, dhe përderisa jetojmë mbi këtë bazë të gabueshme, atëherë do të vuajmë, sepse jemi duke iu larguar vazhdimisht programit të All-llahut.

Njerëzit, të mirën dhe të keqen, i shpjegojnë sipas njohurive të tyre individuale. Kur diçka i konvenon njeriut, ai do t'a konsiderojë atë si të mirë. Ky gjykim rezulton prej atyre, që për bazë kanë doktrinën e sipërtheksuar. E mira dhe e keqja, e bukura dhe e shëmtuara, nuk përcaktohen mbi bazën e të menduarit individual. Kjo bazë e të menduarit do të kishte standarte jo të plota, sepse kemi të bëjmë me egoizmin njerëzor. Nuk do të dihet kurrë, cila është e mirë dhe cila është e keqe, mbi këtë bazë të të menduarit.

Kur ngjan ndonjë ndodhi, nëse ne do t'a gjykonim sipas standarteve të të menduarit individual, do të konstatojmë se ajo ndodhi, për dikënd do të jetë e mirë, e për dikënd tjetër jo. Të sjellim një shembull për këtë: nëse një ministri ose ministër, ndërrohet si rezultat i ndryshimeve elektorale, kjo do të sillte gëzim për njërin grup, e pikëllim për grupin tjetër. Ky ndërrim, për të gjithë ata që do të dalin nga ajo ministri, do të konsiderohet si një vepër e padrejtë, ndërsa për të rinjtë, që do të hyjnë në të, do të konsiderohet si fitore ndaj të keqes. Këtyre të fundit u vijnë edhe telegrame urimi për suksese në të ardhmen. Për të gjitha institucionet ose dikasteret, të cilët janë të atij mendimi (grupimi), kjo ditë do të ishte ditë festive. Me një fjalë, këta mendojnë se kanë bërë një veprim të mirë. Shikuar nga prizmi individual, e mira dhe e keqja do të kuptohet në mënyrë relative, pra një veprim, që për disa konsiderohet si i drejtë -i bukur, për disa të tjerë do të konsiderohet si i padrejtë -i shëmtuar.

Na takon të pyesim: si është e mundur, që një veprim të jetë, në të njëjtën kohë, edhe e mirë, edhe e keqe? Si është e mundur, që një vepër t'a përmbajë të mirën dhe të keqen njëkohësisht!?

Si duket kemi të bëjmë me norma dhe standarte të ngatërruara, sepse kjo nuk jep përgjigjen e vërtetë. Sikur standartet të mos ishin të ngatërruara, nuk do të kishim këtë antagonizëm apo përplasje mendimesh. Por, kur ne jetojmë me këso standarte të ngatërruara, gjithmonë do të hasim në rezultate antagoniste. Kjo është një gjë e vërtetë në jetën tonë, prandaj duhet të kemi shumë kujdes dhe të jemi vigjilent. Të jemi të qartë, ne këtu po trajtojmë të bukurën dhe të shëmtuarën.

Standartet e të menduarit individual, nuk do të duhej të ishin përcaktuese të këtyre gjytimeve. Këtu duhet të kemi disa norma dhe standarte të tjera, krejtësisht të kundërta me këto të tanishmet, që janë të vendosura nga i Gjithëlartësuari, për këtë univers. Vetëm ato do t'i gjykojnë ngjarjet saktë, sepse na japin një kuptim plotë dhe të vërtetë.

Këto standarte, ne, nuk kemi mundësi t'i njohim me anë të të kuptuarit tonë individual, sepse jemi të kufizuar. Për ne, shumë gjëra janë të panjohura, prandaj duke u bazuar në këtë mangësi, ne, duhet t'a themi të fundit fjalën, e të mos ndërhyjmë në gjykimet e të bukurës dhe të shëmtuarës në këtë botë, sepse ne do të gjykonim vetëm për përmbajtjen sipërfaqësore të ngjarjes, do të gjykonim vetëm atë, që e kemi prezent para nesh, duke mos e ditur realitetin përfundimtar. Nëse gjykimet e tilla, të bazuara mbi këto standarte, do të njiheshin si vendime përfundimtare, atëherë them se ato do të ishin vendime jo të plota dhe larg realitetit dhe të vërtetës!

Njohja e universit është e pamundur, por ne do të fillojmë me nxjerrjen e disa konkludimeve për rëndësinë e rolit të njeriut në të, sepse ai është pjesë përbërëse e këtij universi. Prej këtyre konstatimeve, do të shohim se All-llahu i Lartësuar, paska krijuar peshore shumë precize, për ekzistencën e jetës në univers. Kjo peshore, është ajo e cila sundon çdo gjë. Prej krijesave të para, që krijoi All-llahu xh.sh., është peshorja për të bukurën në univers. Edhe e bukura është pjesë përbërëse, e cila kryen detyrën e vet në

këtë univers. Gjithashtu, janë ligjet e universit ato, që e obligojnë njeriun që të mos u shmanget detyrimeve të tij.

Nëse njeriu nuk do t'i përfillë këto ligje, dhe do të vazhdojë t'i injorojë ato, ai fillon e bëhet pengesë e tyre. Kështu, ne nuk do t'a shijojmë kurrë të bukurën. Jeta sipas këtyre standarteve, fatkeqësisht, do të sjellë vuajtje dhe zemërimë. Ndërsa e bukura do të vazhdojë të jetë prezente dhe gjithmonë në pritje, në të gjitha lëvizjet e zhvillimeve të jetës.

7

Në fillim ishte natyrshmëria

Le të fillojmë të startojmë me fillimin e jetës, në çastin kur foshnja lind. Së pari, në momentin kur fëmija lind, ai është musliman nga vetë natyrshmëria e tij (i shpëtuar). I Dërguari All-llahut s.a.v.s., thotë:

“Çdo foshnje lind në natyrshmërinë e muslimanit, ndërsa prindërit e tij e bëjnë atë të krishterë, hebren apo zjarrputist”.

Secila foshnje që vjen në këtë botë, vjen duke qenë me natyrshmëri të rregullt, në fenë e vërtetë të All-llahut. Pastaj, ndodhin ngatërresa midis njerëzve, pra, prej individëve, familjeve, ose simpatizuesve, që e kanë transformuar fenë e natyrshmërisë së tyre - të cilën ua dhuroi All-llahu i Lartëmadhëruar, - në atë, që ata tanimë besojnë. Ky është një argument, për të bukurën e All-llahut në universin e Tij; që prej fillimit të jetës, për secilin të posalindur. Çdo krijesë lind me natyrë islame (të bukur), por pastaj njeriu transformohet dhe e prish të bukurën, dhe kjo konsiderohet të jetë një argument tjetër, në të njëjtën kohë.

Çdo fëmijë konsiderohet i pafajshëm, derisa jeton jetën e tij fëminore. Ai, atë duhet t'a shijojë, si dhuratë prej All-llahut xh.sh. Ai nuk di të gënjejë, nuk di të bëhet hipokrit, nuk di të vjedhë, dhe nuk di asgjë prej veprave të këqija të kësaj bote. Por këtë rrugë të keqe, ia mësojnë prindërit e tij, pasi ai, vërtet, është krijuar në natyrshmërinë e të bukurës. Lindet gojë ëmbël, i singertë, i pafajshëm dhe i pastër. Nuk kemi dëgjuar që një fëmijë të ketë lindur gënjeshtar nga natyra tij, po ashtu, nuk kemi dëgjuar që të ketë lindur hajdut nga natyrshmëria e tij, gjithashtu, nuk kemi dëgjuar të ketë lindur hipokrit nga natyra tij. Të gjitha këto të shëmtuara dhe mëkate, atij ia mësojnë prindërit e tij, të afërmit ose rrethi i tij, ku ai jeton. Pra, sikur po vërejmë, zanafilla e krijimit në univers, buron me të bukurën, ndërsa burimin e të shëmtuarës në univers, e gjejmë në ndërhyrjen e njeriut.

Dalëngadalë, shohim se foshnja rritet dhe, më vonë, fillon të shkojë edhe në shkollë. Kemi shumë raste kur prindërit nuk e mësojnë atë se puna është baza e suksesit, prandaj për të korrur sukses ai duhet të mësojë. Ata (prindërit) u “ndihmojnë” fëmijëve të tyre për t'a kaluar vitin shkollor pa mësuar. Ata intervenojnë tek mësuesit e tyre, duke i marrë paraprakisht testet e provimeve prej mësuesve të tyre. Ndodh që ata pyetjet t'ua marrin mësueseve përmes mësimëve plotësuese (me anë të kurseve), përmes korrupsionit ose privilegjeve të ndryshme. Kjo ndërhyrje e njollos të bukurën në univers. Si dhe pse? Për

arsye se, prindi shpreson se fëmija i tij (në këtë rast nxënësi) një ditë do të mësojë më mirë, prandaj e “ndihmon” t’a kalojë vitin shkollor pa mësuar. Vërtet mendoni se ai fëmijë, një ditë, do të mësojë!? Sigurisht që jo. Përderisa ai mund t’a kalojë vitin pa dhënë mund, atëherë, përse të mësojë e të lodhet!?

Ne jemi dëshmitarë, që disa prej mësuesve i shesin provimet, ose iu japin pyetjet, atyre nxënësve që vazhdojnë kursin tek ata, ose në forma të ndryshme. Ky veprim, i këtij mësuesi, e njollos apo e ndyn harmoninë e së bukurës në univers. Ai bëhet shkaktar që disa nxënës të “korrin” sukses pa mësuar. Ky veprim ndikon dhe lë pasoja të tjera të mëvonshme. Rezultati përfundimtar i gjithë kësaj do të jetë se, nxënësi do të dalë prej asaj shkolle i paditur dhe fare injorant. Më pas, e tërë shoqëria do të kanalizohet në një katastrofë të vërtetë.

I Lartësuarit All-llah, kërkoi nga ne që t’a transformojmë planetin tokë. Për t’a ndërtuar tokën, i Lartësuarit na ka krijuar mendjen, e cila i kupton dhe i përvetëson arritjet e trashëguara. Ajo (mendja) pranon përvojat e të parëve dhe kështu do të përfitojë nga civilizimet e mëparshme dhe njëkohësisht do të bëhet pjesëtare e zhvillimit të mëtutjeshëm. Kjo mendje e dallon njeriun nga kafsha. Kafshët, ende jetojnë jetë primitive, ashtu sikurse janë krijuar. Ne nuk mundemi t’i mësojmë kafshët se si të jetojnë në grupe, se si të sillen midis tyre dhe se cilat të jenë preferencat e tyre. Ne nuk kemi dëgjuar kurrë, që ndonjë kafshë të ketë trashëguar diturinë e babait apo të gjyshit të vet. Gjithashtu, nuk kemi dëgjuar kurrë që të mësojnë atë, që nuk e ka ditur më parë, dhe kështu të mund t’a zhvillonte vetveten, dhe të tjerët. Kjo nuk ka ndodhur për arsye aksiomatike, por për arsye se kafsha nuk e posedon mundësinë e zhvillimit.

Ç’kuptojmë me fjalën zhvillim

Unë habitem, kur dëgjoj disa që thonë se një kafshë ka evoluar në rrethin e vet dhe ka arritur këtë e atë. Ose ata që thonë se, një kafshë i ka qimet e veta më të shpeshta, kur jeton në vende të ftohta, apo se e posedon ngjyrën e vet në varësi të ambientit (bimëve, gurëve, rërës, etj.) ku ajo (kafsha) jeton, me qëllim që të fshihet nga armiqtë e saj, ose se ka ndonjë karakteristikë tjetër të evoluar!

Të gjitha këto janë dhunti prej All-llahut xh.sh., që Ai ia jep atij që do, për t’a mbrojtur jetën e tij nga zhdukja. Por, ç’është e vërteta, kafsha vetë nuk është e pajisur me mendje apo me logjikë. Ajo, gjithashtu, nuk e ka mundësinë e zhvillimit dhe të përparimit të jetës së vet, pasi i Lartësuarit me këtë dhunti (me mendje) e ka pajisur vetëm njeriun dhe askënd tjetër. Ai i shpalosi njeriut disa prej sekreteve të universit, që ai të mund t’a transformojë tokën dhe të mund të ndërtojë civilizim.

Sikur mendja e njeriut të mos ishte në gjendje të kuptonte dhe të mësonte prej civilizimeve të mëparshme, dhe të mos zhvillohej më shumë se paraardhësit e tij, ai do të ishte në një gjendje të ndryshme (nga gjendja në të cilën është sot), dhe padyshim se nuk do të arrinte kurrë t’i kuptonte sekretet e All-llahut të Lartëmadhëruar në univers.

Kur ne shohim se e bukura ndikon pozitivisht dhe se, gjithashtu, është shkaktare e përparimit njerëzor në këtë jetë, dhe është shembull për ndërtimin e planetit tokë, atëherë sistemi ynë arsimor, jep efekt diametralisht të kundërt, kur ne i “mësojmë” fëmijët tanë të “korrin” suksese pa mësuar, pa u munduar, me gënjeshtër, apo me mësim plotësues nëpër kurse, apo në forma të tjera, gjë që e shkatërron shkencën dhe punën njëkohësisht. Ne kështu ndihmojmë shkatërrimin e ndërtimit të deritanishëm, që kemi në planetin tokë, pasi që All-llahu xh.sh. na e ka mundësuar këtë ngritje dhe përparim!

Këtu, kemi një çështje, e cila kohë pas kohe tërheq vëmendjen tonë. Ajo që na bën përshtypje është të ushtruarit e kafshëve. Disa njerëz, pasi u kanë ushtruar kafshëve disa lëvizjeve, mundohen të na lënë të kuptojmë se edhe ato mendojnë apo logjikojnë. Atyre iu themi: ajo që ju pretendoni nuk është e vërtetë. Lëvizjet e tyre mbështeten në instiktet e tyre. Kur një kafshë ushtrohet të bëjë disa lëvizje, ajo instiktivisht e kupton se po shpërblehet. Prandaj, ajo i përsërit të njëjtat lëvizje, sepse ajo ushqehet pas bërjes së tyre. Por, nëse refuzon që t’i bëjë ato lëvizje, (instruktori i vet e godet dhe kafsha) instiktivisht e kupton se është duke u dënuar pasi ky dënim i shkakton dhembje.

Pra, ajo vepron ashtu siç i kërkohet, sepse në të kundërtën do të dënohet me privim të ushqimit, ose nga frika e dhembjeve që i shkaktohen. Ajo e di tani instiktivisht, e jo nga logjika e saj, se nëse do t’a bëjë atë (lëvizjen e caktuar), asaj do t’i jepet ushqim. Sikur të bazohej në mendjen e saj, ajo do t’ia përcillte këtë dituri këlyshëve të saj. Por, në të vërtetë ajo nuk di t’a bëjë këtë. Ne nuk kemi dëgjuar që një luan, një majmun apo një kalë, t’ia ketë përcjellë lëvizjet e veta, që i ka mësuar në cirk, këlyshëve të tij.

All-llahu i Lartëmadhëruar e ka caktuar me këtë detyrë Ademin, para se të krijohej. Këtë i Lartësuar, na i mësoi në Kur’an, kur Ai na tha:

" و اذ قال ربك للملائكة اني جاعل في الارض خليفة "

“ (Përkujtoje kohën) **Kur Zoti yt u tha melekëve: Unë do t’a vë (krijoj) në tokë zëvendësin...**”¹

Ç’kuptim ka fjala Hilafe²

Përderisa All-llahu i Lartësuar ia dha njeriut hilafetin në tokë, Ai i nënshtroi të gjitha llojet e krijesave të botës në shërbim të tij, dhe që të veprojnë për të. Materia e kësaj bote ndahet në katër lloje:

1. Materie e ngurtë (inorganike)

¹ Kur’an, 2 / 30

² Fjala Hilafe-Kalif, tek ne shqiptarët njihet si ‘mbreti i shtetit islam’. Ndërsa në realitet, me këtë emër, i Lartëmadhëruari e emëroi njeriun në tokë. Halif është zëvendësi i Tij në tokë. Çdo gjë e krijuar, i është nënshtuar njeriut, për arsye se ky ka qenë vullneti i All-llahut xh.sh. Halif është quajtur udhëheqësi i shtetit isalm, sepse konsiderohet se është zëvendësi i drejtësisë (së bukurës) në tokë (shënim i përkthyesit).

2. Materie bimore
3. Materie shtazore
4. Materie njerëzore

Lloji i materies së ngurtë, ashtu siç i themi ne, nuk posedon as ndjenja, e as nuk e ka aftësinë e lëvizjes. Kjo gjë shihet që në shikim të parë. Kjo lloj materie mbaron (së qeni e tillë, pra inorganike, pa jetë) me fillimin e shkallës bimore, e cila shfaqet dhe fillon të zhvillohet.

Ne shohim që barishtet merxhanë - koralet³ jetojnë në detëra. Ato japin shenjat e para të zhvillimit primitiv të botës bimore. Bimët kanë cilësinë e rritjes, zhvillimit dhe frymëmarrjes e të tjera, por nuk e kanë cilësinë e ndjenjës dhe të lëvizjes. Kjo lloj materie përfundon (së qeni e tillë, pra bimore) me fillimin e shkallës së parë shtazore. Kemi disa bimë, që kur i prekim, japin shenja gjallërie, dhe ato lëvizin. Një prej këtyre bimëve është ajo, që ne e quajmë zonja e turpëruar, ose ka edhe bimë të tjera, që ekzistojnë nëpër vendet tropikale, që kur ne i prekim, i lëvizin degët e tyre.

Shtazët e fillojnë jetën e llojit të tyre me anën e lëvizjeve dhe ky lloj (pra, lloji shtazor) përfundon (kur fillon lloji i materies njerëzore, pra tek) të logjikuarit. Për këtë, lloji më i lartë i kafshëve, arrin deri tek të menduarit primitiv, sikurse që janë majmunët, që imitojnë lëvizje të caktuara.

Ndërsa njeriu, fillon nga të menduarit primitiv. Kjo e dallon nga krijesat e tjera të All-llahut. Njeriu është ai, i cili i mundëson vetes përparim. Çdo gjeneratë i zgjeron kapacitetet e saj (mendore) prej civilizimeve të mëhershme, duke ia dorëzuar (këto njohuri) gjeneratës tjetër të mëpasme. Kështu, sa më shumë që përparojmë në kohë, do të kemi ndryshime (distanca) më të shpejta. Duke kaluar nga një gjeneratë në tjetrën, na deponohet një trashëgimi madhore prej civilizimeve të mëparshme, me anën e së cilës ne ndërtojmë zhvillimin dhe përparimin tonë.

I Lartësuarit All-llah, ka vendosur bazat e së bukurës në univers. Pa këto baza, jeta nuk mund të paramendohet. Mbi këtë bazë është ngritur jeta, e cila nuk mund të mendohet pa punë. Për këtë arsye, i Dërguari All-llahut s.a.v.s., thotë:

“Njeriu ha ushqim të mirë, atëherë kur ha nga puna e duarve të tij. Pejgamberi i All-llahut, Davudi a.s.⁴, ka ngrënë nga puna e duarve të tij”

Islami nuk lejon që dikush të shpërblehet pa punë. Kjo ndalesë shkon deri aty, sa që një proverb popullor thotë: Nëse nuk ka punë, ngarkoni njerëzit të hapin puse, që të tjerët t'i mbyllin ato.

³ Merxhan-Koral,- shqiptarët për herë të parë kanë mësuar nga Kur'ani për Merxhan-in. Fjalori anglisht shqip i Pavli Qeskut, thotë se 'coral' ka kuptimin merxhan. Ndërsa shprehja 'koral' është fjalë greke.

⁴ Davudi a.s. ishte i dërguar i All-llahut dhe njëherit mbret i popullit çifut. Davudi njihet si një prej mbretërve të rallë në botë i cili është yshqyer prej punës ose djersës së tij të farkatarit.

Sekreti i së bukurës në univers

Nga pikëpamja logjike, mbase radhitja nuk është e qartë. Si të ngarkohet njeriu për hapjen e një pusi, e pastaj për mbylljen e tij? Qëllimi i kësaj është në të angazhuarit e njeriut, që ai të jetë vazhdimisht në punë, të marrë shprehi pune, e jo të presë shpërblim pa punuar. Nëse kjo nuk do të kuptohej kështu, atëherë shoqëria do të përbëhej nga njerëz të papunë, të cilët do të bëheshin pengues, apo shkatërrues të së bukurës në univers. Pas kësaj, pakënaqësia, shthurja dhe shpërbërja do të përgjithësoheshin.

Kështu është edhe me të bukurën në univers. I Lartësuari All-llah, e ka ndaluar ngrënien e pasurisë së paligjshme. Ai, i Lartësuari ka thënë:

"و لا تأكلوا أموالكم بينكم بالباطل و تدلوا بها الي الحكام
لتأكلوا فريقا من أموال الناس بالاثم وأنتم تعلمون"

“ Dhe mos e hani pasurinë e njëri-tjetrit me të padrejtë! Pastaj me të, t’i korruptoni gjykatësit, (kështu) t’a hani një pjesë të pasurisë së njerëzve me tradhëti, ndërsa ju e dini (se çfarë mëkati jeni duke bërë). ”⁵

Nëse ti ushqehesh duke shpenzuar pasurinë e paligjshme, me këtë veprim, ti më ke penguar mua, që unë të ushqehem prej fitimit të punës, që kam bërë me duart e mia. Kështu, ti do të bëheshe shkaktar, që unë të mos t’i shijoj frytet e punës sime, sepse ti do të merrje rezultatin e lodhjes dhe djersës sime, të punës që unë kam bërë, etj. Ti merr ajkën e prodhimit tim. Kur të katandisem në një gjendje të tillë, atëherë unë do t’a pyes veten: pse duhet që unë të punoj? Veprimi yt, do të kuptohej sikur je ti ai, që i ke vendosur rregullat e së bukurës në univers. Nëse, secili njeri do të merrte frytet e punës së vet, sigurisht që do të ishte më i kujdesshëm në punë, dhe në këtë mënyrë do të kishim përparim akoma më të madh në jetë.

Nga kjo kuptojmë, se i Lartësuari e krijoi të bukurën në univers, por njeriu dhe sjelljet e tij, e shthurën këtë bukuri dhe e mira po humbet, sepse vendin e saj e ka zënë e shëmtuara dhe mjerimi.

Gjithashtu, i Lartësuari All-llah, ua ka siguruar krijesave furnizimin, dhe secilin prej tyre e ka dalluar me një dhunti, që nuk e posedon tjetri. Ishte vullneti All-llahut xh.sh., që kjo të sendërtohej sipas një sistemi inxhinjrik. Dikujt i ka dhënë dhunti në mjeksi, dikujt në ndërtimtari, me fjalë të tjera, secili prej nesh ka një dhunti që nuk e posedon tjetri, sepse atij që i është dhënë ai profesion, e bën atë më mirë dhe më saktë se të tjerët.

Këtë e vërtetojmë me thënien e All-llahut xh.sh., i Cili, në Kur’anin Kerim, thotë:

"انظر كيف فضلنا بعضكم على بعض"

⁵ Kur’an, 2 / 188

“Shikoni se si u kemi veçuar njëri nga tjetri (në këtë botë)...”⁶

All-llahu xh.sh., nuk thotë se dikush është veçuar më shumë nga të tjerët. Gjithashtu, Ai nuk thotë se njëri është më i privilegjuar se tjetri. Pse? Sepse, secili prej nesh, ka një veçori, që e dallon prej tjetrit. Kështu, dikush prej nesh, mbase, është një inxhinjer i shkathët, por ky njeri ka kërkesa për nevojat e tij të përditshme, në ushqim, veshmbathje e të tjera. Pra, ky njeri, është i veçuar dhe i dalluar vetëm në një segment të jetës së tij, ndërkohë që ka nevojë për të tjerët, të cilët janë të dalluar në specializime të tjera.

Tjetri, mbase, është një mjek i dalluar. Ai ka disa veçori specifike të tij në mjekësi, por ky ka nevojë për inxhinjerin, që t’ia ndërtojë shtëpinë për të banuar. Gjithashtu, ka nevojë që dikush tjetër t’a veshë, e dikush tjetër prej bujqve, t’a ushqejë, etj.

Ky tjetri, mbase është rrobaqepës i mirë. Por, ai ka nevojë për mjekun dhe për barërat, ka nevojë për inxhinjerin që t’ia ndërtojë vendbanimin, gjithashtu, edhe për bujkun që t’ia sigurojë ushqimin, etj.

Pra, secili prej nesh është i dalluar në një fushë, sepse posedon disa veçori, që tjetri nuk i ka. Kështu është edhe me pastruesin, i cili pastron rrugët, ose ai që bart materialin ndërtimor, qoftë me krahë apo me vinç, për të ndërtuar një godinë. Pra, secili prej nesh, ka nevojë për tjetrin, sepse sikur t’i linim mbeturinat (në rrugë pa u mbledhur), do të përhapeshin sëmundje të shumta dhe, padyshim, toka do të mbushej e tëra me plehëra. Ai njeri është i veçuar prej nesh, sepse është pastrues. Kështu është edhe me ata që punojnë nëpër kanalizimet e ujërave të zeza. Ata janë të veçuar nga të tjerët, në këtë fushë. Sikur këta persona t’i linin punët e tyre, ujërat e zeza do të vërshonin rrugëve, dhe kështu të jetuarit në tokë do të bëhej i pamundur.

Por, mjerë ti, o njeri, që e përbuz punën e tjetrit, e thua se je mbi atë, pasi ai punon në kanalizime, ndërsa ti je mjek, apo ai tjetri, që është inxhinjer, dhe e sheh veten më të dalluar se tjetri. Ti ke nevojë për atë, dhe jo vetëm nevojë, por ke nevojë të madhe për të. Shoqëria nuk mund të jetojë ndryshe, pa nevojën e njëri-tjetrit, ne të gjithë e plotësojmë njëri tjetrin, prej zejtarit më të vogël, deri tek ai më i madhi.

Për të jetuar dhe për të përparuar një shoqëri, duhet të ketë lidhje midis vete. Kjo lidhje është rezultat i furnizimit që bëri All-llahu i Lartësuar, që secili t’a prezantojë punën e vet para njerëzve të tjerë. Ai do të jetë i kënaqur, se me të ka siguruar furnizimin e vet dhe të fëmijëve të tij. Njeriu endet, duke kërkuar punë, për t’u furnizuar. Kjo sjellje është e domosdoshme, sepse aty qëndron themeli i së bukurës në këtë univers. Sikur të gjithë ne të ishim mjekë ose inxhinjerë, atëherë kush do të na ofronte bukën e mëngjesit? Kush do t’i pastronte rrugët? Kush do të punonte nëpër kanalizime, etj?

Një shoqëri, që nuk bazohet në mbështetjen e njerëzve tek njëri-tjetri, nuk mund të ekzistojë, dhe si rrjedhim do të shkatërrohej brenda pak kohe, sepse jeta e tyre do të ishte e pamundshme. Pra, është vullneti i All-llahut xh.sh., që secili prej nesh të ketë veçoritë e

⁶ Kur’an, 17 / 21

veta, dhe kështu të përmbushim zbrazëtirat e njëri tjetrit, për të bërë të mundur vazhdimin e jetës.

Kjo, ishte një hyrje e domosdoshme mbi të bukurën në univers. All-llahu i Lartësuar e krijoi universin mbi binarët e së bukurës, ashtu sikurse e krijoi edhe të mirën mbi këto binarë. Ndërsa e keqja, ishte rezultat i përzgjedhjes së keqe të njeriut, pasi All-llahu xh.sh. i kishte mundësuar atij që të zgjidhte ndërmjet tyre. All-llahu, atij (njeriut) i mundësoi lirinë për të vepruar, apo për të mosvepruar. Kështu, me pretendime të tilla, njeriu po e shkatërron botën, duke propaganduar, gjoja, se është duke e sendërtuar shoqërinë. Citojmë thënien e All-llahut xh.sh., prej Kur'anit Kerim:

" واذا قيل لهم لا تفسد في الأرض قالوا انما نحن مصلحون
ألا انهم المفسدون ولكن لا يشعرون "

“ Kur atyre ju thuhet, mos bëni çrregullime në tokë, ata thonë: ne jemi reformistë (po mbajmë rendin dhe paqen). A nuk janë ata, që po bëjnë çrregullime!? Por, ata, nuk po e ndiejnë.”⁷

All-llahu xh.xh. e krijoi universin mbi themele të shëndosha, dhe e caktoi atë, për një jetë të mirë dhe të harmonishme për secilën krijesë. Sikur njeriu të ndiqte mësimet e All-llahut të Lartësuar, qoftë në përbërje, qoftë në veprim, në specifika, apo në shkaqe, atëherë, në univers, nuk do të ishte prezent as e keqja, e as mjerimi. Çdo gjë, që vendosi i Lartësuari, ka të bëjë me rregullat e së bukurës. Ato (rregullat) janë shumë të përpikta, dhe i mundësojnë secilit që t'a kryejë detyrën e vet. Ato nuk kanë nevojë për diturinë e njeriut, i cili vazhdimisht mundohet që t'i ndryshojë apo t'i zëvendësojë gjërat.

E keqja nuk bën pjesë në krijim, e as nuk është pjesë e rregullave të vendosura të krijimit, por është rezultat i ndërhyrjes së njeriut në të, dhe mund t'a shkatërrojë atë (krijimin). Qëllimi i krijimit të universit është të shpikurit (e gjërave të dobishme), të cilat i kryejnë funksionet e tyre, ashtu si ka dëshiruar All-llahu i Lartësuar. Të gjitha këto, veprojnë në harmoni dhe në qetësinë më të madhe të mundshme. Këto qëndrojnë shumë larg shpikjes së gjërave të dëmshme, që shkaktojnë vuajtje dhe mjerim, dhe që përhapin sëmundje dhe ngatërresa në univers.

Njeriu me largimin e tij prej programit të All-llahut, u përball me sëmundje dhe ngatërresa në shoqëri. U përball me mjerimin dhe keqbërjen. Për këtë arsye, i Lartësuari, iu dërgoi atyre të dërguar (pejgamberë), të pajisur me programe, për t'a rikthyer universin në harmoninë dhe bukurinë e vet.

Gjatë leximit të Kur'anit, hasim thënien:

" و ننزل من القرآن ما هو شفاء و رحمة للمؤمنين "

⁷ Kur'an, 2 / 11-12

“ Ndërsa Ne, ju kemi shpallur Kur’anin për të qenë shërues dhe mëshirues për besimtarët...”⁸

Nga ky ajet, kuptojmë se qëllimi i zbritjes së Kur’anit, qenka të shëruarit prej sëmundjeve kritike, që rrjedhin prej ekstremizmave të ndryshme. Këto sëmundje vijnë si rezultat i largimit nga programi i All-llahut. Ata, që do ta ndjekin programin e All-llahut, konsiderohen të shëruar dhe të pastruar nga sëmundjet që vuanin. Këtyre (kësaj shoqërie) do t’ju zbresë mëshira e All-llahut. Këto sëmundje nuk pastrohen tërësisht, por ato shuhet (përkohësisht), dhe ato nuk kthehen për t’i shqetësuar njerëzit përsëri (për aq kohë sa ata ndjekin me përpikmëri programin e All-llahut).

All-llahu i Lartëmadhëruar e ngriti këtë univers mbi bazat e ligjeve dhe rregullave, që bëjnë që e bukura të jetë cilësia e universit, por njeriut duke iu dhënë liria e veprimit, ndërhyri në bukurinë e universit dhe po e shkatërron atë. Duke abuzuar me lirinë e dhënë, ai zgjodhi gjëra që nuk janë në pëlqim me vullnetin e All-llahut xh.sh., në univers. Prej këtui, filloi e keqja dhe prej këtui filloi shkatërrimi.

Habitem kur dëgjoj propagandimet e disa njerëzve, të cilët thërrasin për “transformime” të universit. Ata e dinë fare mirë se janë shkatërruesit e tij, por kur vetë ata e pësojnë, dhe vuajnë dhe ndiejnë dhembjet e keqbërjes së tyre, atëherë ata kthehen përsëri në programin e All-llahut dhe në rregullat e së bukurës në univers. Por, fatkeqësisht, këta nuk kthehen tek këto rregulla në bazë të imanit të tyre, por kthehen pa dëshirë – me zor, (pasi e kuptojnë dhe binden) se jeta nuk mund të vazhdojë, pa këto ligje dhe pa këto rregulla.

Ne, për fat të keq, vijmë prej shoqërive jobesimtare. Prej atyre, që po shthurin jetën tonë, për shkak se e kanë lënë programin e All-llahut, që është i vetmi rregullator i problemeve tona. Por, këto shoqëri, kanë filluar të kthehen, kundër vullnetit të tyre, në programin e Krijuesit, sepse është vërtetuar përfundimisht, se nuk ka kuptim vazhdimi i jetës pa programin qiellor. Këta të kthyer, e bëjnë këtë kthesë, qoftë nga besimi tyre, qoftë nga domosdoshmëria, sepse nuk mund t’i evitojnë stërlodhjet e tyre të jetës, jashtë këtij programi qiellor.

Kapitulli i dytë

E shëmtuara në univers

Ashtu siç theksuam më herët, i Lartësuarit All-llahu, bëri që e bukura të jetë prezente tek secila krijesë në univers. Për t’i mbajtur dhe për t’i ruajtur këto krijesa në bukurinë e tyre, Ai solli dhe caktoi edhe ligjet. All-llahu na shtrin duart, na ofron mundësinë për të vepruar mirë. Ai, i cili bëhet shkaktar për të mirë, ka fituar, ndërsa, ai, i cili mundohet të marrë diçka, të cilën All-llahu e ka ndaluar, ai konsiderohet shthurës dhe shkatërrues në univers.

⁸ Kur’an, 17 / 82

Universi është krijuar sipas programit të All-llahut, për t'a shijuar harmoninë në çdo gjë, në punë, familje, fëmijë, risk dhe në çdo lëvizje të jetës së universit. Nëse jeton sipas ligjeve të All-llahut do të gëzosh mirësi, nëse largohesh prej ligjeve të Tij, padyshim se do t'a pësosh, jo vetëm në këtë botë, por edhe në ahiret (në botën tjetër). Prandaj thuhet: *'Nuk ka dobi nga mirësia, e cila të shpie në zjarr, e as dëmi nga e keqja që të shpie në xhennet.'*

Atëherë, si mund të kuptohet që: e mira të shpie në zjarr? Le të sjellim një shembull. Njeriu mund të vjedhë me qëllim që të japë lëmoshë, dhe ai jep nga ajo, që e ka vjedhur! Ua merr (pasurinë) të pasurve për t'ua dhënë të varfërve. Këtë person, ndryshe e cilësojnë si hajdut të "ndershëm"! Por atij nuk i takon aspak ky epitete, pra epitete "i ndershëm". Ai mendon se është duke vepruar mirë, por, në realitet, ai ka bërë një vepër të shëmtuar dhe dëm të madh. Ai ka vjedhur, gjë që All-llahu xh.sh. e ka ndaluar, edhe pse ai ka menduar që atë që ka vjedhur, t'ua shpërndajë të varfërve. Atij (hajdutit) nuk i sjell asnjë dobi e mira që ka bërë, dhe atij nuk do t'i pranohet kjo vepër, sepse ai e ka bërë atë, në mënyrë jo të rregullt dhe joligjore.

I Lartësuar All-llah, nuk kërkoi nga askush që t'a ndihmojë Atë, për t'i dhënë riskun dikujt tjetër. Ai është Furnizuesi i të gjithëve. Edhe pasuria e ndaluar (vjedhur) është risk, por kjo pasuri, apo ky risk, është i ndaluar (haram).

All-llahu xh.sh., nuk e lejoi askënd që të marrë (vjedhë) pasurinë e ndaluar, e pastaj të thotë se bëri mirë. Njeriut nuk i lejohej dhe nuk ka kompetenca që të sjellë ligje. Ai nuk mund t'a lejojë atë që është e ndaluar, e as t'a ndalojë atë që është e lejuar. Për këtë, All-llahu i Lartësuar, në Kur'anin Kerim, na thotë:

" قل ارعيتم ما أنزل الله لكم من رزق فجعلتم منه حراما و حلالا قل والله أذن لكم أم علي الله تفترون "

“**Thuaj: a shikoni (keni menduar ndonjëherë) se All-llahu e zbriti riskun për ju, (ndërsa) ju atë (disa prej ushqimeve i konsideroni) se janë të lejuara e (disa) të palejuara (haram e hallall). Thuaj: mos vallë ishte All-llahu që ju dha leje për këtë, apo ju shpifni me (emrin) e All-llahut.**”⁹

Kështu, i Lartësuar xh.sh., na mësoi se harami dhe hallalli janë me lejen e Tij, dhe në dipozicionin e Tij. Njeriut nuk i lejohet t'a ndalojë atë, që e ka lejuar All-llahu, e as të lejojë atë, që e ka ndaluar All-llahu. I Lartësuar nuk dëshiron, e as që ka kërkuar prej ndokujt që t'a ndihmojë Atë në univers, sepse Ai është Absolut, i Gjithëmundur për çdo gjë, ashtu siç thamë më sipër: *'nuk ka dobi nga mirësia, e cila të shpie në zjarr.'*

Ose shembulli i një gruaje, e cila e shet nderin e saj, pastaj mundohet t'a arsyetojë vetveten, duke thënë se (me këtë veprim) po mundohet t'i ushqejë fëmijët, për t'i edukuar!! Asaj i themi se, ajo çka ka bërë, është e ndaluar dhe e gjithë mirësia e saj do të shkojë bosh, sepse ajo nuk do t'i pranohet. All-llahu është më i pasuri nga të gjithë, sikur

⁹ Kur'an, 10 / 59

të duronte vetëm pak, ajo do të furnizohej nga All-llahu me hallall, për t'i edukuar fëmijët e saj.

Kështu është edhe me shprehjen: *'nuk ka dëm nga e keqja, e cila të shpie në xhennet.'* Nëse një njeri ngadhënjën ndaj mizorisë, por pëson plagë, prej të cilave ndien dhembje të mëdha, kjo për të, nuk do të konsiderohej e dëmshme, por e dobishme. Sepse ai do të shpërblehet në mënyrën më të mirë. Nëse një njeri posedon një pasuri, me të cilën i plotëson nevojat e veta, por edhe i tepron diçka, dhe fillon të japë sadaka nga pasuria që ka, ai nuk do të jetë humbës, por fitues. Pa pikë dyshimi, ajo sadaka, do të shumëfishohet tek All-llahu i Lartëmadhëruar.

Të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s., i ishte dhuruar një dele e pjekur. Ai dha urdhër që ajo dele, t'u shpërndahej të varfërve dhe të gjorëve. Këtë detyrë e mori Aishja r.a.

Ajo e dinte se i Dërguari i All-llahut e kishte qejf kofshën e deles dhe e ruajti për të. Kur erdhi i Dërguari All-llahut s.a.v.s., dhe e pyeti për delen, Aisha r.a., i tha: e kemi shpërdarë të tërën, me përjashtim të kofshës. I Dërguari i All-llahut tha: paska mbetur e tëra, me përjashtim të kofshës.

Këto janë standartet e vërteta, si për të mirën, ashtu dhe për të keqen. Janë standarte të cilat, i ka vendosur All-llahu xh.sh. Por, fatkeqësisht njeriu gabon në përzgjedhje. Këtë mundësi, njeriut, në këtë univers, ia dha All-llahu xh.sh. Në vend se ai të zgjidhte për të zbatuar standartet e shëndosha e të sakta, ato të cilat rrjedhin nga natyrshmëria e tij, ai mundohet që t'i përgënjeshtrojë këto standarte nga egoja e tij.

Për t'a kuptuar këtë realitet, ne duhet t'i qasemi më gjërësisht studimit të krijesave në univers. Le t'u drejtohem atyre krijesave, të cilat nuk e kanë lirinë e zgjedhjes. Le të shohim sistemin e veprimit të tyre. Do të shohim se ato kanë një sistem të mrekullueshëm dhe se ato veprojnë në harmoni të plotë midis tyre. Ato janë shumë precize. Secila krijesë kalon një jetë të qetë, pa mjerim, pa vuajtje, e pa mundim.

Dielli, hëna, yjet, planetet, ajri dhe mbarë ato krijesa, të cilat nuk ka mundësi zgjedhjeje, e kryejnë detyrën e tyre pa ndonjë ankesë, ndaj dikujt tjetër, dhe pa e lodhur askënd. Askush nuk është ankuar se dielli është vonuar në lindjen e tij, apo nuk është ankuar se ai ka lindur tek një popull, dhe nuk ka lindur tek populli tjetër. Rregullat e yjeve nuk e kanë lodhur askënd, dhe kur ato do t'a humbin kontrollin, së bashku me to, do të humbë i tërë rregulli i universit. Gjithashtu, askush nuk është ankuar, se nuk ka mundësi të gjejë ajër për të marrë frymë. Askush, gjithashtu, nuk mund të thotë se të reshurat u ndalën dhe çdo gjë mori fund: do të shkatërrohen arat, kafshët dhe njeriu. Askush nuk mund të thotë se toka ka devijuar nga trajektorja e saj dhe se ka dalë nga orbita, dhe se tani jemi mbi shtresat qiellore dhe se jemi duke shëtitur nëpër galaktikë pa drejtues, nëpër hapësirën e gjërë.

Bota e kryen detyrën e vet, e nënshtruar

Të gjitha këto (çka përmendëm më sipër) nuk janë duke ndodhur. Por çdo gjë, çdo veprim i është nënshtruar All-llahut të Lartëmadhëruar. Të gjitha këto, e kryejnë detyrën

e tyre, pa e ndier dhe pa kuptuar. Ato e kryejnë detyrën e tyre plotësisht, duke qenë se nuk e kanë lirinë e zgjedhjes. Por, shfrenimi dhe e keqja, në tokë, erdhi prej atij që e ka lirinë e zgjedhjes, pra, prej njeriut. Fatkeqësisht, ndërhyrja njerëzore, zakonisht po paraqitet në shfrenim, e jo në përmirësim!

Nëse i referohemi fillimit të jetës, shohim se All-llahu i Lartësuar e drejtoi perceptimin tonë drejt programit të jetës të kësaj gjithësie. Ky program, u shfaq që prej momentit të ardhjes së Ademit në planetin Tokë. Nga ai, u kërkua që t'ua përcjellë pasardhësve të tij këtë program, duke ju thënë se ai, i cili do t'i përmbahet këtij drejtimi, do të jetë i lumtur dhe do të jetë i mbrojtur nga vështirësitë.

Kështu, All-llahu xh.sh., në Kur'anin Kerim, thotë:

" قال اهبطا جميعا بعضكم لبعض عدو فاما يأتينكم مني هدي فمن اتبع هداي فلا يضل ولا يشقى "

“(All-llahu ju)Tha: zbrisni prej saj¹⁰ ju të dy¹¹, se të gjithë ju do të jeni midis vete armiq¹². Prej Meje do t'iu vijë udhëzimi, ai i cili do t'a ndjekë këtë udhëzim, nuk do të humbasë, e as nuk do të ketë vështirësi.”¹³

Pra, siç e shohim, që prej fillimit të paraqitjes së njeriut në tokë, ne jemi të informuar nga All-llahu i Lartësuar, se mjerimet dhe të këqiat do të vijnë nëse largohemi nga programi i All-llahut xh.sh.. Pra, nëse ky program do të praktikohej ashtu siç kërkohet, e keqja nuk do të jetë prezent në univers. Pra, po e shohim se All-llahu xh.sh. na ka treguar rrugën e vërtetë, që prej fillimit të jetës sonë.

Ademi a.s. kur zbriti në tokë, kishte me vete programin, të cilin ua përcolli fëmijëve të tij, me qëllim që edhe ata t'ua përcillnin pasardhësve të tyre.

Këtu, tani, kemi të bëjmë edhe me vullnetin e njeriut, i cili mbolli farën e së keqes në tokë. Kjo (e keqe) filloi me fëmijët e Ademit. Kur'ani na tregon konfliktin midis Habilit dhe Kabil. Ishte krimi (vrasja) i parë, që ndodhi në planet, midis bijve të Ademit. Sikur Kabili t'a dëgjonte dhe t'a kuptonte thënien e All-llahut të Lartëmadhëruar:

" و لا تقتلوا النفس التي حرم الله الا بالحق "

“E mos i vrisni qeniet njerëzore, të cilat i ka ndaluar All-llahu, me përjashtim të atij që do t'a meritojë (vrasje me drejtësi).”¹⁴

¹⁰ Prej saj-prej xhennetit

¹¹ Ademi dhe Hava (qenie njerëzore)

¹² Midis qenies njerëzore dhe xhinëve - shejtanëve

¹³ Kur'an, 20 / 123

¹⁴ Kur'an, 17 / 33

nuk do të ndodhte kjo e keqe. Por ajo që ndodhi, ishte se njëri prej tyre, në këtë rast Kabili, e theu programin e All-llahut, dhe e vrau një njeri, ndërkohë që All-llahu e kishte ndaluar vrasjen e njerëzve, përveçse me të drejtë (ata që e meritojnë vdekjen, sipas Ligjit Islam).

Tregimi është si vijon më poshtë:

All-llahu i Lartësuar kishte caktuar që Hava të lindte, në çdo shtatzënësi, nga një djalë dhe nga një femër. Mbase, me qëllim të shtimit të qenies njerëzore, në planetin tokë. Ishte caktuar, gjithashtu, që mashkulli i lindur i shtatzënësisë së parë, do të martohej me femrën e lindur në shtatzënësinë e dytë. Ndërsa, mashkulli i shtatzënësisë së dytë, do të martohej me femrën e shtatzënësisë së parë. Kabilit nuk i pëlqeu ky përcaktim, dhe protestoi. Motra e tij, që kishte lindur me të, ishte shumë më e bukur se motra, e cila kishte lindur me Habilin. Për këtë arsye, u mundua që t'a ndryshojë këtë përcaktim. Ai propozoi që të martohej me motrën e tij, me të cilën kishte lindur. Ata iu drejtuan babait të tyre, Ademit a.s. Nga ai kërkuan, që ai të gjykojë drejtë. Ademi për t'a stabilizuar situatën, iu drejtuar All-llahut:

Kur'an Kerim, na transmeton se si ka ndodhur ngjarja:

"واتل عليهم نبأ ابني ادم بالحق اذ قربا قربانا فتقبل من احدهما و لم يتقبل من الآخر
قال لأقتلنك قال انما يتقبل الله من المتقين "

“(O Muhammed) informoji¹⁵ me të vërtetën e dy bijve të Ademit, kur ata prenë nga një kurban (për All-llahun). Njërit iu pranua, ndërsa tjetrit jo. (Atij që nuk iu pranua) Tha: do të të vras, (ndërsa atij që iu pranua kurbanin) tha: Pa dyshim, se i pranohen (lutjet – kurbanet) vetëm atyre, që kanë frikë-respekt ndaj All-llahut”.¹⁶

Ky tregim, na përkujton se All-llahu xh.sh., kur e ka zbritur Ademin në planetin tokë, ia ka dhënë atij edhe programin. All-llahu, pra, nuk e ka lënë njeriun pa udhëzues, për asnjë moment, që prej fillimit të jetës së tij. E ka udhëzuar, dhe i ka treguar se cila është rruga e jetës së lumtur, pra cila rrugë e afron atë tek Ai, dhe cila e largon nga Ai. Kemi disa njerëz që thonë se Ademi ka zbritur në tokë pa program, dhe se ai dhe pasardhësit e tij janë lënë pa udhëzues, derisa nuk erdhi Idrisi a.s., e më pas edhe Nuhu a.s. Këta individë, mbështeten në tregimet e peygamberëve, duke filluar prej Nuhut a.s. Këta mendojnë se para tij (Nuhut) nuk kishte peygamber. Atyre ju themi se, kjo nuk është e saktë. Unë mendoj se këtyre do t'i u mjaftonte argumenti i All-llahut dhe drejtësia e Tij, i Cili, në Kur'anin Kerim, thotë:

" و ما كنا معذبين حتي نبعث رسولا "

“ ...ndërsa, Ne, nuk e ndëshkojmë (asnjë popull), derisa nuk i kemi dërguar peygamber.”¹⁷

¹⁵ Njerëzit me të vërtetën, sepse pasuesit e feve qiellore duhet t'a dinë saktësisht se çfarë kishte ndodhur...

¹⁶ Kur'an, 5 / 27

¹⁷ Kur'an, 17 / 15

Pra, ishte e domosdoshme, që njeriu të informohej mbi programin e All-llahut. Për të pasur drejtësi, njeriu duhej të informohej, përndryshe nuk do të kishte kuptim shpërblimi, apo ndëshkimi për mëkatarët. Sikur, të mos të kishin program, si do të gjykoreshin Kabili dhe Habili tek All-llahu i Lartëmadhëruar? Ata kishin informacionin dhe diturinë e duhur bindëse, se All-llahu xh.sh., detyrimisht ekziston. Sikur të mos ishte informuar Ademi dhe bijtë e tij, për programin e All-llahut, ne nuk do të dinim asgjë për të.

Të metat e mendjes së njeriut

Vetëm me anën e mendjes sonë, ne nuk do të mund të arrinim asnjëherë tek kërkesat e All-llahut, nuk do të dinim se si t'a adhuronim Atë, gjithashtu, nuk do të dinim se çka do t'i pëlqente, e çka do t'a hidhëronte. Mendja mundi t'ia arrijë qëllimit, sepse arriti t'a njohë ekzistencën e Hyjnisë të universit, pasi ishte munduar të njohë universin, krijimin e qiejve dhe të tokës, të diellit dhe të hënës, e të tjera.

Ajo (mendja) arriti t'a kuptojë se kemi të bëjmë me një Krijues madhështor. Ky është Ai, i Cili i kish krijuar të gjitha këto, sepse njeriu nuk posedon forcë për t'i bërë ato. Askush nuk ka mundësi t'a krijojë diellin, hënën, yjet apo tokën. Askush nuk do të pretendonte të thoshte se ato janë vepra e tij, ose të thoshte se ai e ka krijuar vetveten. Këto gjëra, janë mbi mundësinë e njerëzve, edhe sikur t'i grumbullonin të gjitha forcat e tyre. Pra, ishte e domosdoshme, që të pranohej Krijuesi i këtij universi, i Cili i bëri të gjitha këto, dhe i Cili na krijoi edhe neve.

Kush është Krijuesi? Çfarë do Ai nga ne? Këto janë pyetje që e tejkalojnë mundësinë e të kuptuarit të mendjes sonë. Ajo nuk mund të arrijë deri tek një përgjigje. Mendja këtu ndalet, pra stagnon, tek njohja e ekzistencës së Krijuesit. Pra, si e ka emrin Ai? Ç'ka dëshiron nga ne? Si t'i afrohem Atij? Cilat gjëra i pëlqejnë, e cilat jo? Të gjitha këto pyetje, janë mbi mundësinë e mendjes së njeriut.

Le t'a afrojmë këtë edhe më afër mendjes sonë. Le t'a zemë se jemi ulur në një dhomë të mbyllur. Pas pak dëgjojmë se dikush është duke trokitur në derë. Ajo çka ne mund të dimë, është se dikush është duke trokitur në derë. Po, kush është ai? A është burrë, grua apo fëmijë? Çfarë do ai? Na i do neve të mirën apo të keqen, ka ardhur me qëllim të mirë, apo me qëllim të keq, apo nuk ka asgjë kundër nesh, apo ka ardhur për të na informuar për gjëra, që ne nuk i kemi marrë vesh? Të gjitha këto përgjigje nuk do t'i marrim, pa u ngritur dhe pa ia hapur derën trokitësit, i cili është duke pritur jashtë derës.

All-llahu i Lartësuar është fisnik në dhurimet e Tij. Për këtë arsye, Ai nuk na ka lënë që këto përgjigje, ne t'i marrim nga vetja jonë. Ai na dërgoi peygamberë, na hapi dyert e qiellit dhe na informoi se Krijuesi i këtij universi është All-llahu xh.sh. Ai kërkoi nga ne që t'a adhurojmë Atë, në mënyrë që të mos humbim. Ai përcaktoi për ne adhurimin, dhe këtë formë lutjeje. Ai na mësoi se, përveç kësaj jete, kemi edhe një jetë tjetër, e cila është e amshueshme. Gjithashtu, na ka treguar se Ai, ka paraparë begati të panumërta për ata që kanë besuar, dhe dënim të madh për ata që kanë mëkatuar.

Për këtë arsye, nga Mëshira e Tij, ka caktuar që jeta njerëzore të fillojë në tokë, ka dërguar të dërguar apo peygamberë. Këta do të jenë ata, të cilët do të na informojnë për All-llahun, rreth asaj se çfarë dëshiron Ai, në mënyrë që njeriu të dijë për Të, se Ai është All-llahu, Krijuesi i gjithçkaje, po ashtu edhe Krijues i vetë neve qenieve njerëzore. Ai, gjithashtu, na ka vendosur programin e jetës, të cilin ne duhet t'a ndjekim.

Programi u zbrit në tokë me Ademin a.s.

Problemin e pazgjidhur, ndërmjet Kabilit dhe Habilit, ia kishin lënë për gjykim vendimit të All-llahut xh.sh. Ky është një prej argumenteve, se ata dinin për ekzistencën e All-llahut, dhe e njihnin Atë, si Krijues të këtij universi. Përderisa kishin vendosur që çështjen t'ia linin All-llahut për t'a gjykuar, ata ia afruan kurbanët. Edhe ky veprim argumenton se ata kishin dijeni për programin e All-llahut xh.sh. Ndryshe si do të kuptohej fakti se ata kërkuan ndihmë nga All-llahu xh.sh? Ata e dinin se All-llahu i Lartëmadhëruar iu afrohej atyre sipas veprimeve (lutjeve) të veçanta dhe hidhërohej me anë të disa veprimeve (të këqia) të kufizuara. Kjo ishte sa për t'a kuptuar se All-llahu nuk e ka lënë njeriun, për asnjë moment të vetëm, pa program. Pra, programi u zbrit në tokë me Ademin a.s.

Ne mësuam se All-llahu ia pranoi kurbanin Habilit e nuk ia pranoi kurbanin Kabilit. Thuhet se Habili kishte marrë kurbanin më të mirë që kishte, ndërsa Kabili kishte marrë kurbanin më të dobët që kishte. All-llahu është i mirë, dhe i do vetëm të mirët. Gjithashtu, thuhet se Habili ishte pajtuar me gjykimin e All-llahut, i Cili kishte caktuar që ai të martohej me motrën nga shtatzënia e parë (më e madhe se ai), me atë që kishte lindur me Kabilin, ndërsa Kabili protestoi ndaj vendimit të All-llahut, dhe vazhdoi të këmbëngulë në kërkesën e tij, sepse i dukej më e drejtë të martohej me motrën e dytë, ngase kishte lindur nga e njëjta shtatzënia.

Sado të flitet rreth shkaqeve të ngjarjes, ne na intereson ajo që shkruar në Kur'anin Fisnik, se All-llahu ia pranoi kurbanin Habilit, e nuk ia pranoi kurbanin Kabilit. Do të duhej që Kabili t'a pranonte dhe respektonte vendimin e All-llahut, edhe pse Ai nuk ia pranoi kurbanin atij. Ai duhej t'i kërkonte falje (istigfar) All-llahut xh.sh., të shikonte veten dhe të metat e tij dhe të orvatej të përmirësohej duke këshilluar veten. Por, fatkeqësisht, ai nuk e bëri këtë. Ai u mbush plot mllef dhe hidhërim, dhe duke shpërthyer prej zemërimit i tha Habilit: do të të vras.

Habili ia ktheu: Unë nuk e ndiej veten fajtor, për çka ndodhi mes nesh. All-llahu xh.sh. nuk e pranoi kurbanin tënd. All-llahu pranon veprat e individëve të pastër e të dlijrë.

Do të ndalojmë këtu pak, e përsëri të pyesim: Kush e informoi Habilin, se All-llahu i pranon lutjet e individëve të pastër? Pra, s'do mend, ata kishin para tyre programin, prej të cilit ishin informuar. Habili e dinte se All-llahu nuk i pranon lutjet e mëkatarëve apo pabesimtarëve.

Më pas, All-llahu xh.sh. vazhdon të na tregojë neve të vërtetën mbi ngjarjen, se Kabili e vrau vëllain e vet, Habilin. I Lartësuari thotë:

" فطوعت له نفسه قتل أخيه فقتله فأصبح من الخاسرين "

"Fryma e tij ¹⁸ e shpuri në vrasjen e vëllait, dhe e mbyti atë. Kështu (me këtë vepër ai) u bë prej të humburve."¹⁹

Akti i kryerjes së vrasjes, pra mënyra se si u krye vrasja, nëpërmjet goditjes me një pjesë hekuri, guri, apo çfarëdo sendi tjetër, neve nuk na intereson. Ajo, që neve na duhet dhe na intereson, është se, ky akt veprimi, konsiderohet si krimi i parë që ka ndodhur tek qenia njerëzore. Është ndryshimi i parë i programit dhe refuzimi i parë i vullnetit të All-llahut xh.sh., prej qenies njerëzore në univers.

Mëkati nuk u ndërpre

Ishte kjo një paraqitje e shpejtë e fillimit të temës sonë mbi të keqen në univers. Ishte All-llahu, i Cili me vullnetin e Tij dëshiroi të na tregojë se e keqja vjen vetëm atëherë kur ndryshohet programi i Tij. Sikur Kabili t'i bindej programit të All-llahut, ai nuk do ta vriste vëllain e tij. Ky ishte fillimi i mëkateve, që barti me vete të këqijat, të cilat nuk u ndalën. Në këtë mënyrë, na transmetohen edhe tregimet e pejgamberëve dhe të dërguarve në Kur'anin Kerim, për Nuhin, Hudin, Salihin, Shuajbin, Lutin, Musain, e të tjerë. Për ta ruajtur rendin në univers, ishte e domosdoshme ndërhyrja e qiellit në shkatërrimin e këtyre popujve. Kështu, në Kur'anin Kerim, na transmetohet:

" فكلأ أخذنا بذنبة فممنهم من أرسلنا عليه حاصبا و منهم من أخذته الصيحة و منهم من خسفنا به الأرض و منهم من أغرقنا و ما كان الله ليظلمهم و لكن كانوا أنفسهم يظلمون "

"Kështu, secilin e kemi dënuar sipas mëkateve të tyre: disa prej tyre, u kemi dërguar furtunën (e përzier) me gurë ²⁰. Disave u kemi lëshuar zë të madh tmerrues²¹, disa të tjerë i ka gëlltitur toka²², kurse disa i përmbytëm²³. All-llahu nuk ju bëri atyre padrejtësi, por ata i bënë mizori vetvetes së tyre."²⁴

Por, shtrohet pyetja: si u largua njerëzimi nga rruga e drejtë, ndërkohë që e kish pasur programin hyjnor me vete? Këtë, na e tregon All-llahu i Lartësuar. Ne jemi betuar në emër të veteve tona, duke qenë ende në botën e Dherr-it²⁵:

¹⁸ Atij që nuk ju pranua kurban

¹⁹ Kur'an, Maide / 30

²⁰ Populli e Luti u dënua me këtë dënim

²¹ Popullit të Themudit dhe Shuajbit

²² Si në rastin e Karunit, pjesëtar i popullit të Musait a.s.

²³ Popullin e Nuhut, dhe Faraonin e kohës së Musait a.s.

²⁴ Kur'an, 29 / 50 ?

²⁵ Alemu al Dherr – është bota e atomeve. Në këtë rast aludohet për shpirtërat tanë, kur ne ishim krijuar, para se të zbrisnim në jetën e këtij planeti. All-llahu i ka tubuar të gjithë, dhe ka kërkuar prej tyre që të

Në lidhje me këtë, i Lartësuari thotë:

31

" و اذ اخذ ربك من بني ادم من ظهورهم ذريتهم و أشهدهم علي أنفسهم ألسنت بربكم قالوا بلي شهدنا أن تقولوا يوم القيامة انا كنا عن هذا غافلين. او تقولوا انما أشرك عابائونا من قبل و كنا ذرية من بعدهم أفتهلكنا بما فعل المبطلون "

“(Përkujtoni kohën) Dhe kur Zoti yt, nxori nga ijet (kryqet) e bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe kërkoi të dëshmojnë për vetvetet e tyre: “A nuk jam Unë Zoti juaj?” “(Njerëzit) Thanë: po gjithësesi, ne këtë e dëshmojmë” që të mos thoni në Ditën e Ringjalljes “Ne për këtë nuk kishim fare dijeni”.

Apo të thoni: “Prindërit tanë ishin politeistë para nesh, ndërsa ne ishim gjenerata pas tyre. Vallë, do të na dënoje për atë se ç’bënë të degjeneruarit !?”²⁶

Largimi nga programi i All-llahut, vjen në dy forma, ose rrugë. Rruga e parë, vjen prej injorimit të programit. Ndodh që të harrohet, apo të devijohet e vërteta e programit, apo kemi të bëjmë edhe me tradhëtira. Dikujt i teket të flasë në emër të All-llahut, ndërkohë që ato, që thotë, nuk janë fjalët e All-llahut. Për shkak të pasioneve njerëzore, grupi që ka harruar se çfarë i është paraqitur prej programit të All-llahut, ndjek dhe pëlqen atë drejtim, ndërsa ata që nuk e kanë harruar programin, e shtrembërojnë drejtimin dhe njollosin programin e vërtetë. Ata, që devijojnë rrugën, sjellin mendime njerëzore, e këto ia atribuojnë thënieve të All-llahut të Lartësuar. Për këtë arsye, i Lartësuari në Kur’anin Kerim, thotë:

" فويل للذين يكتبون الكتاب بأيديهم ثم يقولون هذا من عند الله ليشتروا به ثمنا قليلا فويل لهم مما كتبت أيديهم وويل لهم مما يكسبون "

“ Dhe, mjerë ata, që me duart e tyre shkruajnë Librin, e pastaj thonë: “Kjo është prej All-llahut” që me të, të kenë përfitime të vogla. Dhe, mjerë ata, që me duart e tyre e kanë shkruar, dhe mjerë ata, që në këtë mënyrë fitojnë!”²⁷

Kjo është një injorancë e thellë. Me kalimin e kohës, (ky deformim) bëhet rutinë dhe kështu hyn në zemrat e atyre, të cilët frymëzohen me “programin” e All-llahut xh.sh.

Ndërsa rruga e dytë, është të pasuarit e veprimeve të trashëguara nga të parët (baballarët). Prindërit fillojnë të largohen pak nga programi i All-llahut xh.sh., ndërsa fëmijët e tyre ndjekin hapat e prindërve, dhe madje ua tejkalojnë edhe atyre. Kështu vazhdojnë të devijojnë prej rrugës. Këto devijime bëhen shkak për shtimin e pasioneve dhe përfitimeve të kësaj bote. Pastaj, kjo transmetohet nëpër gjenerata dhe shtresohet si

dëshmojnë për ekzistencën e Tij. Njerëzimi ka dëshmuar dhe e ka pranuar që Ai është Krijuesi i tij. (shënim i përkthyesit)

²⁶ Kur’an, 7 / 172-173

²⁷ Kur’an, 2 / 79

trashëgimi e të parëve të tyre, e kështu me radhë. All-llahu i Lartëmadhëruar, na lë t'a kuptojmë këtë, kur Ai thotë:

" و اذا قيل لهم اتبعوا ما أنزل الله قال نتبع ما ألفينا عليه ءاباءنا أولو كان ءاباؤهم لا يعقلون شيئا و لا يهتدون "

“Dhe kur atyre u thuhet, “Ndiqni revelatën e All-llahut (Kur'anin), ata thonë: ne, do të ndjekim rrugën e prindërve tanë. Por, a nuk ishin prindërit e tyre, që nuk kuptonin asgjë e as që ishin të përdhur !?”²⁸

Pra injoranca ndaj programit, dhe ndjekja e rrugës së baballarëve, janë themelet e mëkateve dhe mosbesimit. Për këtë arsye, dashti All-llahu me vullnetin e Vet, që të na tërheqë vëmendjen për këto dy arsye, të cilat nuk do të jenë të pranueshme në ahiret. Neve na është tërhequr vërejtja, qysh kur kemi qenë në botën e Dherr-es, për arsye që askush të mos të ketë mundësi polemike në Ditën e Gjykimit, duke i përdorur këto dy argumente.

Muhammedi a.s., mëshirë për besimtarët dhe mosbesimtarët

Qielli ka ndërhyrë gjithmonë tek ata popuj, që e lëshonin rrugën. Me këtë ndërhyrje kuptohet shkatërrimi tyre. Kjo vazhdoi derisa i zbriti mesazhi Muhammedit s.a.v.s. Me ardhjen e tij, u ndërpre ndëshkimi nga qielli, për mosbesimtarët në këtë botë. Kjo ndodhi për dy shkaqe:

Shkaku i parë është se Muhammedi s.a.v.s. është dërguar mëshirë për botërat²⁹. Këtu përfshihen si besimtarët, ashtu edhe jobesimtarët. Kjo mëshirë i është dhuruar secilit, që ka lirinë e të shprehurit në këtë botë. Këtyre u është hapur dera e pendimit. Pra, u është hapur të gjithëve, deri në momentin e fundit të jetës së tyre.

All-llahu i Lartëmadhëruar i pranon pendimet e të gjithë robërve të Tij, derisa të vazhdojë jeta në tokë. Kjo mëshirë është e vlefshme deri në atë kohë, kur do të lindë dielli nga perëndimi – pra kur të fillojë kataklizma.³⁰ Kjo mëshirë, i është dhuruar secilit njeri, për hir të zotërisë së njerëzimit, Muhammedit s.a.v.s.

Ndërsa, shkaku i dytë, është se All-llahu i Lartëmadhëruar ka siguruar se Ummeti i Muhammedit s.a.v.s., do t'i ftojë vazhdimisht pabesimtarët në edukim dhe përdhje. Këtë e vërteton thënia e All-llahut xh.sh. në Kur'anin Kerim, ku Ai thotë:

" كنتم خير أمة أخرجت للناس تأمرون بالمعروف و تنهون عن المنكر و تؤمنون بالله "

“Jeni ummeti³¹ më i mirë që jeni nxjerrë për njerëzimin. Besuat All-llahun, urdhëroni në (vepra) të mira dhe ndaloni në (vepra) të këqia...”³²

²⁸ Kur'an, 2 / 170

²⁹ Muhammedi s.a.v.s. është i dërguar për mbarë njerëzimin, si edhe për xhin-ët, (shënim i përkthyesit)

³⁰ Kataklizma – përmbajtje e madhe dhe e papritur – fjalori i gjuhës së sotme shqipe

Nëse, deri tani, ishim duke shpjeguar të keqen dhe mjerimin në univers, tani duhet domosdo, të trajtojmë kohën tonë bashkëkohore, sepse tani, e keqja dhe mjerimi ndër ne, i ka tejkaluar të gjitha kohërat e mëparshme. Cili është shkaku i këtij mjerimi?

Shkaqet e mjerimit vijnë për shkak të lënies së programit të All-llahut, nga ana e njerëzve, të cilët e zëvendësuan atë me programet e tyre, që ne i quajmë ligje pozitiviste. Mbi bazën e këtyre ligjeve funksionon shumica e shteteve të botës, dhe kështu, u devijuan ligjet që vinin nga programi i All-llahut të Lartësuar, i cili ishte për të mirën njerëzore dhe të universit.

Ky është sekreti i mjerimit dhe i plogështisë që po përjeton bota sot, edhe pse kemi të bëjmë me një qytetërim dhe zhvillim shumë të madh teknologjik dhe shkencor.

Sado e shkathët dhe e aftë qoftë, mendja e njeriut është e cekët dhe e kufizuar. Sado që njerëzit të arrijnë në përparimin e shkencës, atyre ju zbulohen gjëra të reja. Mendja njerëzore nuk mund t'i zgjidhë të gjitha problemet që na rrethojnë. Këtë na e vërteton edhe ndryshimi permanent i ligjeve pozitiviste, pasi pa mbaruar ende një vit, ligjet ndërrohen, pasi duhet të zëvendësohen me të tjera “më të mira”.

Ky ndryshim, vjen si rezultat i mungesës së njohurive gjithëpërfshirëse, prandaj njerëzit detyrohen t'i zëvendësojnë ato “ligje”, dhe kështu jeta shkon duke zëvendësuar të zëvendësuarën. Ne jemi dëshmitarë të kësaj tolerance nga ana e All-llahut xh.sh. Kjo, mbase, bëhet vetëm për të qenë dëshmitarë të ndryshimeve të tyre, dhe kjo do të jetë argument dhe vërtetim për mendjelehtët dhe mendjekufizuarit. Me këtë, vërtetohet se ata nuk janë kompetentë të sjellin legjislacion të përshtatshëm për jetën njerëzore.

Njeriu nuk ka kohë të mendojë dhe të studiojë prej ngarkesës dhe dinamikës jetësore që ka, si edhe prej anarkisë së ligjeve që ekzistojnë në botë. E pyes shpesh veten, pse nuk duam ta praktikojmë programin e All-llahut, kur Ai është më i Dituri, dhe Atij nuk i shpëton asgjë pa ditur, qoftë e vogël ose e madhe!? Ai, që e krijoi njeriun, e di më mirë se çfarë i duhet dhe i nevojitet atij. Prodhuesi i një objekti, e di më mirë se të gjithë të tjerët, se ku, dhe si duhet të sigurohet ai objekt. Ne, në jetën tonë njerëzore, nëse duam që t'a riparojmë një mjet, së pari shkojmë tek prodhuesi i atij mjeti, ose tek katalogu të cilën e ka përgatitur vetë prodhuesi. Aty mbështetemi, pasi ajo është regullorja e sigurimit të mjetit, ose shkojmë tek personi që ka marrë mësim praktikë nga prodhuesi i mjetit, dhe aty e bëjmë riparimin.

Ne kështu po kundërshtojmë vetveten. Ne nuk duam të shkojmë tek programi i All-llahut (prodhuesi) e t'i ndjekim udhëzimet e Tij, për qenien tonë, ashtu siç ndjekim rregullat kur kemi të bëjmë me mjetet e jetës sonë të përdishme. Në këtë rastin e fundit ne riparimet i bëjmë tek pronari i atij mjeti dhe programin për mbikqyrje e marrim prej tij, ashtu siç ai e ka përshkruar për ne. Pra, ky është shkaku i parë i së keqes dhe mjerimit në botë.

³¹ Ummeti, bashkësia ose komuniteti

³² Kur'an, 3 / 110

Disa shtete, janë zhgënjyer prej ligjeve pozitiviste, që kanë votuar për veten e tyre. Ata i kanë zëvendësuar ish-amandamentet e tyre prej ligjit të All-llahut, duke e shlyer dënimin me vdekje. Më vonë, filluan të vajtojnë, sepse u penduan për shkak të rritjes së tepërt të krimeve dhe vrasjeve në shoqëritë e tyre. Nuk kishin rrugëdalje tjetër, kështu që u detyruan që të kthehen përsëri tek programi i All-llahut, i Cili e ka caktuar dënimin me vdekje, për ata që e meritojnë.

Kështu është edhe me shkurorëzimin. I Lartëmadhëruari e ka lejuar shkurorëzimin. Ai, në Kur'anin Kerim, thotë:

"الطلاق مرتان فامساك بمعروف او تسريح باحسان"

“(Gruaja) mund të shkurorëzohet³³ dy herë, e (pastaj) ose jetë e njerëzishme (bashkëshortore), ose shkurorëzohuni me mirëkuptim...³⁴

Por kisha katolike, solli një ligj që e ndaloi shkurorëzimin, duke thënë se: martesë është e përjetshme dhe nuk duhet të ketë shkurorëzim. Ky është një ligj pozitivist. A zgjati ky ligj? Jo, asesi. Ky ligj solli dëshpërim të madh dhe mundime të tepërta për shkak të problemeve të panumërta familjare, etj. Prandaj, katolikët e detyruan kishën që ta lejojë shkurorëzimin. Ky ndryshim nuk ndodhi për shkak të besimit (imanit) që kishin për fenë islame, por ishte një kthim i detyrueshëm. Jeta nuk mund të parashihet pa këtë ligj. Ka raste, kur jeta bashkëshortore bëhet e padurueshme. Midis çifteve ndodhin probleme dhe i vetmi shërues, për këto çifte, mbetet shkurorëzimi.

Sot kisha katolike e ka lejuar shkurorëzimin, sepse në Romë shkonin mbi 20 mijë ankesa për shkurorëzim, vetëm në një ditë të vetme.

Ndërsa, sa i përket gjidhënies, All-llahu i Lartëmadhëruar thotë:

"والوالدات يرضعن اولادهن حولين كاملين لمن اراد أن يتم الرضاعة"

“Nënat le t’u japin gjë fëmijëve të tyre plot dy vjet, për ata që dëshirojnë që gjidhënia të jetë e plotë...³⁵

Perëndimorët filluan të propagandojnë se gjidhënia artificiale është më e mirë dhe më e dobishme për foshnjën. Menjëherë pas kësaj propagande, u krijuan fabrika të mëdha të qumështit për fëmijë. Gjithashtu, thonin se qumështit po i shtojnë edhe disa preparate shtesë vitaminash, të cilat e bëjnë foshnjën më të fuqishme se qumështi natyral i nënës!!

³³ Divorci mund të bëhet dy herë me të drejtë kthimi (nëse të tretën herë, ndodh që gruaja të divorcohet, asaj nuk i lejohej më t’i kthehet atij burri. Do t’i lejohej përsëri martesë me të njëjtin burrë, vetëm atëherë nëse ajo do të martohet me dikë tjetër, pastaj nëse shkurorëzohet edhe prej burrit të dytë, asaj i lejohej t’i kthehet burrit të parë (shënim i përkthyesit)

³⁴ Kur’an, 2 / 229

³⁵ Kur’an, 2 / 233 – sipas Hijes së Kur’anit, të Dr. Feti Mehdiut

Më pas doli se një fëmijë, i cili nuk ushqehet me gjirin e nënës, për dy vjet, mundet të përfitojë sëmundje mendore, të cilat edhe mund ta ç'ekuilibrojnë atë përfundimisht. Krahës kësaj, për mungesë të gjidhënies, fëmijës i shkaktohen disa veti të mosrespektit dhe mosafimit me prindërit. Për të mos thënë se ai përfiton ndjenja të tilla negative, të cilat edhe e largojnë atë prej tyre përfundimisht. Gjithashtu, është vërtetuar se ata bien shumë më lehtë pre e sëmundjeve psikike, dhe kështu, e gjejnë shërimin tek drogat dhe pijet e ndryshme, etj. Nga ankesat e shumta që janë marrë, për këtë lloj sëmundjeje, del se shkaktarët kryesorë kanë qenë prindërit e tyre, për mosafimin prindëror të tyre.

Çuditërisht, ata që dje kërkonin që foshnjat të ushqeheshin me qumësht artificial, tani kërkojnë me çdo kusht, që të kthehet gjidhënia natyrale. Për të realizuar këtë kthim u mbajtën shumë kongrese, të cilat u përpoqën të kthenin bindjen, se foshnja është shumë më e shëndetshme, më normale, më e sigurtë dhe do të ketë një rritje shumë më të natyrshme me gjirin e nënës, se sa me atë artificial.

Shpreh habi që edhe ne, pra bota islame, filloi heshtazi t'a praktikojë ndërrimin e gjidhënies natyrale me atë artificiale, edhe pse ne kemi Kur'anin, programin e All-llahut, i Cili na ka mësuar se gjidhënia është dy vjet, dhe se (kështu) edukimi i fëmijëve tanë do të jetë më i mirë. Ata pasuan në heshtje rrugën e "mirë" dhe ndoqën perëndimorët. Kjo na kushtoi shumë, sepse prej nesh humbën disa gjenerata. Por, është e kotë që ankohe mi për disa gjenerata të "humbura", pasi ne, ende nuk po i thërrasim mendjes, dhe të pranojmë, se ne, ndryshuam programin e All-llahut dhe për këtë shkak i humbëm disa gjenerata.

Tani, pas gjithë kësaj, mund të sjellim dhjetëra shembuj, nëse shtrohet arsyeja rreth mjerimit, që solli përvoja pozitiviste, e cila u largua nga programi i All-llahut xh.sh.

Na thuhet se: prerja e dorës së hajdutit është veprim shtazarak. Por ata harrojnë se Islami, me këtë, ka për qëllim që t'a ndalojë krimin dhe të marrë masa preventive ndaj kriminelit. Sikur ta dinte hajduti se në një shtet (vend) i pritët dora për vjedhje, ai nuk do të vidhte, dhe pikërisht kjo edhe synohet (prej ligjit islam). Por kur hajduti e di se, nëse vjedh, nuk i pritët dora, atëherë hajdutët shtohen, lindin klane kriminelësh të shumtë, sa që e gjithë bota do të pushtohet prej tyre. Tani, veç sa nuk jemi në atë situatë që ta kufizojmë veten për të mos dalë në rrugë, për shkak se siguria është zero, sepse çdo ditë po vriten, me qindra njerëz në botë, duke mos llogaritur të lënduarit.

Sikur t'a praktikonim programin e All-llahut, dhe t'ia pritnim dorën hajdutit, do të zvogëlohej numri i hajdutëve në botë, të mos themi se do të zhdukej fare. Por ne, me ligjet tona njerëzore, po ia shtojmë vetes akoma mjerim, dhe po e ndihmojmë ose po e ngrejmë nivelin e të keqes në botë, pa përfituar asgjë. Përkundrazi, nëse vazhdojmë kështu, e keqja do të shtohet edhe më shumë, për arsye se jemi duke u larguar prej programit të All-llahu xh.sh. Ai me dijen e Tij të pakufizuar, të Cilët nuk mund t'i shpëtojnë asgjë pa ditur, dhe duke qenë se është Krijuesi i qenies njerëzore, është i Vetmi ligjdhënës, sepse ne (njerëzimi), nuk do të mund të gjejmë ligj më të mirë kurrë e kurrës. Programi i Tij, bën që jeta jonë të jetë stabile, e qëndrueshme dhe e drejtë.

E tërë bota sillet rreth një qarku. Atë e ka kapluar e keqja dhe mjerimi dhe ajo nuk po e merr vetveten dhe nuk po gjen drejtimin e duhur për t'i zgjidhur problemet që ka. Pa dyshim se ajo do t'a gjente rrugën, sikur t'i kthehej ligjit të All-llahut xh.sh., qoftë për shkak të imanit, qoftë për shkak të të qenit e detyruar.

Dhe në fund të këtij kapitulli, mendoj se duhet të paraqes dy pika shumë të rëndësishme:

Pika e parë, ka të bëjë me atë që flasin njerëzit, se drejtësia dhe mirësia nuk është e shpërndarë (në mënyrë të njëjtë) në tokë. Disa popuj kanë bollëk dhe tepricë, ndërsa disa popuj të tjerë janë në mjerim, sepse nuk ju mjafton ushqimi për të jetuar.

Pika e dytë, ka të bëjë me ata njerëz, të cilët e shohin të mirën vetëm në pasuri. Atë që All-llahu e ka begatuar me pasuri, mendojnë se ai gëzon kënaqësinë e All-llahut, ndërsa atë që All-llahu nuk e ka begatuar me pasuri, mendojnë se All-llahu është i hidhëruar me të dhe nuk ia pranon lutjet atij.

Këto mendime janë të gabuara. All-llahu xh.sh. ka sjellë në këtë botë furnizim, që do të ishte i mjaftueshëm për të gjitha krijesat, deri në Ditën e Gjykimit. All-llahu xh.sh. i sprovon njerëzit me pasuri. Ndodh që mospasja e pasurisë të jetë hakmarrëse, apo që ajo mos t'a ketë pëlqimin e All-llahut xh.sh. Gjithashtu, ndodh që ajo të bëhet shkaktare për mosbesimin e atij personi (qoftë larg nesh). Njeriu sprovohet në forma të ndryshme.

Kemi prej tyre që mendojnë se janë bosat e botës dhe nuk kanë nevojë për asgjë. Për këtë arsye edhe nuk i luten Zotit. Ata e përfundojnë këtë jetë pa bërë asnjë të mirë të vetme, që do të mund t'u shërbente në ahiret.

Kapitulli i tretë

Imagjinuesi dhe i binduri

Të gjithë njerëzit e kërkojnë të mirën, por pak kush prej tyre e di se cila është e mira e vërtetë dhe ku është ajo e mirë. Në të shumtën e rasteve, njerëzit kërkojnë të mirën e kësaj bote, dhe e harrojnë të mirën e botës tjetër. Ky është një vizion shumë shkurtpamës dhe i ngushtë. Sepse ai, i cili e bën këtë, ka blerë një gjë të imagjinuar, kundrejt vlerës shumë të çmuar që ka. Nuk dyshoj se kjo do të ishte një humbje e madhe dhe ofenduese.

Kemi prindër të cilët sakrifikojnë veten për fëmijët e tyre. Këtë e bëjnë, në mënyrë që fëmijët e tyre të kenë një jetë sa më të mirë në këtë botë. Ata, për hir të kësaj ndjenje, investojnë ndoshta të gjithë pasurinë që kanë. Mundohen t'i sigurojnë fëmijës shkollën më të mirë, edhe pse të ardhurat vjetore i kanë të pakta. Ata do të mundohen (duke kursyer dhe privuar vetveten) që në çdo mënyrë t'ia sigurojnë ato të ardhura. Më pas e regjistrojnë në fakultetin më të mirë, edhe pse ajo barrë materiale vazhdon t'u rëndojë

përmbi supe. Nëse e pyesim prindin: pse vepron kështu? Do të thotë: për t'a ndërtuar ardhmërinë e tij. Për të pasur një jetë të mirë dhe një ardhmëri të mirë. Nëse i themi: ti po e dëmton veten për një gjë që s'është e sigurtë, sepse ti je duke investuar për diçka që po e supozon. Ti, ndoshta, supozon se fëmija yt do të jetojë gjatë dhe do të bëhet një prej figurave më eminente në botë.

Por kush të siguron ty, se kjo do të ndodhë? Kush të siguron ty, se fëmija yt do t'i përballojë të gjitha këto mësimë? Por edhe sikur të arrinte t'i kalonte këto mësimë, kush të siguron ty, se ky fëmijë nuk do të bierë pre e ndonje femre, apo se nuk do të martohej me ndonjë grua, e cila do t'a shfrytëzonte ndjeshëm? Kush të siguron se nuk do t'a mashtrojë atë shejtani, dhe të kthehet kundër teje dhe të t'a shkatërrojë pasurinë, shëndetin dhe të t'a humbë krejt ardhmërinë? Kush të siguron se nuk do t'i afrohet alkoolit, bixhozit apo drogës, dhe veprave të tjera të shëmtuara, e t'a humbë tërë ardhmërinë, dhe t'a shkatërrojë, në këtë mënyrë, të gjithë atë që ti e ngrite me aq mund? Ose së fundi, kush të siguron se nuk është jetëshkurtër? I vjen vdekja dhe gjithë ai mund, që ke bërë, të shkon bosh. Ti po e përgatit për këtë botë. Por, a ke llogaritur për botën tjetër?

A ke investuar për ahiretin e tij, gjysmën apo një çerek, të asaj që ke investuar për këtë botë? A e ke mësuar si të falet, ose t'a lexojë Kur'anin? A e mësove se ç'është sadakaja, amaneti, mirësjellja ndaj të varfërve, nevojtarëve dhe jetimëve? Apo, këto gjëra i ke lënë anash dhe nuk je marrë me to?

Nuk e ke urdhëruar të falet asnjëherë, dhe më vonë ti pret që ai të falet. Nuk i ke folur asnjëherë për pëlqimin e All-llahut, ndërsa më vonë ti pret nga ai që të jetë i respektueshëm. Pra, as nuk e ke mësuar se si t'a ruajë amanetin, as për sadakanë, e as se si duhet të mbrohet nga mizoria. Të gjitha këto gjëra nuk i ke bërë, edhe pse ke qenë i detyruar që t'ia japësh programin e All-llahut, si mësimin e parë të domosdoshëm.

Për ardhmërinë e kësaj bote e mundove veten, investove për fëmijën tënd një investim, për të cilin nuk je i sigurtë, nëse do t'a realizojë, apo nuk do t'a realizojë synimin tënd. Por, pa dyshim, ti, ashtu sikurse edhe fëmija yt, ashtu sikurse edhe të gjitha krijesat e tjera, do të gjykohej në Ditën e Gjykimit. Padyshim se, të gjithë do të merremi në pyetje, dhe padyshim se do të jemi prej atyre që do të kënaqemi në xhennet, ose prej atyre që do të dënohemi me xhehennem.

Ti pra, me sjelljet e tua, i ke vendosur të gjitha forcat e tua në supozimet e tua. Ndërsa ke lënë anash, dhe nuk ke investuar, në gjëra të sigurta, të padyshimta, e që do të ndodhin në momentin kur t'a takojmë All-llahun e Lartëmadhëruar. Sikur të kishe logjikuar dhe të kishe pasur mendje të shëndoshë, ti do të investoje për djalin dhe për mbarë familjen në rrugën bindëse dhe të padyshuar, dhe ky do të ishte një investim i sigurtë. Por, nëse ende mendja jote anon më shumë nga e supozuara, se sa nga ajo e sigurta, kthehu dhe logjiko, ose, të paktën nëse je prej atyre, që gjendesh midis këtyre dy drejtimeve, kthehu përsëri kah e vërteta, e mos u vono.

Jeta e vërtetë

Shumica e njerëzve mendojnë se janë vetë në gjendje t'a përcaktojnë të mirën, por kjo nuk është e saktë. Këtë të vërtetë nuk e përcaktojnë kriteret e kësaj bote, sepse të gjitha këto kritere nuk shërbejnë për të gjykuar, se ku është e mira, e ku e keqja. All-llahu i Lartësuar na ka caktuar neve këtë, kur Ai thotë në Kur'anin Kerim:

"وان الدار الآخرة لهي الحيوان لو كانوا يعلمون"

"...vërtetë, bota tjetër (ahireti) është jeta e vërtetë, sikur ata ta dinin këtë!"³⁶

Pra, Ahireti qenka jeta e vërtetë, për të cilën njeriu duhet të punojë. Pa dyshim se këtë e pranon edhe logjika. Ajo e di se një ditë do të shkojmë atje, dhe do të jetojmë përgjithmonë në të. Jeta e njeriut në këtë botë, ndodh të jetë disa orë, ose edhe më gjatë. Ndërsa, jeta në ahiret do të jetë e përhershme. Të mirat e kësaj bote mund të zhduken, gjithashtu, edhe ti vetë do të zhdukesh me vdekjen, ndërsa të mirat dhe begatitë e ahiretit nuk zhduken kurrë, ato qëndrojnë përgjithmonë.

Por ne, a e marrim jetën si të tillë? Një pakicë e vogël prej nesh, e bën këtë. Ndërsa shumica e tyre, llogarisin vetëm të mirat e kësaj bote. Ata të mirën e shohin tek pasuria, personaliteti dhe pozita në këtë botë, dhe përveç këtyre nuk dinë ndonjë të mirë tjetër.

Shumëkush mendon se ai që ka pasuri, dhe që ka risk të madh, është nën hijen e kënaqësisë së All-llahut xh.sh., ndërsa ai që nuk ka pasuri, por përkundrazi ka risk të pakët, mendon se All-llahu është i hidhëruar me të. Për këtë, All-llahu xh.sh., në Kur'anin Kerim thotë:

"فأما الإنسان إذا ما ابتلاه ربه فأكرمه و نعمه فيقول ربي أكرمن وأما إذا ما ابتلاه فقدر عليه رزقه فيقول ربي أهانن كلا بل لا تكرمون اليقيم ولا تحاضون علي طعام المسكين و تأكلون التراث أكلا لما و تحبون المال حبا جما "

"Ndërsa njeriu, kur sprovohet prej Zotit të tij, (Ai) e nderon atë dhe i dhuron begati (ky njeri me plot elan dhe mburrje) thotë: "Zoti im, më ka nderuar"³⁷. Por, kur atë do t'a sprovojë me mungesë të riskut, (kur ia zvogëlon furnizimin, ky njeri do të) thotë: Zoti im, më ka përulur (nënçmuar). Jo, asesi! Por ju nuk po respektoni bonjakun (jetimin). Dhe nuk keni inkurajuar njëri-tjetrin për t'i ushqyer të varfërit. Kurse trashëgiminë e hanit me ëndje. (Mjerisht) edhe pasurinë e donit për së tepërmi".³⁸

Tek këto ajete kur'anore, doemos, duhet të ndalemi pak më shumë. All-llahu është duke ia përmirësuar njeriut të kuptuarit e vërtetë të së mirës dhe së keqes. Sepse, nga këndet prej të cilave shumica e njerëzve gjykon, shumica e tyre gabon. All-llahu i Lartësuar thotë:

³⁶ Kur'an, 29 / 64

³⁷ Populli ynë thotë e paska parë Zoti !

³⁸ Kur'an, 89 / 15-20

" فَأَمَّا الْإِنْسَانُ إِذَا مَا ابْتَلاَهُ رَبُّهُ فَأَكْرَمَهُ

"Ndërsa njeriu, kur sprovohet prej Zotit të tij, (Ai) e nderon atë..."

Kjo jep të kuptohet se e mira vazhdimisht e rrit riskun, çdo gjë që vjen në këtë botë është sprovim prej All-llahut të Lartësuar, për robërit e Tij. Sprovimi është provim. Sprovimi në vetë brendinë e tij, nuk do të thotë se ai person është i denigruar. Ajo që e bën të denigrueshëm, ose të falënderueshëm, është vetë rezultati.

All-llahu xh.sh. i sprovon robërit e Tij në këtë botë, si me të mira ashtu edhe me të këqija, ose me atë, që ata mendojnë se është e mirë, ose me ato gjëra, që ata i njohin si të këqija. Këtë e vërteton thënia kur'anore:

" وَنَبْلُوَكُمْ بِالْشَّرِّ وَالْخَيْرِ فِتْنَةً "

"...Ne do t'ju testojmë, duke ju sprovuar me të këqija dhe me të mira..."³⁹

Ashtu siç konsiderohet e keqja provim për njeriun, në të njëjtin rangim është edhe e mira. Sepse jeta, në tërësi, në këtë botë, është e mbushur me sprovime dhe provime për njerëzimin. Kur Robi i Mirë, ia solli Sulejmanit a.s. fronin e mbretëreshës Belkizë sa hap e mbyll sytë, ai (Sulejmani) e kuptoi se All-llahu po e sprovonte. Ku është këtu sprovimi ose provimi? Sulejmani a.s.e kuptoi se kishte më të ditur se ai, në këtë botë. Ai ishte Robi i Mirë, i cili ia solli atij fronin mbretëror të Belkizës, sa hap e mbyll sytë.

Sprova këtu ishte për Sulejmanin a.s., i cili e kuptoi se ishte dikush tjetër prej robërve të All-llahut xh.sh., që ishte më i ditur se ai në shkencë. Në këtë situatë ai (Sulejmani) ishte i lirë, - ose të ishte njëri prej atyre që do t'a falenderonte All-llahun e Lartësuar, dhe të mos bëhej xheloz për të kërkuar më tepër se sa i kishte dhënë prej mbretërisë, dhe ta kuptonte se All-llahu xh.sh. i jep kujt të dëshirojë, sa të dëshirojë dhe të mos mendonte se ai qëndronte mbi gjithë të tjerët, pasi çdo mendim tjetër do të konsiderohej fillimi i mosbesimit (Zoti na mbroftë prej tij), - ose do të shkatërrohej i tëri, duke i thënë All-llahut: O Zot, më nënçmove me këtë rob, pasi ma dhe mua tërë këtë mbretëri! Në këtë rast, sikur të ndodhte kjo, ai do të ishte mosmirënjohës ndaj All-llahut dhe do të bëhej pabesimtar.

Sulejmani a.s., u paralajmërua për këtë sprovim, për këtë arsye ai vetëm tha, ashtu siç thotë Kur'an Kerim:

" وَمَنْ شَكَرَ فَإِنَّمَا يَشْكُرُ لِنَفْسِهِ "

"...pra, kush falënderon, do të falënderojë për veten e tij..."⁴⁰

Kjo do të thotë se ai ishte falenderues ndaj All-llahut xh.sh., edhe pse Atij nuk i shtohet gjë prej pasurisë së Tij, nëse e falënderon Atë. Nëse e lartëmadhërojnë, ose i përkulen

³⁹ Kur'an, 21 / 35

⁴⁰ Kur'an, 27 / 40

Atij, kjo aspak nuk ia shton fuqinë All-llahut xh.sh. All-llahu është i Përkryer dhe Absolut. Falënderimi kthehet tek vetë ai që e ka falenderuar, me sevapet të cilat ia jep All-llahu atij, kur e shpërblen me të mira. Kështu është edhe me mosbesimin. Atë, mosbesimi njerëzor nuk e dëmton aspak, sepse All-llahu është Absolut dhe i Përkryer.

Sikur të gjitha krijesat e All-llahut t'a mohonin Madhërinë e Tij, Atij nuk i bëhet asnjë dëm në Pushtetin e Tij. Ai është më i pasuri nga të gjitha botërat. Për këtë arsye, All-llahu xh.sh. thotë:

"ومن كفر فان ربي غني كريم"

"...e kush mohon, (dijene se) Zoti im është më i pasuri (nuk ka nevojë për asgjë) dhe është bujar."⁴¹

Kur All-llahu i Lartëmadhëruar e begaton njeriun me mirësira të shumta, ai thotë: *"Zoti im më ka nderuar"*. Ndërsa kur e sprovon njeriun me risk, e ai mbetet keq materialisht, thotë: *"Zoti im më ka përulur (nënçmuar)."*⁴²

Këto janë standartet njerëzore rreth të mirës dhe të keqes. Kur dikush fiton dhe i shtohen begatitë, ai mendon se të gjitha këto janë mirësi, dhe konkludon se All-llahu xh.sh. është i kënaqur me të. Ndërkaq, kur ai nuk fiton, mendon se All-llahu është i hidhëruar me të, dhe se Ai nuk është i kënaqur me veprimtarinë e tij.

All-llahu xh.sh. na tregoi se këto mendime janë të gabuara tek njerëzit dhe për të na i përmirësuar ato, na thotë: "Jo"! Pra, ne jemi duke i kuptuar ato gabimisht. Pasuria e madhe dhe mirësitë nuk duhet të konsiderohen se janë pëlqime të All-llahut, e as skamja dhe varfëria nuk duhet të konsiderohen se janë hidhërime të All-llahut, por ne duhet t'a kuptojmë, se të dyja ato, janë sprovë për njerëzit. Ata duhet të jenë dëshmitarë të vetes së tyre, në Ditën e Gjykimit. A pranohet vallë vendimi i All-llahut, vetëm me anë të pajtimit dhe falënderimit, apo pranohet me anë të mosbesimit dhe refuzimit?!

Pastaj, i Lartëmadhëruari, na tregoi shkaqet e largimit të begative prej njeriut, shkaqet të cilat i pakësojnë begatitë ose bëjnë që ato të humbasin krejt prej tyre.

Shkaku i parë: All-llahu xh.sh., në Kur'anin Kerim, na mësoi kështu: **"Jo, asesi! Por ju nuk po i respektoni jetimët"**. All-llahu xh.sh. e ka paraparë që jetimit t'i jepet haku, e me këtë kuptohet të kujdesurit apo të mbikqyrurit e jetimit. Përbuzja apo nënçmimi i jetimit është njëri prej shkaqeve të largimit të begatisë. Pse? Për shkak se udhëheqësi i shoqërisë duhet t'a mbrojtë të dobëtin nga arroganca e të fuqishmëve. Jetimi, është ai, i cili e ka humbur babanë, duke qenë i vogël. Ai, pa atë (babanë), është i thyer, i dobët dhe i shkretë. Njeriu e ka shumë lehtë që t'ia marrë pasurinë atij dhe t'a shpërdorojë atë. Ai e ka të lehtë të bëjë me të çfarë të dojë, sepse ai (jetimi) nuk ka forcë, e as mudësi që t'i kundërpërgjigjet.

⁴¹ Kur'an, 27 / 40

⁴² Pra, populli, gjithashtu, thotë: Zoti se paska parë...

All-llahu xh.sh. dëshiron që secili të jetojë i qetë në shoqërinë islame, dhe që t'i rritë fëmijët e tij pa brenga, pa marrë parasysh, a është apo nuk është prezent në shtëpi, apo nëse ka ndërruar jetë. Ai, për këtë arsye, i ka ngritur në shkallën më të lartë ata, që i mbështesin ose kujdesen për jetimët. Madje, edhe sikur t'ia fshish kokën me butësi mallëngjyese jetimit, do të fitosh të mira të shumta, për arsye se ia ke ledhatuar kokën me ngrohtësi. All-llahu xh.sh. ka për të shpërblyer për secilën qime që ia ke ledhatuar.

All-llahu xh.sh. ka paralajmëruar, se shpërblimet më të mëdha, do t'u takojnë atyre që kujdesen për jetimët dhe i përkëdhelin ata. Për përbuzjen e jetimëve, dënimi nuk do të jetë vetëm në ahiret, por dënimi do të jetë edhe në këtë botë. Për këtë arsye, All-llahu i Lartëmadhëruar ua injoron dhe ua zvogëlon pasurinë atyre njerëzve, që i përbuzin jetimët, apo tregohen të ashpër me ta.

Lexo thënien e All-llahut xh.sh. :

"أرعبت الذي يكذب بالدين فذلك الذي يدع اليتيم"

"A e pe atë (njeri), që përgënjeshtroi fenë⁴³. Po ai (njeri) dëbon vrazhdë bonjakun (jetimin)."⁴⁴

Një musliman, sjelljet dhe paraqitjet e ashpra ndaj jetimit, nuk mund t'i kapërdijë, pasi një person i tillë klasifikohet prej atyre që e kanë përgënjeshtruar fenë.

Shkaqet e largimit të begative

All-llahu xh.sh. na mëson edhe një shkak tjetër, i cili shkakton largimin e begatisë, duke na thënë:

"و لا تحاضون علي طعام المسكين"

"...Dhe nuk keni inkurajuar njëri-tjetrin për t'i ushqyer skamnorët..."⁴⁵

Pra, nuk keni inkurajuar njëri-tjetrin për t'i ushqyer skamnorët, ata që nuk kanë ushqim të bollshëm. Disa njerëz mendojnë se skamnor, është ai person, i cili nuk posedon asgjë mbi vete. Por jo, skamnor është edhe ai, i cili nuk ka aq sa i nevojitet. Këtë e vërteton thënia e All-llahut të Lartëmadhëruar:

"أما السفينة فكانت لمساكين يعملون في البحر"

"Ndërsa, sa i përket anijes, ajo u takonte disa skamnorëve që punonin në det"⁴⁶

⁴³ Fjala është për ata persona, që refuzojnë Ditën e Gjykimit, në ahiret

⁴⁴ Kur'an, 107 / 1-2

⁴⁵ Kur'an, 89 / 18

Pra, skamor është ai, i cili nuk posedon mjete për jetesë, aq sa ai ka nevojë. Sepse All-lahu, ata njerëz i quan të skamur edhe pse, ata kishin në dispozicion një anije.

Nga shkaqet e tjera të largimit të pasurisë është edhe amullia mes njerëzve, nganjëherë mosinkurajimi, dhe jo vetëm kaq, por ndonjëherë propagandohet që të skamurve të mos t'u ndihmohet, qoftë edhe me ushqim (kafshata buke). Kush kërkon ushqim, nuk është gënjeshtar për atë që kërkon, sepse një nevojtar që kërkon prej teje para, mund të jetë prej tyre që grumbullon para për t'u pasuruar, kur ai të kërkon rroba, mund të mos ketë nevojë për to, por i do ato për t'i shitur. Ndërsa ai, i cili të kërkon bukë për të ngrënë, padyshim se është i uritur, sepse nuk ka për të ngrënë, prandaj edhe kërkon bukë, prandaj ne kësaj i themi: kërkesë e drejtë, e jo e gënjeshtër. Ndërsa ata, që pengojnë për t'i ushqyer skamnoret, kanë bërë krim dhe mëkat të madh, pasi ata bëhen shkaktarë që skamnoret të mos u jepet ushqim.

Për këtë, All-llahu xh.sh., thotë:

"وَتَأْكُلُونَ التَّرَاثَ أَكْلًا لَمًا وَتَحِبُّونَ الْمَالَ حُبًا جَمًّا"

"...Kurse trashëgiminë e hanit me ëndje. (Mjerisht) edhe pasurinë e donit për së tepërmi."⁴⁷

Edhe kjo sjellje, gjithashtu, konsiderohet një prej atyre që të largojnë nga begatia (nimeti). Të hani trashëgiminë në mënyrë të padrejtë! Si mund të hahet ajo, që i është përcaktuar dikujt tjetër. T'a hani hakun e tjetërkujt, ndërkohë që ata janë të vegjël! Ose të ëndërrosh që të marrësh një pjesë të trashëgimisë së tyre, sepse ju keni qenë i rritur, në kohën kur pronari i pasurisë ka ndërruar jetë. Dhe të kesh guxim që të manipulosh, pa u frikësuar fare, se do të zbulohesh një ditë prej njerëzve të tjerë. Duke qenë se të ishte dhënë mundësia të mbizotëroje në këtë situatë, ti e keqpërdore, dhe arrite të përvetësosh një "pasuri" të ndaluar. All-llahu do të dënojë në këtë botë, sepse Ai do t'a largojë begatinë prej teje, ndërsa llogarinë (ndëshkimin) e plotë do t'a marrësh në ahiret.

Pasuria është punësim në jetë

Dashuria për pasurinë e motivon pronarin që të grumbullojë sa më shumë thesare. Ky "hob" bën që shumë persona t'a humbin punën në jetë. Për të fituar pasurinë, njeriu duhet të punësohet. Ky punësim mundëson qarkullimin e jetës. Nëse njeriu ndalohej që të punësohet, ky qarkullim do të shthuret, sepse ndalen apo mbyllen dyert e riskut për njerëzit. Njeriu, për secilën pasuri që e jep (e investon), hap dyert e riskut (për të tjerët) në shoqëri, qoftë ky veprim i dëshiruar, apo i padëshiruar, qoftë me qëllim, apo pa qëllim. Nëse dikush dëshiron të ndërtojë p.sh. një ndërtesë, atij, ndoshta, nuk i shkon ndërmend se sa e ndihmon shoqërinë (pasi aty punësohen shumë njerëz), por dëshira e tij është që

⁴⁶ Kur'an, 18 / 79

⁴⁷ Kur'an, 89 / 19-20

ai, të jetë pronari i ndërtesës, dhe dëshiron të investojë, pasi ai, në këtë botë, e ka siguruar veten prej së keqes, që vjen prej varfërisë.

Ai, vërtet, i hap dyert e riskut, sepse do t'a paguajë arkitektin për t'ia skicuar projektplanin, do të paguajë pronarët e tokave, në të cilat do të ngrejë godinën, do t'i paguajë dhe ata që do të gërmojnë tokën për hapjen e themeleve të godinës, gjithashtu, do të paguajë edhe të gjithë ata, që do të merren me mjeshtërinë e ndërtimtarisë, kush me hekur, e kush me beton. Më pas, vijnë edhe muratorët, e kështu me radhë kryerësit e të gjitha punimeve të vrazhгета të ndërtimtarisë. Kemi pastaj, mjeshtërit e tjerë, që merren me shtrimin e pllakave, parketit, banjove, interiorin, e kështu me radhë... Këtu janë të angazhuar edhe të gjithë ata, që merren me sigurimin e lëndës së parë, sikurse janë fabrikat e çimentos, tullave, hekurit, xhamave, aluminit etj...

Me këtë veprim, vërtet, hapen dyert e riskut për mijëra punëtorë, për qindra mjeshtër dhe për dhjetra fabrika, kështu jeta qarkullon dhe shoqëria gjallëron. E tërë shoqëria fiton, edhe pse ti ndërtove një ndërtesë ose kompleks ndërtesash, pa të shkuar fare ndërmend se, realisht, me ty, ka fituar dhe është gjallëruar e gjithë shoqëria. Përderisa ti investove, të tjerët patën qarkullim, patën gëzim dhe gjithashtu e shijuan jetën. Sikur ti të mos e realizoje këtë projekt, pasuria do të qëndronte e grumbulluar tek ti, ndërsa shoqëria do të vazhdonte të vuante dhe të përkeqësohej.

Nëse i ndalon paratë prej qarkullimit të tyre, duhet t'a dish se ke bërë një mëkat të madh, ndaj së drejtës së shoqërisë dhe të mbarë njerëzimit (për të pëftuar të mira dhe dobi prej tyre). All-llahu xh.sh. nuk do që shoqëria islame të jetë e varfër, e vyshkur dhe me risk të ngushtuar. Nëse, vërtet, je i dashuruar pas pasurisë, i Dashuri yt xh.sh., dëshiron gjithmonë të jetë me ata, të cilët e duan Atë! Pasi, nëse ti, do t'i spostosh në një vend, që ato (paratë) t'a ndiejnë veten si të burgosura, që ato të mos mundin t'a kryejnë detyrën e vet, atëherë çfarë do të ndodhë (si do të vejë halli) me ty në Ditën e Gjykimit?

All-llahu i Lartëmadhëruar, për këta grumbullues të thesareve, thotë:

"والذين يكنزون الذهب و الفضة ولا ينفقونها في سبيل الله فبشرهم بعذاب اليم. يوم يحمي عليها في نار جهنم فتكوي بها جباههم و جنوبهم و ظهورهم هذا ما كنزتم لأنفسكم فذوقوا ما كنتم تكنزون"

"...gjithashtu, ata, të cilët e grumbullojnë floririn dhe argjendin dhe nuk e shpenzojnë në rrugë të All-llahut, përgëzoji me një dënim të dhembshëm. Atë ditë, kur ajo (pasuri e deponuar- në thesar) do të skuqet në zjarrin e xhehennemit, pastaj me të, do t'iu lyhet balli, krahët dhe shpina. Ky ishte (shpërblimi) për atë, që kishit grumbulluar për vetet tuaja, shijojeni pra, atë që keni grumbulluar."⁴⁸

Dashuria për pasuri, e bën njeriun që t'a gjejë atë, në çdo mënyrë. Kjo nuk e ndalon atë (njeriun) as nga hallalli, e as nga harami, as nga e mira, e as nga e shëmtuara. Njeriu e grumbullon pasurinë prej çdo këndi, që i mundësohet, pa marrë parasysh prejardhjen e saj. Atij kjo nuk i intereson, ajo që është me rëndësi tek ai, është që pasuria të shtohet sa më shumë, edhe pse ajo që ai vepron, e ndalon dashurinë e All-llahut ndaj tij. Madje,

⁴⁸ Kur'an, 9 / 34-35

njeriu formon edhe klanin e vet për t'ia shtuar shoqërisë vuajtjet edhe më tepër (për shkak të padrejtësive që bën). Por dijeni se, kur çdo gjë e bëni në emër të pasurisë, atëherë All-lahu do t'ua marrë atë pasuri, dhe do t'a largojë begatinë nga ju.

HERE Pasuria dhe shoqëria janë begati apo sprovë?

Njerëzit besojnë se e mira qëndron tek pasuria, por kjo nuk është aspak e vërtetë. Ndodh që pasuria të bëhet sprovë për ty, në vend që ajo të ishte mirësi për ty. Ndërsa, ti mendon në vetvete, se je në rregull me Zotin tënd (pra se gëzon kënaqësinë e Tij), për shkak të pasurisë, shoqërisë ose pushtetit që ke. Por gabohesh, sepse mund të ndodhë që të gjitha këto që ti i posedon, nuk konsiderohen si të pëlqyera tek i Lartëmadhëruari.

All-lahu xh.sh.e ka përshkruar mjaft saktë, këtë ndjenjë njerëzore, në Librin e Tij të madhëruar. Ai na ka dhënë shembuj të shumtë, se pasuria mund të bëhet shkak i mosbesimit, i diktaturës dhe i ngasjes për mëkate nga ana e njerëzve. Shembuj të tillë ka shumë, por ne do të përkujtojmë vetëm disa prej tyre.

Lexoni thënien e All-lahut xh.sh., kur thotë:

"الم تر الي الذين حاج ابراهيم في ربه أن اعطاه الله الملك اذ قال ابراهيم ربي الذي يحي و يميت قال أنا احي و أميت قال ابراهيم فان الله يأتي بالشمس من المشرق فاتي بها من المغرب فبهت الذي كفر و الله لا يهدي القوم الظالمين"

"A nuk i pe, ata, që u fjalosën me Ibrahimin për Zotin e tij? Atij, që All-lahu i kishte dhënë pushtet?"⁴⁹ Atëherë, kur Ibrahim i tha: "Zoti im është Ai, i Cili jep jetë dhe merr jetë (ngjall dhe vdes)", ai iu përgjegj (me arrogancë): "(edhe) unë ngjall dhe vdes! (jap dhe marr jetë)". Ibrahim i tha: Vërtet, All-lahu ka bërë që dielli të dalë në lindje, bëje ti që ai (dielli të lindë) nga perëndimi! Ai, mosbesimtari u shtang! All-lahu, pra, nuk udhëzon (në rrugë të drejtë) popullin mizor."⁵⁰

Ne nuk na intereson se kush ishte ai person konkretisht, sepse Kur'an i nuk meret me personalitetin dhe historikun e tij, por Ai na tregon cilësitë e imanit të tij. Tregimet e Kur'anit Kerimit janë të vlefshme për secilën gjeneratë, sepse ngjarjet përsëriten nëpër gjenerata. Ato shtegtojnë nga një vend, në një vend tjetër. Tregimet e Kur'anit janë të përgjithësuara, ato nuk merren me vetë ngjarjen, për të nxjerrë heronj prej tyre. Në Kur'an, është bërë përjashtim vetëm në rastin e tregimit të Merjemes, bijës së Imranit, nënës së Isaut (All-lahu qoftë i kënaqur me ta). Ky është tregimi i vetëm, që është veçuar nga All-lahu në Kur'an, sepse kjo ngjarje nuk do të përsëritet më kurrën e kurrës.

Ibrahimi a.s. i shkoi këtij njeriu për t'a udhëzuar, dhe i ofroi atij programin e All-lahut xh.sh., por ai iu kundërvu argumentave të tij. Këtij personi, All-lahu xh.sh., i kishte dhënë mbretëri. Duke qenë se ishte mbret, ai kishte elitën e tij, pushtet të madh dhe pasuri të tepërta. Ai duhej të ishte falenderues ndaj All-lahut xh.sh., për gjitha ato mirësi dhe

⁴⁹ Fjala është për Nemrudin, mbretin e popullit të Ibrahimit (shën. i përkth.)

⁵⁰ Kur'an, 2 / 258

begati që Ai i kishte dhënë, dhe duhej t'a pranonte se të gjitha ato, ishin dhuratë prej All-llahut, por përkundrazi, ai u paraqit arrogant, mosmirënjohës dhe, qysh në fillim, filloi të polemizojë me Ibrahimin a.s. Kuptohet se argumentet e tij ishin argumente të një pabesimtari. Mbretëria e tij kishte orientim laik, pasi dukej qartë se u mungonte orientimi i bazave të imanit. Si duket kjo (mbretëri), e kishte shtyrë atë t'a mohonte All-llahun, (larg nesh qoftë ky mosbesim). Ai nuk e njohte, ose më mirë nuk e pranonte, ekzistencën e All-llahut të Lartëmadhëruar.

Kur, Ibrahim a.s., ia përkujtoi atij se All-llahu xh.sh. është i Vetmi, i Cili jep jetë dhe merr jetë, ai nuk u dakordua me të. Ai shfaqti arrogancën e vet, menjëherë për ato që dëgjoi. Mendjemadhësia e tij nuk e lejoi të "mposhtej" dhe tha: "(edhe) Unë jap dhe marr jetë." Si është e mundur që njeriu të marrë dhe të japë jetë? Mbreti pabesimtar tha: ma sillni këtë njeri para meje, duke bërë me gisht, për njërin prej tyre që ishte prezent tek mbreti, midis njerëzve që ishin dëshmitarë të kësaj ngjarjeje. Pastaj tha: vriteni. Në momentin kur ata filluan ekzekutimin tha: ndaluni, ia kam falur. Me këtë shembull, ai deshi t'i tregojë Ibrahimit a.s., se ai jep dhe merr jetë. Ai mendonte se urdhëri tij për vrasje do të ekzekutohej dhe kështu ai person do të konsiderohej i vdekur. Kur, pas këtij urdhëri, ai ia fali jetën, ai deshi t'u linte të tjerëve përshtypjen të mendojnë se ishte ai, që i dha jetë.

Historia na tregon se këtij mbreti, prej atij momenti, nuk i është shtuar as begatia, as pasuria, as imani e as falenderimi për All-llahun, por përkundrazi, ai u bë edhe më arrogant, dhe edhe shumë pabesimtar.

Atëherë, Ibrahim a.s., e sfidoi atë me një gjë, që ishte mbi mundësitë e qenies njerëzore. Ai mori diellin si shembull dhe i tha atij: Zoti im bën që dielli të dalë nga lindja, bëje ti atë të dalë nga perëndimi. Kur i dëgjoi këto fjalë, ai mori goditje të rëndë dhe u shtang. Nuk kishte se si t'i përgjigjej, sepse nuk e priste që një djalosh, do t'a sfidonte atë, me krijesat e universit të All-llahut.

Me këtë shembull, i Lartësuar, i përkujton secilit njeri, se pasuria, pushteti etj, nuk duhet të bëhen kurrë shkak i mosnjohjes dhe shkak që ata të paraqiten arrogantë dhe dhunues në popull. Këta, që kanë arritur pasuri, të mos harrojnë mirësitë e All-llahut xh.sh., të mos harrojnë se pasuria e tyre është prej riskut të All-llahut, dhe nuk u ngelet pas vetes asgjë. Le të mos shprehin arrogancë në të tilla raste, dhe le të mos e teprojnë me sjelljet e tyre, e të shndërrohen në diktatorë që i tejkalojnë të gjitha kufijtë. Nëse arrijnë në këtë gjendje, le t'a dinë se e tërë kjo, është si rezultat i punëve të padrejta. Për këtë arsye, i Lartëmadhëruari, thotë:

" كلا ان الإنسان ليطغى ان رءاه استغنى "

"Jo! Njeriu, vërtet, kërkon t'i kalojë të gjitha kufijtë, kur ai e ndien veten të pavarur."⁵¹

⁵¹ Kur'an, 96 / 6-7

Pasuria ndikon që njeriu, shpeshherë, t'i kalojë kufijtë njerëzorë, sepse atij i duket se pasuria është mbi të gjitha, dhe mund të bëjë çfarë të dojë me forcën e saj. E pse jo, kur ai posedon mbretëri të madhe, pasuri të shumta dhe kështu ka mundësi t'a "realizojë atë, që ai dëshiron". Atij, shpeshherë, i duket se është ngritur shumë lart, aq saqë mendon se ka më shumë pasuri, se edhe vetë Zoti. Prandaj, mendon se nuk duhet të kërkojë ndihmë prej Tij, e as nuk duhet të marrë pëlqimin e Tij, prandaj sillet me arrogancë dhe terrorizon masën.

Ndoshta, tregimi i Karunit, e qartëson edhe më shumë këtë lloj karakteri. Karuni ishte sprovuar nga All-llahu xh.sh. (me dhënien e begative të mëdha nga ana e Tij). Atij i ishte dhënë mundësia të grumbullonte pasuri aq shumë, saqë askush në botë nuk ka pasur më shumë se ai. Por shtrohet pyetja, vallë a ia shtoi lutjet dhe besimin atij, kjo pasuri!? Apo e bëri atë të bëhet akoma më mosmirënjohës, me egoizmin e tij, pasi ai meritën për arritjen e pasurisë ia atribuoi vetes së vet. Ai thoshte se, këtë pasuri, e kish fituar në sajë të shkathtësisë së vet, dhe me forcat e tij vetjake. Ai nuk pranoi se, e gjithë kjo, ishte prej mirësive të All-llahut!

Kur'an Kerim, na e tregon kështu tregimin e Karunit:

" ان قارون كان من قوم موسى فبغى عليهم وعاتيناه من الكنوز ما ان مفاتيحه لتنوأ بالعصبة أولى القوة اذ قال له قومه لا تفرح ان الله لا يحب الفرحين "

"Karuni⁵² ishte prej popullit të Musait, ishte oguri i zi për ta (çifutët), ndërsa Ne i kishim dhënë aq shumë thesare, saqë disa të fuqishëm (individë) me shumë mundime arrinin t'ia bartnin çelësat (e depove) të tij; (megjithatë) populli i tij i thoshte: Mos u kreno, sepse All-llahu nuk i do ata që krenohen."⁵³

All-llahu xh.sh. i kishte dhënë Karunit thesare dhe pasuri të shumta. Askujt prej robërve të Tij, më parë, nuk i kishte dhënë sa i kishte dhënë këtij personi. Por, fatkeqësisht, kjo pasuri nuk i ndihmoi atij të jetë rob falenderues ndaj Zotit, por përkundrazi, ai merrej me përgojime, përbuzje dhe sillte ngatërresa mes njerëzve në tokë. Kur atij ia përkujtuan programin dhe begatitë e All-llahut xh.sh., ai u përgjigj:

" قال انما أوتيته علي علم عندي "

"Ai (Karuni) thoshte: por këto (thesare) që unë i posedoj, janë (rezultat) vetëm i dijes sime."⁵⁴

Karuni ia atribuoi meritat vetvetes për pasjen e kësaj pasurie, pra sipas tij, ajo ishte rezultat i aftësive të tij. Kështu mendonte ai. Ai harroi mirësitë e All-llahut dhe mendoi se tani, ai është më i pasur, madje, se edhe vetë Zoti. Por si e dënoi i Lartëmadhëruari, meqënëse ai e kishte tepruar në mosmirënjohjen e mirësisë së All-llahut xh.sh.?

⁵² Karuni, pasi arriti të grumbullojë pasuri shumë të madhe, Faraoni e bëri ministër të financave.

⁵³ Kur'an, 28 / 76

⁵⁴ Kur'an, 28 / 78

Le t'a shohim Kur'anin, se si e dënoi Zoti atë:

"فخسفنا به وبداره الأرض فما كان له من فئة ينصرونه من دون الله وما كان من المنتصرين"

"Dhe Ne bëmë, t'a përpinte toka me gjithçka kishte, në pallatin e tij. (Kështu) Askush prej ithtarëve të tij nuk arriti t'a ndihmojë, pa (urdhërin e) All-llahun, e ai, as që ka mundur të mbrohet (prej dënimit të All-llahut)."⁵⁵

Në të shumtën e rasteve, pasuria është provë për poseduesin e saj. Sepse në momentet kritike të imanit, ai mendon se është më i pasur dhe më i fuqishëm se vetë All-llahu xh.sh. dhe nuk mendon shumë për ato që flet, aq sa kalon deri në mohim. Ai ia atribuon të mirat vetvetes. Por, ai dikur do të vdesë dhe do t'a lërë të tërë pasurinë e vet. Kështu, ai do t'i paraqitet All-llahut, i vetëm, pa pasuri, pa forcë dhe pa pushtet, dhe Ai do t'a dënojë me dënimin më të rëndë.

Pasuria, në këtë rast pasuria, konsiderohet begati apo provë?

Kur njeriut i mungon ndonjëherë risku, ai mendon se duhet të jetë më afër All-llahut (me lutje dhe vepra të mira). Por, kur atë (njeriun), e sprovon me pasuri, ai e shkatërron jetën e vet dhe të familjes së vet, sespe mund të ndodhë që, as ai vetë, të mos t'a gëzojë atë pasuri, pasi mund t'ia humbin fëmijët në drogë, në bixhoz (kumar), etj.

All-llahu mund t'a sprovtojë njeriun me ndonjë sëmundje, që nuk i gjendet shërimi. Ai detyrohet të shpenzojë qindra mijëra dollarë për t'u shëruar, por pa sukses. Nuk përjashtohet mundësia që të ketë aso dhimbjesh, sa që të vuajë tërë jetën prej tyre. Ndodh që t'i ndalohet ngrënia e ushqimeve të caktuara. Edhe pse ai ka para vetes çdo gjë, atij i është ndaluar ushqimi dhe pija, edhe pse ia ka ënda shumë për t'i ngrënë ato. Shikon mishin dhe nuk mund t'a kafshojë, edhe pse dikur i shijonte mishi shumë. Nëse, nga nefsi, do t'a hante ndonjë copë, kjo do t'i shkaktonte dhembje të padurueshme. A mos vallë, është e mirë kjo?

Kur'ani Kerim na jep këta shembuj dhe shumë shembuj të tjerë, shumicën e të cilëve do t'i shpjegojmë hollësisht, derisa të bindemi se pasuria nuk është e mira absolute e kësaj bote, siç paramendojnë disa njerëz. Kemi njerëz, të cilët e mallkojnë ditën që filluan të pasurohen, pasi ajo (pasuria) iu është bërë shkaktare e shkatërrimit të jetës dhe e qetësisë që kanë pasur. Ata jo vetëm që i sollën probleme, vuajtje e mërzi vetes, por edhe fëmijëve të tyre.

Nëse nuk keni qenë mirënjohës ndaj All-llahut xh.sh., për pasurinë që ua dhuroi, ajo s'do të jetë veçse dënim në këtë botë. Të jeni të sigurtë se All-llahu nuk shikon (vlerëson) pasurinë, por iu kap dhe iu shpie në xhehennem (për shkak të veprave tuaja të këqija), – kërkojmë mbrojtje nga All-llahu që të na ruajë prej atij vendi.

⁵⁵ Kur'an, 28 / 81

Kapitulli i katërt

Çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqe

Para se të fillojmë të flasim për të mirën dhe të keqen, e shoh të domoshme të paraqes se çfarë është e mira dhe çfarë është e keqja, sepse njerëzit kanë opinione të ndryshme për to. E mira është ajo, e cila të përcjell deri tek qëllimi, që nuk ka më të mirë pas tij. Njeriu lind në këtë botë, pastaj fillon e rritet, më pas mbaron shkollën fillore, të mesmen, dhe mbase e mbaron edhe fakultetin, magjistraturën, doktoraturën dhe, në një formë apo në një tjetër, e jeton jetën e vet në këtë botë dhe më në fund edhe vdes. Pastaj ringjallet, dhe nëse ishte i mirë në këtë botë, do të hyjë në xhennet. Kjo, në tërësi, është begatia e përhershme dhe, pas kësaj, nuk ka gjë. Pra, pas xhennetit nuk ka asgjë më tutje, këtu përfundon e mira.

Pra, destinacioni ose qëllimi i kësaj jete është të arrijmë deri tek begatia e përhershme-xhenneti. Këtë qëllim nuk e arrijmë dot, përveçse atëherë kur i kemi peshuar dëshirat me programin e All-llahut xh.sh. Vetëm atëherë kemi arritur deri tek e mira e vërtetë, pas së cilës nuk ekziston diçka tjetër më e mirë se ajo.

Ndërsa e keqja, sipas nesh, është çdo gjë që përplasit me dëshirat e egos (nefsit). Çdo gjë që na shijon dhe që e kërkojmë, por që nuk arrijmë që t'a realizojmë, apo nuk arrin që të ndodhë, (gjithçka që bëhet shkak për t' i penguar ato) ne e konsiderojmë të keqe. Ne ëndërronim dhe shpresonim se do të ndodhte ajo gjë, por ndodhi diçka, që ajo u pengua prej nesh.

Nëse je p.sh. tregëtar, dhe të paraqitet shansi për të bërë një kontratë, prej së cilës mendon se do të arrish fitime të mëdha, por ndodh, që për arsye të ndryshme, të ndërrohen çmimet në treg, dhe në vend se të fitosh, ti do të pësosh humbje. Duke qenë në këtë situatë, ti mendon se kjo ishte një e keqe e madhe për ty. Gjithashtu, t'a zemë se je duke kërkuar punë, por "fatkeqësisht" punët u sollën në mënyrë të tillë, që t'i nuk arrin të punësohesh aty ku dëshiron. Edhe këtë, njeriu e konsideron të keqe. Ose, sikur të të ishte dhënë rasti të kaloje në një pozitë më të mirë, apo pushtet më të lartë, por punët rrjedhin ashtu, që ti nuk mund t'a zesh atë pozitë. Edhe këtë, gjithashtu, ti do t'a konsiderojë të keqe.

Nga kjo kuptohet se e keqja dhe tradita njerëzore ndeshen midis dëshirave, pasioneve dhe epsheve. Pa marrë parasysh, nëse kanë qëlluar rastësisht të ishin në përputhje me programin e All-llahut, ose nuk kanë qëlluar. Njeriu kur shfaq dëshirë të arrijë deri tek qëllimi i tij, ai domosdo, duhet të planifikojë mënyrën se si do të arrijë deri tek ajo dëshirë, gjë që atij do t'i marrë kohë dhe mund.

Ta zemë se dikush synon (ka qëllim), p.sh. të ketë sukses në provim. Për këtë arsye, ai shkon në shkollë çdo ditë, kalon kohën në mësim dhe vërtet derdh shumë mund. Ai, ia ndalon vetes që kohën e lirë t'a kalojë me shokët e tij, ose të shikojë ndonjë program televiziv që ia ka ënda, ose e ndalon veten të shikojë me familjen e tij diku, në ndonjë

gosti gazmore, etj. Vazhdon të mësojë vazhdimisht, dhe gjithashtu fle shumë pak. Të gjitha këto, i bën vetëm për të arritur qëllimin.

Nga përvoja njerëzore, është vërtetuar se njeriu, i cili nuk e ndal veten prej asgjëje që dëshiron për t'a shijuar, nuk mund t'a realizojë asnjë synim të mirë në jetën e tij. Pse? Sepse atij, për të arritur deri tek ajo e mirë, i duhet të punojë, të jetë i përpiktë dhe të sakrifikojë nga vetvetja.

P.sh. nxënësi, i cili pjesën më të madhe të kohës e kalon në lojëra, nuk e frenon veten, por i plotëson të gjitha dëshirat e tij, dhe çdo minutë e kalon me gjëra të kota, ai në këtë mënyrë, realizon vetëm dëshirat e tij të atypëratyshme. Ky njeri, kurrë nuk do të arrijë deri tek qëllimi i tij final, asnjëherë. Ai do të mbetet pa ardhmëri, pa jetë të ndershme, dhe nuk do të arrijë t'a shijojë dhe përjetojë atë. Kështu është në secilin sektor të jetës. Tregtari, nëse nuk endet shumë në kërkim të mallit të mirë, dhe nëse nuk gjen çmime të volitshme apo mesatare, ai nuk ka arritur të bëjë asgjë, sepse konsumatori e dikton çmimin. Tregtari duhet të ketë edhe bashkëpunëtorë besnikë, se përndryshe do të falimentojë. Kështu, nuk do të mund t'a realizojë atë, që ai dëshiron.

E mira absolute

Nëse dëshirojmë të veprojmë për hir të së mirës, (duhet t'a dimë se) e mira e vërtetë vjen vetëm prej All-llahut të Lartësaur. Ajo, që vjen prej Tij, mbetet dhe nuk zhduket. Ajo vetëm rritet, dhe asesi nuk pakësohet. Pra zhvillohet dhe nuk zvogëlohet. Çdo gjë, që është në botë, zvogëlohet me përjashtim të mirës, që vjen prej All-llahut xh.sh., sepse ajo gjithnjë shkon duke u shumëfishuar.

Një shembull thotë: Pasuria është shërbëtor i mirë, ndërsa zotëriu është i lig. Pra, nëse arrin të kesh pasuri, arrin që të realizosh shumë gjëra, ndonëse jo të gjitha. Nëse atë e vë në shërbimin tënd, mund të blesh me të çfarë të duash, dhe çfarë të shijon. Por, nëse ti, e konsideron atë si zotëruesin tënd, atëherë ti do t'a grumbulloje atë. Ti nuk ke qëllim tjetër, përveç ambicies për të grumbulluar sa më shumë pasuri, ngado që të vijë ajo, qoftë nga rruga e hallallit, qoftë nga e haramit.

Këtë e bën, sepse je bërë rob i pasurisë. Prej saj nuk ke kurrfarë dobie, por përkundrazi, ajo të ka burgosur dhe të ka ndaluar të shijosh ato që dëshiron, sepse ke frikë se mos po të shpenzohet ajo (pasuria). Gjithashtu, pasurinë nuk e përjeton, sepse dëshira e madhe për të, nuk të lejon që ajo të ikë nga ti (të të dalë nga duart).

Duhet t'a kesh parasysh, se pasuria nuk është risku yt i drejtëpërdrejtë. Ajo është risku yt, por në mënyrë të tërthortë. Ti, me të, blen gjëra, por të gjitha ato që i blen nuk i përdor, sepse ti nuk ke dobi të drejtëpërdrejtë. Për ta sqaruar këtë le të marrim si shembull ushqimin. Le të supozojmë se ti ke dy kodra, njërin me flori dhe tjetrën me argjend, ndërkohë që ti je i uritur dhe i etur. A do të mund të ushqehesh prej kodrës me flori? A do të mund të pish prej kodrës me argjend? Sigurisht që jo. Sikur të vijë një njeri me një bidon me ujë, dhe të kërkojë prej teje gjysmën e kodrës me flori, (në këmbim të një gote me ujë), ndërkohë që ti je duke vdekur nga etja, a nuk do t'ia jepje gjysmën e pasurisë?

Ndërsa tjetri sjell ushqim, ndërkohë që ti je duke vdekur nga uria, dhe të kërkon gjysmën e kodrës me argjend. A nuk do t'ia jepje? Sigurisht që po.

Pra, çdo gjë që njeriu e përjeton në këtë botë, dhe e mbështet në programin e All-llahut do të ishte e mirë, dhe çdo gjë që e largon prej këtij programi, do të ishte e keqe. Nëse e përdor pasurinë për t'i ndihmuar të varfërit, të gjorët, jetimët, apo për vepra të mira bamirësie, kjo do të ishte e mirë, por nëse e përdor atë për shkatërrimin e njerëzimit, kjo do të ishte e keqe, ose pasuri e pavlerë. Nëse e shpenzon pasurinë për të evituar tiraninë, ose për të pastruar të keqen mes njerëzve, dhe gjykon me drejtësi, kjo do të ishte e mirë. Por, nëse e përdor atë për të rritur vuajtjet e njerëzve, apo për të ushtruar mizori, apo perversitet, kjo do të ishte e keqe. Nëse e kalon jetën me vepra fisnike e të nderhme, kjo do të ishte e mirë, ndërsa nëse e përdor për t'iu shkaktuar dhembje dhe armiqësi njerëzve, kjo do të ishte e keqe.

Kështu pra, nuk kemi të kuptuar absolut të gjësendeve. Por, secila gjë, vlen aq, sa dhe si e shfrytëzon. Nëse e përdor për të keq, siç thamë më sipër, ajo do të llogaritet si mjet i së keqes në univers.

Njeriu dhe ngjarjet në univers

Ngjarjet në univers janë të shumta. Ato nuk kalojnë në më shumë, se nëpër tre kanale kryesore:

1. Ngjarje që e godasin njeriun, por, në fakt, ai nuk ka të bëjë fare me to. Brenda kësaj ngjarje është prezent dora e njeriut, por jo edhe zgjedhja e tij. Këto njihen si kadere të All-llahut të Lartëmadhëruar. Le të themi p.sh., se një njeri është duke ecur nëpër trotuar (rrugës së vet) dhe i bie ndonjë gur, ose e përplas ndonjë makinë, ose mund t'i pësojë djali ndonjë aksident, ose e godet ndonjë sëmundje e pashërueshme, etj. Të gjitha këto ndodhi nuk janë rezultat i veprimit të njeriut, ato konsiderohen të jashtme. Njeriu goditet pa vullnetin e tij, dhe s'ka mundësi të shpaguehet nga dikush për atë dëmtim, përveçse vetja e tij, që do të vuajë.

2. Ngjarje që e godasin njeriun, për shkak të tjerëve. Le të themi p.sh. se një njeri të del përpara, të huton dhe kërkon të zihet me ty, ose të sulmon në rrugë, ose të shtyn dhe të rrëzon në tokë, e të tjera të kësaj natyre.

3. Ngjarje që ndodhin, por që kanë pasur mundësi alternative... Kjo rjedh nga programi i All-llahut të Lartësuar, në dhënien e lirisë 'vepro ose mos vepro'. Përderisa All-llahu xh.sh. të ka thënë 'bëje', ti në sajë të lirisë që posedon mund që mos t'a bësh, se përndryshe nuk do të kishte thënë 'bëje'. Kur Ai. xh.sh., të thotë: 'mos e bëj këtë', ti gjithashtu, në sajë të lirisë që posedon mund që t'a bësh, se përndryshe All-llahu nuk do të thoshte 'mos e bëj'.

All-llahu i Lartëmadhëruar, ka paraparë që njeriu të ketë lirinë e zgjedhjes, dhe në sajë të saj, ai do të japë përgjigje. Me të, ai (njeriu) do të shpërblehet për të mirë, ose do të

ndëshkohet për të keqen e bërë. Që të dyja këto, shpërblimi dhe ndëshkimi, janë drejtësi. Kështu do të jetë edhe për jetën tëndë të përditshme. Çfarë ke ngënë? Me kë po rri? Çfarë po vesh? E të tjera pyetje, prej gjërave të jetës së përditshme.

Gjërat, të cilat nuk kanë qenë në dorën tëndë, pra, që nuk kanë ndodhur sipas dëshirës tëndë, dhe për të cilat nuk ke pasur mundësi zgjedhjeje, janë caktime të All-llahut xh.sh., pra ato vijnë nga vullneti i Tij absolut, në univers.

Secila ndodhi, që vjen drejtëpërdrejt nga All-llahu i Lartëmadhëruar, padyshim, që duhet të njihet si e mirë, sado që ajo të jetë ngarje tragjike, sipas syrit tonë, apo teorive tona. Dituria jonë është e kufizuar, ne nxitojmë në gjykime dhe llogaritë tona e nxjerrin (atë ndodhi) si diçka shumë të keqe. Por, çdo gjë, që vjen prej All-llahut, padyshim që është e mirë, por ai që e ka zemrën e ngushtë, dhe është i padurueshën (pa sabër), ai humbet. Ne, këtë lloj njeriu, e shohim si jo të plotë në vetvete.

All-llahu, me vullnetin e Vet, na dha shembuj për këtë lloj të natyrës së njerëzve, në kaptinën kur'anore 'Shpella' – 'Kehf'. Musai a.s. kishte një takim me Robin e Mirë⁵⁶. Të gjitha veprat, që i bëri Robi i Mirë, nga pikëpamja e Musait a.s. ishin vepra të gabuara. Ata hipën në një anije të disa skamnorëve, dhe ai (Njeriu i Mirë) e zhbiroi anijen në mënyrë që të fundosej. Ai vrau një fëmijë pa pasur faj fare, pasi ai ende nuk kishte arritur në moshën e pubertetit, dhe së fundi, ata hynë në një fshat, populli i të cilit ishte koprac, për arsye se ata nuk iu servuan atyre asnjë kafshatë buke, edhe pse ata i kishin parë se ishin të uritur. Megjithatë, Robi i Mirë iu riparoi atyre një mur, i cili ishte duke u shembur!

Të gjitha këto veprime, nga pikëpamja e Musait a.s. ishte të gabuara. Por, që të gjitha këto ndodhi ishin prej kaderit⁵⁷ të All-llahut. Ato, me vete, bartnin përplot të mira (hajre). Ai e zhbiroi anijen që të fundosej, sepse mbreti i atij populli kishte sjellë një vendim që t'i uzurponte të gjitha anijet e qytetarëve të atij shteti. Kur xhandarmëria e pa se anija e tyre ishte e shkatërruar, u largua dhe nuk ia mori atë skamnorëve. Ata, me një riparim të vogël, arritën që të punojnë përsëri, po me atë anije.

Ndërsa fëmija kishte pasur një ardhmëri të keqe, dhe ai, gjithashtu, do të bëhej shkaktar që prindërit e tij të mirë, të mohonin Zotin dhe të përfundonin në xhehennem. Atyre, All-llahu, ua zëvendësoi atë me një fëmijë tjetër. Ishte pra, mëshira e All-llahut që e mori para se të mbushte kohën e pubertetit dhe t'a shpinte atë në xhennet, pa e marrë në llogari.

Ndërsa muri, kishte në themel një thesar florinjsh, i cili ishte pronë e jetimëve të një njeriu të mirë. Me riparimin e atij muri, ai përforcoi atë mur që të qëndrojë (pa u rrëzuar) derisa të rriten fëmijët. Kur ata do të rriteshin, do t'a ripararin murin që nga themeli, dhe

⁵⁶ Robi i Mirë, ndryshe populli ynë e njeh me emrin Hizri. Robi i Mirë është shfaqur në Kur'an me disa dhunti të dhuruara drejtëpërdrejt, nga All-llahu xh.sh. Mundësitë e tij ishin mësim për Pejgamberët e All-llahut dhe kuptohet për mbarë njerëzimin, në veçanti për besimtarët (shënim i përkthyesit).

⁵⁷ Kaderi – është një fjalë, që duhet të shpjegohet gjërë e gjatë, por neve tani për tani, do të na mjaftonte të themi se 'Kader' ka kuptimin e caktimit të All-llahut xh.sh. (shënim i përkthyesit)

aty, do t'a gjenin thesarin që ua kishte lënë babai tyre. Është edhe një qortim i popullit të atij fshati, por, për më gjërë, mund të lexoni në librin 'Tregimet e Kur'anit', në kaptinën 'Kehf' – 'Shpella'.

Pra, ajo se çfarë paraqitet në sipërfaqe të ngjarjeve, nuk është e tëra, prandaj ne nuk mund të japim konkludimin përfundimtar (vetëm në bazë të gjërave sipërfaqësore). Për arsye se, ne, nuk kemi para vetes të tërë ngjarjen dhe përfundimin e saj. Ne, vetëm, sa shohim disa skena, por ende na kanë ngelur pa parë skenat e tjera të shumta. All-llahu i Lartëmadhëruar, në Kur'anin Kerim, thotë:

"وَمَا أُوتِيتُمْ مِنَ الْعِلْمِ إِلَّا قَلِيلًا"

"...kurse juve, ju është dhënë shumë pak dituri."⁵⁸

Gjithashtu, thotë:

"وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ"

"...por, shumica e njerëzve nuk dinë (nuk kuptojnë)."⁵⁹

Tani le t'i kthehemi vetvetes. Kur neve na godet diçka, le ta dimë se ajo ishte nga All-llahu xh.sh., prandaj t'a presim si një vepër me të ardhme të mirë, edhe pse nuk e dimë urtësinë e saj. All-llahu xh.sh. na ka argumentuar, se ne nuk jemi kompetentë, që të japim konkludimet përfundimtare për ngjarjet, e as për ato gjëra që nuk na përkasin neve, e që janë në univers.

Për këtë arsye, gjejmë versete të shumta në Kur'anin Kerim, të cilat kërkojnë nga ne, që mos t'i parafrazojmë ngjarjet dhe të japim konkludime, duke u bazuar në dijen tonë, sepse ne jemi të kufizuar dhe shumë të cekët.

Kështu, le ta lexojmë këtë ajet kur'anor:

"وَعَسَىٰ أَنْ تَكْرَهُوا شَيْئًا وَهُوَ خَيْرٌ لَّكُمْ وَعَسَىٰ أَنْ تُحِبُّوا شَيْئًا وَهُوَ شَرٌّ لَّكُمْ وَاللَّهُ يَعْلَمُ وَأَنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ"

"Ndodh që ju t'a urreni ndonjë gjë, por ajo (në realitet) është (përcaktuar të jetë) e mirë për ju, gjithashtu, ndodh që ju të dëshironi diçka, por ajo (në realitet) është e keqe për ju. All-llahu e di, ndërsa ju nuk e dini."⁶⁰

Kështu, All-llahu i Lartëmadhëruar, na informon, se ne nuk jemi kompetentë që t'i gjykojmë ngjarjet që ndodhin tek ne, e aq më tepër ato që ndodhin në univers. Ndodh që ne t'a urrejmë një send, por në realitet, aty, ka të mira të shumta, për të cilat ne nuk kemi dijeni, ndërkohë që ne mendojmë se ai ishte një ndëshkim, apo diçka tjetër.

⁵⁸ Kur'an, 17 / 85

⁵⁹ Kur'an, 30 / 6

⁶⁰ Kur'an, 2 / 216

Por, në realitet, ai “ndëshkim” ishte një ndodhi, që solli të mira të shumta për ne. Por ngjan, që midis nesh të ndodh diçka, që të jetë e “mirë” sipas nesh, por që në realitet është një e keqe dhe dëm i madh për ne.

Ne duhet që t’a mbështesim ndodhinë, të cilën e patëm kader, sepse njerëzit nuk i dallojnë ngjarjet midis të mirës dhe të keqes (hajrit dhe sherrit). Njerëzit nuk mund t’a kuptojnë, sepse atyre u është i panjohur realiteti, për sa ndodhi, dhe si ndodhi. Për këtë arsye, ne duhet t’a marim si një ngjarje që ka të mirën brenda, sepse kur vijnë kaderet e All-llahut, ato janë përplot të mira (hajre). Ndërsa e keqja vjen prej dorës së njeriut.

Le të diskutojmë për një njeri, i cili ka qenë i pasur, apo i pushtetshëm, e më pas All-llahu xh.sh. e ka rrëzuar atë nga pushteti, apo ia ka marrë atij pasurinë, etj. Ky njeri mendon se, ajo që i ndodhi, ishte një e keqe e madhe për të, dhe nuk ndalet së vajtuari, aq sa e dëgjojnë të gjithë. Ai nuk i ndërpret ankesat e tij, në drejtim të All-llahu xh.sh., për kaderin që i ndodhi, por realiteti nuk është absolutisht i tillë.

Le t’a lexojmë thënien e All-llahut xh.sh.:

" قل اللهم مالك الملك توتي الملك من تشاء وتنزع الملك ممن تشاء وتعز من تشاء وتذل من تشاء بيدك الخير انك على كل شيء قدير "

“Thuaj: O All-llahu im, që e ke tërë pushtetin, Ti i jep pushtet atij, që do dhe ia merr pushtetin atij, që do. Ti e lartëson kë do, dhe e poshtëron kë do, në dorën Tënde është mirësia. Ti, me të vërtetë, ke mundësi për çdo send.”⁶¹

Përderisa, i Lartëmadhëruari, kërkoi prej nesh që, për çdo gjë, t’i drejtohem Atij me thënien: “Në dorën Tënde është mirësia”, ajo që do të vijë nga Mbreti i Mirësisë është e mirë, gjithashtu edhe nëse të merret, edhe ajo është e mirë. Të mirën, që vjen nga Mbreti i Mirësisë, askush nuk mund të ta ndalojë, dhe askush nuk dyshon se ajo është e mirë. Kur All-llahu i jep pushtet dikujt, ai duhet t’a kuptojë, ose t’a shpjegojë këtë, si një dhuratë të mirë për të, sepse secili njeri e shpjegon këtë si një gjë të mirë, por si mund të kuptohet të larguarit nga pushteti, si një gjë e mirë!?

All-llahu xhele xhelaluhu thotë: “ **...dhe ia merr pushtetin atij që do...**” Marrja e mbretërisë ose pasurisë, nuk ndodh nëpërmes lirisë (me vullnet të lirë), por domosdo që All-llahu ua merr ato njerëzve me anë të puçit, edhe pse këta njerëz dëshirojnë që të vazhdojnë të qëndrojnë sipas atij sistemi. All-llahu xh.sh., ua merr atyre me zor dhe në mënyrë të vrazhdë. Atëherë si mund të quhet, ky puç, gjë e mirë!?

Themi se All-llahu e di përfundimin e plotë, që prej fillimit, deri tek mbarimi i ngjarjes. Ai i njeh gjërat, dhe ndodhitë e njerëzve, para se të ndodhin, dhe si do të përfundojnë. Ai e di se kush prej tyre do të shpërblehet me xhennet, e kush do të dënohet me zjarr. Për Të, nuk ka ndërprerje të ngjarjeve, sikur që i kemi ne, në formë sekuencash. Për Të, çdo gjë, është e përkryer dhe absolute. Fillimet dhe përfundimet janë të lidhura njëra me tjetrën⁶².

⁶¹ Kur’an, Ali Imran / 26 – bazuar në përkthimin e Dr. Feti Mehdiut

⁶² Sepse koha, tek Ai, nuk ekziston.

Ai, i cili bën një punë të mirë, do t'a gjejë atë në xhennet, ndërsa ai, i cili ka bërë mëkate dhe shkatërtime në tokë, do të ndëshkohet në ahiret.

Përderisa, prej fillimit të mbarë pritet rezultat i mirë, atëherë nga fillimi i keq pritet rezultat i keq. Kështu është edhe me mbretëritë. Ato demostrojnë forcën, pushtetin, urdhërat, dhe nënshtrimet. Ato ndonjëherë sillen ndaj popullit me arrogancë, mizori e nganjëherë i kalojnë kufijtë duke terrorizuar masën. Kur, All-llahu xh.sh., ua merr me zor pushtetin disa njerëzve, ata nuk e dinë se ua ka marrë atë, për t'i shpëtuar nga zjarri i përhershëm në ahiret.

All-llahu i Lartësuar, me dijen e Tij të pafundme, si i Gjithëdijshtëm, e di se cili njeri do të shndërrohet në diktator dhe në tiran. Për këtë arsye, mbase prej Rahmetit të Tij, dëshiron që t'a shpëtojë atë nga dënimi i rreptë, prandaj edhe ia mer pushtetin për t'a ndaluar katastrofën që do të mund të vinte. Njëkohësisht, do t'a shpëtonte nga vuajtja e përhershme. Kjo pra, a do të ishte hajër apo sherr?!

Sikur të mos ia merrte pushtetin, ai do të vazhdonte të qëndronte edhe për pak vite në pushtet, por, më në fund, pak para se të mbaronte jetën e tij, do t'a humbiste atë. Marrja e pushtetit do të duhej të konsiderohej mëshirë ndaj tij. Ai do të ndahej prej aty me mirësjellje, dhe kështu nuk do të bëhej prej të hidhëruarve të All-llahut.

Njeriu në momentin kur i mirret mbretëria (pasuria), mendon se për të çdo gjë është keq e më keq, por kur të shkojë në ahiret do t'i jetë falenderues dhe do t'i bëjë sexhde All-llahut xh.sh., sepse Ai e ka shpëtuar nga zjarri i xhehennemit.

Kështu është edhe me të krenuarit në këtë botë, kur njeriu pason mëkatin. Të krenuarit (mburrja) e largon njeriun nga All-llahu xh.sh., dhe e bën atë arrogant dhe keqbërës. Kur All-llahu i Lartësuar, ia merr atij këtë krenari, Ai e kthjell atë dhe ia tërheq vërejtjen. Atëherë njeriu do ta kuptojë se paska qenë i nevojshëm shumë për All-llahun xh.sh. Ai do t'i ngrejë duart kah qielli dhe do të thotë: O Zot! Dhe ndoshta, pas këtij momenti, do të fillojë të ecë drejt rrugës së vërtetë, e të largohet prej rrugës së shtrembër, që ishte duke shkuar, prej asaj rruge që do t'a dërgonte në shkatërrimin total.

Pra, secili kader (caktim), që vjen prej All-llahut xh.sh., sado i dhimbshëm të jetë në shikimin sipërfaqësor, apo të jetë i dëmshëm sipas kuptimeve njerëzore, në realitet, ai është i mirë dhe i hajrit. All-llahu i Lartëmadhëruar është Ai, i Cili na krijoi dhe nënshtroi për ne çdo gjë, që ka në qiej dhe në tokë. Lartëmadhëria e Tij na do të mirën, por njeriu dëshiron t'i përshpejtojë gjërat dhe nga injoranca e tij nuk e di se All-llahu xh.sh., për të ka caktuar (më të mirën), pasi Ai ka Urtësinë e Tij absolute në Mretërinë e Tij, ndërsa ne, edhe nëse arrijmë të kuptojmë ndonjë gjë, mbetemi pa kuptuar diçka tjetër.

Disa njerëz, i shohim t'iu ngushtohen zemrat, kur thonë se e kam lutur All-llahun xh.sh. për këtë e atë, por nuk më është përgjigjur. Atyre iu themi: Përgjigja, në brendi, ka të mirat e veta, gjithashtu edhe mospërgjigja ka të mirat e veta. Ndoshta, ajo që ke kërkuar nga All-llahu i Lartësuar, ka qenë në dëmin tënd, sepse t'i e nuk e di në fakt, nëse ajo do

të ishte e mirë apo e keqe, për ty. Sikur t'i përgjigjej kërkesës tënde ndoshta do t'a pësoje shumë më keq!?

A nuk i mallkon nëna nganjëherë fëmijët e vet para Zotit, kur ajo është gjendur ngushtë dhe është hidhëruar prej tyre!? A nuk e lut (për keq) njeriu All-llahun, kur ai është i zemëruar, për njerëzit më të afërt të tij!? Çfarë do të ndodhte sikur të pranohej lutja e nënës, për t'ia marrë fëmijët, nga kjo jetë, përnjëmend? A do të gëzohej nëna në këtë rast? A do t'a kishte falëndruar All-llahun, sikur t'i pranohej lutja?

Kështu është edhe lutja e babës ndaj fëmijëve të tij, ose e gruas për burrin e saj, kur ata janë të zemëruar. Sikur qielli t'ua pranonte lutjet atyre, do të shtohet mërzia dhe zemërimi edhe më shumë. Por, duke mos ju përgjigjur atyre, ju ka dhënë mirësi të shumta. Për këtë, i Lartësuari, në Kur'anin Kerim, thotë:

"و يدع الإنسان بالشر دعاءه بالخير و كان الإنسان عجولا"

"Dhe njeriu e thërret të keqen, edhe pse lutjen e ka për të mirë; njeriu (nga natyra e tij) është i vrullshëm."⁶³

Kështu pra, është me ata që mendojnë se lutja do të ishte e mirë, sikur t'iu pranohej, por realiteti do të ishte i dëmshëm për ta. Këto kërkesa të ngutshme dalin nga injoranca dhe mosnjohja e përfundimit të ngjarjeve. Mosnjohja e tyre, se çfarë mund të ndodhë, është sekretet. Ty sipas parallogaritjeve të tua të duket se është e mirë, ajo (ndoshta) koiçidon me kohën dhe vendit në të cilën je duke jetuar, por mund të ndodhë që parallogaritja jote të jetë e gabueshme. Pse? Sepse më vonë, mund të dalin disa gjëra të tjera, dhe do të konkludoje se ajo (kërkesa e parë) paska qenë e keqe e madhe, e ti më parë nuk mendoje se ajo ishte e dëmshme, edhe në të vërtetë nuk ndaleshe duke u lutur që të të pranohej sa më shpejtë duaja! Por, All-llahu i Lartëmadhëruar, me Urtësinë e Tij, nuk të është përgjigjur ty "pozitivisht". Ai, nga Dituria e Tij, ka dëshiruar të të shpëtojë nga e keqja, e cila do të vinte për ty, sepse e dinte se ajo për ty ishte e panjohur.

Ti, mbase, dëshiroje të ishe pranë sundimtarit, apo të bëheshe prijësi i një grupi njerëzish. Por ditët që pasuan, e ndryshuan situatën dhe ai sundues, u zëvendësua me një tjetër të ri, i cili do t'i spastronte nëpunësit e sundimtarit të vjetër. Ndoshta, edhe ai sundues të cilin e ëndërroje do të të mundonte, do të zemëronte me ngarkesa, të cilat nuk do të ishe në gjendje që t'i përballoje.

A nuk kemi dëgjuar për sundimtarë, të cilët u rrëzuan nga pushteti me puç, prej njerëzve më të afërt të tij dhe madje që edhe i ekzekutuan? Kemi dëgjuar, shumë raste të tilla, veçanërisht në revolucionet, që ndodhën në disa shtete. Këto parafytyrime nuk janë të vjetra për ne, por le t'a lexojmë thënien e All-llahut në Kur'anin Kerim:

"و يذيق بعضكم بأس بعض"

"...dhe të shijoni vuajtjet e njëri-tjetrit..."⁶⁴

⁶³ Kur'an, 17 / 11

⁶⁴ Kur'an, 6 / 65

Ti, kur drejtohesh drejt qiellit me duar e ngritura, lutesh për diçka, dhe shpreson se ajo lutje do të pranohet. Me siguri, mendon se kjo lutje, sikur të pranohet, do të ishte e mirë për ty. Por, duhet që edhe sikur ajo të të mos të pranohet, po ashtu duhet t'a kuptosh se kjo është e mirë për ty. Sepse All-llahu xh.sh., me këtë mospërgjigje, të ka ndaluar nga një sherr i madh.

Këmbëngulja për pasuri të hajrit

Njerëzit në jetën e tyre, këmbëngulin gjithnjë për pasuri të mirë. Kemi shumë njerëz që habiten, kur shohin se si All-llahu xh.sh., i jep krenari dhe pasuri edhe pabesimtarit?!

All-llahu xh.sh. na bën me dije se njerëz të tillë nuk i pëlqejnë. Nganjëherë, i furnizon pabesimtarët për t'ua shtuar mëkatet dhe mohimin. Sikur t'ua ndërpriste begatitë, mbase ata do të kthjelloshin dhe do të pendoheshin. Për shkak të hidhërimit të lartë ndaj tyre, Ai ia lehtëson atyre përparimin në botë.

Le t'a lexojmë thënien e All-llahut xh.sh. në Kur'anin Kerim, se ç' thotë për pabesimtarët:

" فلا تعجبك أموالهم و لا أولادهم إنما يريد الله ليُعذبهم بها في الدنيا و تزهد أنفسهم و هم كافرون "

"Le të mos ngazëllesh ty (o Muhammed) pasuria, e as fëmijët e tyre! All-llahu dëshiron t'i dënojë me të, në këtë botë, dhe t'a përfundojnë jetën si jobesimtarë." ⁶⁵

Në këtë ajet kur'anor, All-llahu i Lartëmadhëruar e këshillon Muhammedin s.a.v.s., e kur këshillohet ai, kjo do të thotë se kjo këshillë vlen për të gjithë besimtarët muslimanë.

I Lartësuarit thotë: mjerë ai, i cili mendon vetëm për shtimin e pasurisë dhe fëmijëve, sepse ato janë dhuratë dhe vullnet i All-llahut. Mos mendoni se e mira qëndron në to! Nëse ti vëren atë se çka u jepet të tjerëve, mos e lakmo atë, sepse ti nuk e di që ajo mund të jetë shkak i dënimit të tyre. Pasuria dhe fëmijët e bëjnë njeriun të mendojë se ato janë begati për të, por nuk është thënë se ato janë dhuruese begatish, nëse njeriu nuk e përkujton All-llahun xh.sh.

Njeriu frikësohet të ndahet nga kjo botë, për shkak të pasurisë dhe fëmijëve. Ai, i cili nuk e beson ahiretin, mendon se ka vetëm jetën e kësaj bote. Nëse i ikin ato (pasuria dhe fëmijët), për të është katastrofa më e madhe, por edhe ky nëse u ikën atyre, edhe kjo gjithashtu, do të ishte një katastrofë e madhe për të. Sikur ai të besonte në All-llahun xh.sh. dhe në Ditën e Gjykimit, do të ishte i bindur se edhe sikur atij t'i iknin të mirat e kësaj bote, ai do të gjente të mira të shumta, nga All-llahu xh.sh., në ahiret.

Verseti kur'anor na lë të kuptojmë, se pasuria përmban në vete ngazëllimin (mahnitjen), gjithashtu, edhe fëmijët përmbajnë në vete ngazëllimin. Ai, i cili ka pasuri, ngazëllehet

⁶⁵ Kur'an, 9 / 55

me pasurinë që e ka. Gjithashtu, edhe ai që ka fëmijë, mahnitet me fëmijët që ka. Nëse, All-llahu xh.sh., mundëson që një njeri t'i ketë të dyja këto të mira, ai do të ngazëllehej akoma më tepër.

All-llahu i Lartësuar dëshiron të na tregojë se grumbullimi i pasurisë, dhe shtimi i fëmijëve nuk duhet t'i habitë njerëzit, pasi kur All-llahu xh.sh., i dhuron pabesimtarit pasuri dhe fëmijë, nuk e bën këtë për t'a nderuar atë, por për t'a dënuar me to, në këtë botë dhe në botën tjetër.

Sklavi i pasurisë edhe pse ka arritur pasuri të madhe, gjithmonë jeton me frikë. Imani i tij ka humbur, sepse ai i frikësohet skamjes. Për këtë arsye, ai bëhet koprac, edhe me veten, edhe me fëmijët e tij. Ai është i kujdesshëm për secilën qindarkë që shpenzon. Do të shohim se, gjithnjë, ai është duke u frikësuar (se mos varfërohet), edhe pse posedon pasuri të majme. Ai nuk ia plotëson dëshirat vetes, nga frika se po i harxhohet ajo (pasuria), apo se po e humbet atë! Ai, gjithnjë, është i stresuar, prej ankthit për t'i ruajtur ato. Ai është në gjendje të bëjë gjithçka, edhe sikur të mëkatonte apo gabonte, vetëm në emër të ruajtjes së pasurisë së tij. Ai drithërohet prej çfarëdo ndodhie, nga frika e humbjes së pasurisë së tij.

Në pamje të jashtme, njerëzve u duket se ai po i gëzohet pasurisë së tij, por në realitet, ai jeton një jetë plot ankth dhe frikë brenda qenies së tij.

E keqja e parë, që i shkakton vetvetes njeriu i robëruar pas pasurisë së tij, është se ai i harron shokët e tij dhe All-llahun xh.sh. Ai i thyen zemrat e të tjerëve dhe i mashtron njerëzit, duke ua marrë të pafuqishmëve të drejtat e tyre.

Nga kjo, sa thamë më sipër, kuptohet se të dhënurit e pasurisë një jobesimtari, nuk duhet të merret si dashuri ndaj tij, por All-llahu ua jep atyre, që gradualisht t'a bëjë ralisht fjalën e Tij (dënimin e tyre). Ky i harron këta mohues, për shkak të mosbesimit dhe joimanit të tyre ndaj programin të Tij, prandaj atyre u jep dhe ua shton pasurinë, derisa të bëhen adhurues të pasurisë së tyre dhe t'a harrojnë adhurimin e All-llahut xh.sh. Kështu, pasuria e tyre, do të vazhdojnë të bëhet shkak, që ata t'a injorojnë adhurimin e Tij, derisa të vijë koha, që ata do të ndërrojnë jetë (vdekja), e atyre t'iu merret shpirti, duke qenë pabesimtarë (qafirë). Atëherë, çfarë do të ndodhë në Ditën e Gjykimit?

Lexojeni thënien e All-llahut xh.sh., i Cili thotë:

"ان الذين كفروا وماتوا و هم كفار فلن يقبل من أحدهم ملء الأرض ذهباً ولو افتدي به أولاءك لهم عذاب أليم وما لهم من ناصرين"

"Ata, të cilët mohojnë dhe vdesin si mosbesimtarë, me siguri asnjërit nuk do t'i pranohet për kompensim, qoftë edhe e tërë pasuria e kësaj bote. Ata i pret dënim i dhembshëm. Atyre, askush, nuk do t'u ndihmojë."⁶⁶

⁶⁶ Kur'an, 3 / 91 – Sipas përkthimit të Dr. Feti Mehdiut

A mos vallë, floriri dhe pasuria e tyre, ishte e mirë për ta? Apo, ishte e keqe dhe e dëmshme?

Kapitulli i pestë

E mira dhe bota

Disa njerëz supozojnë se bota nuk është e krijuar në mënyrë të mirë dhe të drejtë. Si është e mundur kjo?

Ne, para vetes, shohim pamje të llojllojshme. Shohim të pasur, të varfër, shohim prej atyre që vdesin prej urisë, si edhe prej atyre që vdesin prej mbipeshës. Shohim, gjithashtu, reprezalje të ndryshme, shohim të verbër, të paralizuar që nuk lëvizin fare. Pastaj, ku mund të jetë ajo drejtësi, kur edhe fëmija vdes i uritur? Apo, kur vërejmë njeriun, që e ka kapluar sëmundja, apo plakën, e cila jeton në këtë botë e dëshpruar dhe e vetmuar?

Nëse i hedhim, vetëm pak, vështrimin kësaj që më sipër thamë, do të shohim se, të gjithë këto ndodhi, janë fakte të vërteta. Por, është i vërtetë edhe fakti tjetër, se njerëzit e kanë lënë rrugën e programit të All-llahut xh.sh. Njeriu me arrogancën dhe me injorancën e tij, është ai vetë fajtori, i cili po e shkatërron botën, të cilën, ashtu siç e përshkuam, e ka kapluar skamja dhe mjerimi, në tërësi.

All-llahu xh.sh., në Librin e Tij të Madhëruar, thotë:

" و جعل فيها رواسي من فوقها وبارك فيها و قدر فيها أقواتها في أربعة أيام سواء للسائلين "

“Dhe Ai, në të (në tokë), nga sipër vendosi kodra të palëvizshme, i bekoi dhe caktoi prodhimet e saj, në të. (të gjitha këto) I bëri për katër ditë (kjo është përgjigja) sqarim për ata që pyesin.”⁶⁷

Përderisa, i Lartësuar All-llah, ka thënë: **“dhe caktoi prodhimet e saj në të”**, kjo do të thotë se ushqimi në tokë është me bollëk, dhe i mjaftueshëm për secilin njeri, që prej kohës së Ademit, e deri në Ditën e Kataklizmës. Këtë e argumenton edhe vetë realiteti ynë, pasi nëse ndodh që një shtet t’a kaplojë uria, administratorët e atij shteti importojnë artikuj ushqimorë të nevojshëm prej vendeve të tjera, ose ato ua japin atyre në shenjë bamirësie.

Pra, ushqimi që u nevojitet njerëzve për ngrënie është i bollshëm në sipërfaqen e tokës. Nganjëherë, ose për çdo vit, një shtet mund të ketë tepricë, ndërsa një tjetër ka mungesë. Problemi është tek shpërndarja, e jo tek mungesa e ushqimit për njerëzimin. All-llahu xh.sh., e ka nënshtruar tokën dhe gjithçka tjetër në shërbim të krijesave të Tij.

⁶⁷ Kur'an, 41 / 10

I Lartësuari, në Kur'an, thotë:

"و الأرض وضعها للأنام"

"Dhe tokën e bëri për (dobinë e) krijesat." ⁶⁸

Fjala 'Enam' do të thotë: krijesat e All-llahut, që prej kohës së Ademit, e deri në Ditën e Fundit. Por, a e përcaktoi All-llahu i Lartëmadhëruar, ndarjen e tokës për ndokënd prej krijesave të tij? Jo, nuk e ka bërë dhe nuk e ka përcaktuar. Toka, në tërësi, është e të gjithë njerëzve, por njeriu vetë krijoi shtete dhe, natyrisht, vendosi kufij midis tyre. Këto shtete dhe kufij, janë shkaktarët e problemeve në botë, ato shkaktojnë luftërat dhe kështu betejat janë rezultat i këtyre ndarjeve.

Sot jemi dëshmitarë, se kemi shtete që janë shumë të pasura, por që janë të pakta në numër. Fatkeqësisht, shumë pak prej tyre, janë në shërbim të së mirës. Ndërsa kemi shtete të varfëra, që janë të shumta në numër, por që, edhe prej tyre, shumë pak janë në shërbim të së mirës. Ky është një prej shkaqeve të mosbarazpeshimit ekzistues, në kohën të cilën po jetojmë. Sikur gjërat të liheshin të rridhnin, ashtu siç e ka paraparë ligji (sheriati i All-llahut), nuk do t'i kishte probleme, e aq më tepër nuk do të ekzistonte problemi i të ushqyerit. Ushqimi, njerëzve do t'u vinte pa strese dhe pa ndonjë lodhje, sikur t'a kishim këtë barazpeshim.

Shkatërruesit në tokë

Ah! Sikur çështja të mbaronte vetëm me kaq! Kemi shtete të pasura, të cilat sundojnë çmimet e tregjeve për secilin artikull ushqimor, bile edhe për nënproduktet e tyre. Disa shtete, sikurse është p.sh. Amerika, shtetasve të vet ua paguan humbjet, ose ua plotëson produktet të gjithë atyre që merren me bujqësi, veçanërisht atyre që mbjellin drithëra, vetëm e vetëm që t'a mbajë çmimin e lartë në tregun botëror! Disa shtete, sikurse është Brazili, e hedh në det kafënë, vetëm e vetëm që të mos t'a ulë çmimin e saj! Po ashtu, kemi edhe shtete të tjera, të cilat e marrin kafën, qumështin, vezët, e të tjera artikuj ushqimorë dhe i hedhin në det, vetëm e vetëm që t'a ruajnë çmimin në tregun botëror, ndërkohë që dihet se me miliona e miliona njerëz në botë, kanë nevojë imediate për to. Ata kanë nevojë për një copë buke, ose për një gotë qumësht, ose një vezë për t'a ngrënë. Ky është shkatërrim dhe përbuzje ndaj begatëve të All-llahut, që janë në tokë. T'a marrësh begatinë e All-llahut dhe t'a hedhësh, për t'ua ndaluar krijesave të tjera për t'a ngrënë!?

Sikur këto begati të ishin prodhuar fund e krye prej njerëzve, do të kishim thënë, se mbase ata kanë të drejtë të veprojnë kështu, por të hidhen ato, që i ka krijuar All-llahu xh.sh.!? Shtazët nuk u krijuan prej njerëzve, që ata t'i japin të drejtën vetes, për t'a hedhur mishin apo qumështin e tyre. Ata, nuk i krijuan as shpezët, që t'ua hedhin vezët. Ata nuk e krijuan as tokën, prej së cilës u prodhua kalliri i grurit. Në vend se t'a

⁶⁸ Kur'an, 55 / 10

shpërndanin begatinë e All-llahut, në emër të All-llahut⁶⁹ për robërit e Tij, pra t'ua shpërndanin tepricat e veta shteteve të skamura, ata i hedhin ato në det, duke i penguar begatitë e All-llahut për krijesat e Tij.

Kemi shtete, të cilat nuk merren me këto lloj prodhimesh (bujqësore), edhe pse All-llahu u ka dhënë ara shumë pjellore dhe fusha të gjëra toke, por merren me “ndërtimin” e vendit të tyre. Në vend se të merren me prodhimin e tokës dhe të nxjerrin maksimumin prej saj, ata janë të preokupuar me revolucione dhe luftëra. Ndërrojnë qeveritë dhe pushtetarët, për të qeverisur vetë.

Njeriun e preokupojnë përplasjet e “mëdha” dhe luftërat në botë, në vend se të merret me detyrën, që All-llahu i ka caktuar për t'a ndërtuar dhe punuar tokën.

Kjo është tirania njerëzore, me anë të së cilës, njerëzve iu ndalohen begatitë e All-llahut xh.sh.

All-llahu xh.sh., për këtë, thotë:

" قل أريتكم ما أنزل الله لكم من رزق فجعلتم منه حراما و حلالا قل ءالله أنن لكم أم على الله تفترون "

“ Thuaj: a shikoni (keni menduar ndonjëherë) se riskun All-llahu e zbriti për ju, (ndërsa) ju atë (disa prej ushqimeve i konsideroni) se janë të lejuara e (disa) të palejuara (hallall e haram). Thuaj: mos vallë ishte All-llahu, që ju dha leje për këtë, apo ju shpifni ndaj All-llahut.”⁷⁰

Kështu, ne shohim tiraninë njerëzore, në ndarjen e tokës në shtete dhe kufij dhe në vende që u ndaluan për robërit e All-llahut. Kur All-llahu e krijoi tokën për njerëzit dhe vetëm për njerëzit, atëherë, kush vallë e solli këtë mjerim ndërnjerëzor?

Këtë mjerim, që po sillet ndër njerëz, pa dyshim, e solli mendja e njeriut. All-llahu e kishte krijuar njeriun të lirë të zgjidhte midis dy, apo më shumë alternativave. Por, fatkeqësisht, ai u preokupua me gjithçka tjetër, ndërsa obligimet e veta të jetës, i la anash. Ajo, për të cilën ishte krijuar, ishte mirëqenia në tokë, ndërsa atë e preokupoi shkatërrimi, e preokupoi okupimi i vendbanimeve, për të sunduar njerëzit e tjerë. E preokupoi çdo gjë, që është ndesh me botën, ndërsa detyrën e vet të ndërtimit, e injoroi, për të mos thënë e ka harruar fare. Pra, ajo që kishin dëgjuar e parë, mbeti: ishte seç na ishte...!!

Këtu na çoi liria e përzgjedhjes së njeriut. Mjerim, në vend të gëzimit dhe hareshë. Shkatërrim i begative të All-llahut të Lartëmadhëruar, në vend të progresit. Kështu, ata me këtë rrugëtim, vetëm sa i shtuan edhe më shumë problemet në tokë. Në vend se t'i zgjidhin problemet, ata i largohen edhe më tepër programit të All-llahut. Kjo do t'i shpierë ata drejt një katastrofe totale. Ata, patjetër, do të duhet të mbështeten dhe t'a marrin në konsideratë programin e All-llahut, dhe jo vetëm të mbështeten në mendjen dhe

⁶⁹ Kur'an i na tregon se si veproji dhe sa i kujdesshëm qe Jusufi a.s., në kohën kur pati 7 vjetë thatësi ekstreme bota – (shënim i përkthyesit).

⁷⁰ Kur'an, 10 / 59

planet e tyre, sepse mendja, si mjet i vetëm, të dërgon drejt shkatërrimit e jo drejt përmirësimit.

Arroganca e mendjes njerëzore, supozoi dhe pretendoi se do të jetë në gjendje t'a ndryshojë sistemin në univers, duke iu paraqitur të tjerëve se është për një mirëqenie dhe për një përparim akoma më të madh. Por në realitet çfarë bëri? I preu lisat e maleve, të cilat All-llahu xh.sh. i krijoi si mushkëri të tokës. Në vend të tyre ndërtoi fabrika, prej të cilave ndotet ambienti në tokë, dhe jo vetëm toka, por edhe qielli. I Lartësuari i kishte krijuar ato të pastërta dhe të hapura për gjallesat. Tani, kemi të bëjmë me një rrezik shumë më të madh global. Tani rruzullit tokësor, pra, njërës prej shtresave ajrore atmosferike të tokës, e quajtur shtresa e ozonit, i është hapur një vrimë. Njeriu, në emër të përparimit, po hedh shumë materie kimike nëpër lumenj, liqene, etj. Kështu, ai është duke e plehërosur tokën dhe, natyrisht, duke e ndotur ujin, të cilën All-llahu e zbriti të pastër dhe të pijshëm. Ashtu siç e shkatërroi njeriu mendjen e bujkut, që t'i hidhte tokës plehëra kimike, po ashtu ai shkatërroi edhe vetveten, sepse u helmuan edhe bimët e tjera përreth tyre. Ato bimë i hanë kafshët, e kështu bashkë me to, edhe ne, qeniet njerëzore. Kjo po na "ndihmon" tani, në plogështinë tonë trupore, në lodhje, sëmundje të ndryshme dhe vdekje!

Kur shkencëtarët filluan t'a ngrenë zërin dhe të japin vërejtjet e tyre për dëmet që shkaktuan këto lloj helme mbi pemët, kafshët dhe njeriun, u pësuan aq shumë dëme, sa u hoqën të zitë e ullirit. Tash, së fundi, është ndaluar përdorimi i tyre, pasi bota u mbush me plehëra, në emër të shtimit të prodhimit. Arsyetimi është se nataliteti njerëzor është shumë i madh.

Pastaj ç'ndodhi? Këto kimikate u vunë edhe në shërbim të shërimit të disa sëmundjeve. Edhe këto u ndaluan me shumë vonesë, sepse u vu re se kishin kundërefekte, veçanërisht në sëmundjet mendore. Të gjitha këto, kanë ndodhur për shkak se mendja e njeriut është e cekët dhe e kufizuar. Njeriu, vërtet, mëson diçka, por atij i mungon shumëçka. E keqja fillon aty, sepse ai konkludon dhe vendos për të vepruar, me atë dituri të cekët, që ai ka. Ai mendon se ka shpikur një zbulim të ri shkencor, dhe në emër "të mirësisë" globale, po i ofron shërim njerëzimit. Kur, ai, më vonë, e kupton se paska qenë gabim, ai kthehet aty ku ka filluar.

Ai nuk i sheh problemet në tërësi në kompleksitetin e tyre, por sheh vetëm problemet e dukshme që ka para vetes. Atij i mungojnë dija dhe njohuritë rreth asaj, se çfarë do të ndodhë në të ardhmen. Kështu p.sh. disa shtete, duke u mbështetur në emër të lirisë, kanë kërkuar që prostitucioni të jetë i lirë. Bile parlamenti i Britanisë së Madhe, ka shkuar aq larg, saqë lejoi prostitucionin në grup. Dhe kjo i gëzoi aq shumë, saqë mburren me këtë "arritje", se janë vendet që i kanë dhënë më së shumti liri personalitetit të njeriut. Vallë, njeriu, a nuk ka marrë liri më të madhe nga programi i All-llahut xh.sh.!?.

Por, çfarë ndodhi më pas?

Më pas, u shfaqën dhe u shpërndanë shumë sëmundje, më e njohura dhe më e rrezikshmja prej të cilave, në ditët e sotme, është sëmundja e sidës. Kjo sëmundje

vdekjeprurëse, e cila nuk ka shërim, është duke i sfiduar shkencëtarët, të cilët janë duke bërë përpjekjet maksimale për parandalimin e saj, por deri tani pa sukses. Vetë ata, që ishin gëzuar se kishin arritur kulmin e lirisë personale, duke lejuar prostitucionin dhe homoseksualizmin, tani kërkojnë që të mbështeten në atë, çka është e mirë dhe e moralshme! A e bëjnë këtë për shkak të imanit të tyre: sigurisht që jo, këtë e bëjnë për shkaqe domosdoshmërie dhe nevojë. E bëjnë që t'a shpëtojnë veten nga sëmundjet vdekjeprurëse. Sikur t'a praktikonin programin e All-llahut, do të ishin të qetë, nuk do të sprovoheshin me këtë sëmundje ngjitëse, e cila po sillet rreth shoqërive, që e kanë lejuar prostitucionin me ligj.

Të gjitha këto të vërteta po ndodhin në tokë përreth nesh, ndërsa ne nuk po mbushemi me mend. All-llahu e ka ndaluar kamatën, dhe atyre që merren me kamatë, u ka premtuar dënime të rënda, por ja që njerëzit e thyen këtë ligj të programit të All-llahut dhe e shkatërruan ekonominë botërore. Madje, gjendja ka arritur deri aty, sa që fajdja e ka tejkaluar vetë kapitalin botëror. Kamata tani është bërë shkaktarja kryesore e falimentimeve të shteteve dhe e likuidimit të njerëzve. Bota, tani, ka filluar të kërkojë abrogimin e ligjit të kamatës.

Gjërat që mendja e njeriut s'i kupton

Tani le të shohim gjërat që mendja njeriut nuk i kupton. Disa njerëz thonë: Nëse All-llahu i Lartëmadhëruar e ka ndaluar mishin e derrit, atëherë pse e krijoi atë?

Kjo është një pyetje e cekët, që buron nga mendja jobesimtare. All-llahu xh.sh. është Ai, që krijoi çdo gjë në univers, dhe gjithçka që Ai krijoi, e kryen detyrën e vet, pa marrë parasysh, a është kjo gjë në dijeninë tonë, apo jo.

Kush u ka thënë njerëzve, se derri është krijuar për t'a ngrënë mishin e tij? Ndoshta, All-llahu e ka krijuar atë, për t'i pastruar plehërat nga biliarda mikrobe që kanë. Kështu ndihmon në mosshtimin dhe shpërndarjen e tyre, në mënyrë që njeriu të mos t'a pësojë dhe të mos vuajë shumë. Përderisa All-llahu, e ka ndaluar mishin e tij, Ai e ka krijuar atë për diçka tjetër, e jo për ngrënien e mishit të tij.

Dikush tjetër pyet: pse Zoti i krijoi gjarpërinjtë, akrepat, kafshët e egra etj., të cilat e frikësojnë dhe e shqetësojnë njeriun?

Atij i themi se: ti nuk je duke e kuptuar qëllimin e krijimit të këtyre krijesave. Ato ekzistojnë në tokë (univers) për të treguar dhe dëshmuar Fuqinë e All-llahut xh.sh. në botë. All-llahu nënshtroi në shërbim të njeriut shumë kafshë, duke na dhuruar shumë të mira prej tyre, krahas edhe kënaqësive të tjera, që ato na japin. Porse njeriu nuk e di, dhe nuk do ta kuptojë kurrë, pse All-llahu i Lartëmadhëruar disa prej kafshëve i bëri t'i nënshtrohen dhe t'i përulen fuqisë së tij, ndërsa disa të kafshë të tjera i bëri që të mos i nënshtrohen forcës së njeriut.

Shohim se si një fëmijë i vogël kalëron një deve të madhe! Sikur deve, rastësisht, t'i tekej t'a shqelmonte fëmijën, do t'a mbyste atë në vend. Por ja që, deveja i nënshtrohet

plotësisht fëmijës. Ai e nget atë si të dojë, e detyron të ecë, kur dhe nga të dëshirojë ai, gjithashtu ai i jep për të ngrënë kur të dëshirojë.

Disa njerëz mendojnë se është një gjë normale që fëmja t'a bëjë këtë sepse ka mundësi për t'a bërë, por e vërteta është se deveja i nënshtrohet fëmijës nëpërmjet urdhërit dhe Fuqisë së All-llahut xh.sh. Ai ka bërë që deveja t'i bindet dhe t'i përulet çdokujt prej qenieve njerëzore, kur ato t'a urdhërojnë atë.

Por nuk është kështu p.sh. me gjarpërin dhe me akrepin. Këto gjallesa janë më të vogla në krahasim me deven, plus kësaj janë edhe më të pafuqishme se ajo. Por, nëse mundohemi t'i përvetësojmë, ose të kërkojmë prej tyre të na nënshtrohen, ato do të refuzojnë dhe ne nuk do të mundemi t'i komandojmë, sepse ato nuk janë urdhëruar për të na u nënshtroar ne. Sikur të ishte se gjallesat do t'i nënshtroheshin vullnetit të njeriut, atëherë ai, së pari, do të kërkonte t'i nënshtroheshin gjallesat më të dobëta dhe më të vogla, siç janë insektet. Por, All-llahu këto nuk ia nënshtroi vullnetit njerëzor.

Përderisa, gjendja është kjo që është, ne duhet t'a kuptojmë se mundësitë tona janë të pakta dhe të kufizuara. Ne, me këto mundësi që kemi, nuk jemi në gjendje që të nënshtrojmë me forcën tonë ndonjë gjallesë. Prandaj, duhet t'a respektojmë dhe t'i jemi mirënjohës Atij, që na mundësoi që disa kafshë të caktuara të jenë në shërbimin tonë, që prej disave të marrim mishin, qumështin, apo pjesë të tjera, si lëkurën, leshin, puplat, gëzofin, etj. Ne, sado forcë të madhe që të kemi, nuk do të arrinim kurrë që të nënshtrojmë askënd, pa Fuqinë e All-llahut xh.sh.

Le të shqyrtojmë tani, sëmundjet e ndryshme të cilat e prekin njeriun. Në to, vërtet, kemi urtësi, por njeriu nuk i njeh dhe nuk i kupton këto urtësi. All-llahu xh.sh. me këto sëmundje, dëshiron që t'ua bëjë me dije mizorëve në rruzullin tokësor, që të mos tentojnë t'a mashtrojnë vetveten, me forcën dhe pushtetin që u ka dhënë Ai. All-llahu i Lartëmadhëruar, atyre iu thotë se forca juaj është zero, sepse sikur të dëshironte, Ai do t'iu shfaroste nga faqja e dheut, me anën e disa mikroorganizmave (bakterieve), të cilat vërtet janë mikroskopike, por janë shumë precize. Syri i njeriut nuk i sheh ato, megjithatë ato kanë fuqi shkatërrimtare, dhe e bëjnë njeriun të mos ketë mundësi të lëvizë fare. Ato i bëjnë njerëzit të dergjen në shtrat dhe të mos mund të ngrihen dot në këmbë.

Jo vetëm kaq, por ato i shkaktojnë njeriut edhe dhembje shumë të mëdha. Njeriu, këto gjallesa, nuk duhet t'i neglizhojë, sepse forca, mundësia dhe mendjemadhësia e tij nuk vlejnë fare, përpara këyre mikroorganizmave. Ai duhet t'a kuptojë se, këtu ka të bëjë me Fuqinë e All-llahut të Lartëmadhëruar. Le të mos harrojmë, se një ditë të afërme do të takohet me Zotin e tij, dhe duhet t'a ketë paraysh se atë ditë do të merret në pyetje. Atë ditë, nuk do të ketë me vete as fuqi, as privilegje, as mundësi e as ndihmuesit e tij, që i ka pasur në këtë botë. Atë ditë, All-llahu xh.sh., e ka cilësuar si vijon :

" يوم تبلي السرائر فماله من قوة ولا ناصر "

“Në ditën kur fshehtësitë do të shpalosen; njeriu nuk do të ketë as forcë, e as ndihmues.”⁷¹

Disa sëmundje, duken qartë se janë sinjale të drejtësisë së All-llahut xh.sh. Ai, i cili e tepron në ushqim, ai ka marrë më tepër se sa i takon nga ushqimi i begatisë së përgjithshme. Prandaj, All-llahu xh.sh., dikujt prej njerëzve, të cilët e kanë tepruar në ushqim gjatë së jetës së tyre, iu dërgon ndonjë sëmundje, me anën e së cilës ia ndalon ushqimin e tepruar. Për t’ia përkujtuar atij, se ai, për disa vite me rradhë, ka marrë më tepër ushqim, se sa i ka takuar, dhe kështu i kompesohet në vitet që i kanë ngelur me ushqim të racionalizuar.

P.sh. ata të cilët kanë ngrënë ëmbëlsira të shumta, për disa vite me rradhë, sëmuren nga sëmundja e sheqerit, dhe kështu atyre ju ndalohet nga mjekët të hanë më shumë se gjysmën e ëmbëlsirës së servuar. Nëse arrin një shkallë të përkeqësimit të tepërt të sëmundjes së sheqerit, ndoshta, të tillit do t’i ndalohet të hajë edhe bukën e bardhë, ose do t’i lejohen vetëm copëza të vogla buke. Por, mund të ndodhë që t’i ndalohen edhe shumë artikuj të tjerë ushqimorë, me përjashtim të bukës së zezë ose të thekrës, edhe pse më herët, ai ishte nga ata, që i përbuzte këto bukë, dhe kështu ai do të vazhdojë t’i kalojë vitet e mbetura të tij, deri në përfundimin e jetës në këtë botë.

Për këtë arsye, All-llahu i Lartëmadhëruar, thotë:

" و كلوا واشربوا و لا تسرفوا انه لا يحب المرفين "

“...dhe hani e pini, por mos e teproni, sepse Ai nuk i do ata që e teprojnë.”⁷²

Përderisa All-llahu xh.sh., na ka urdhëruar që t’a mbajmë drejtësinë, ndërsa del dikush dhe nuk i përmbahet kësaj drejtësie, atëherë, ai do të përjetojë atë që nuk e dëshiron, pasi ai i ka thyer rregullat e drejtësisë.

Ai, i cili e tepron p.sh. duke mos fjetur gjatë natës, ai do t’a ç’rregullojë shëndetin. Kështu, me kalimin e kohës, për shkak të përkeqësimit të shëndetit, ai do të kalojë në një gjendje, prej së cilës nuk do të mund të ngrihet prej shtratit. Ndoshta, dëshira e drejtësisë së All-llahu xh.sh. është që ai t’a plotësojë dhe kompesojë gjumin e pabërë, nëpërmjet sëmundjeve. I Lartësuari, në një hadith Kudsij thotë ⁷³:

" ان الله عز و جل يقول يوم القيامة:

يا ابن آدم. مرضت فلم تعدني . قال يا رب, و كيف أعودك و أنت رب العالمين؟ قال : أما علمت أن عبادي فلانا مرض فلم تعده . أما علمت أنك لو عدته لوجدتني عنده؟

⁷¹ Kur’an, 86 / 9-10

⁷² Kur’an, 7 / 31- Sipas përkthimit të Dr. Feti Mehdiut

⁷³ Hadith Kudsij – janë fjalët e All-llahut të shprehura prej Muhammedt s.a.v.s., e jo të thëna në Kur’an...

يا ابن آدم . استطعتمك فلم تطعمنيز قال : يا رب . و كيف أطعمك و انت رب العالمين؟ قال : أما علمت أنه أستطعمك عبي فلان فلم فلا تطعمه؟ أما علمت أنك لو أطعمته لوجدت ذلك عندي؟

يا ابن آدم. استسقيتك فلم تسقني . قال : يا رب, كيف أسقيك و أنت رب العلمين؟ قال : استسقاك عبي فلان فلم تسقه . أما انك لو سقيته لوجدته ذلك عندي.

Vërtet, All-llahu xh.sh., në Ditën e Gjykimit, do të thotë :

O bir i Ademit: U sëmura, por ti nuk më vizitove.

(Njeriu) Do të përgjigjet: O Zoti im; si të të vizitoja unë, kur Ti je Zoti i botëve?

(All-llahu do të) Thotë: Kur ti e kuptove se rob i im, filani, ishte sëmure, pse nuk e vizitove? A nuk e dije se po t'a vizitoje atë, do të më gjeje Mua aty, pranë tij!

O bir i Ademit: Të kam ushqyer, pse nuk më ushqeve?

(Njeriu) Do të përgjigjet: O Zoti im; si mund të të ushqeja unë, kur Ti je Zoti i botëve?

(All-llahu do të) Thotë: Kur ti e dije se të ka kërkuar të ushqyer rob i im, filani, atëherë pse ti nuk e ushqeve atë? Sikur t'a dije dhe t'a ushqeje atë, do t'a gjeje atë tek Unë!

O bir i Ademit: T'a kam larguar etjen, pse nuk m'a largove edhe ti atë?

(Njeriu) Do të përgjigjet: O Zoti im; si mund të t'a largoja unë Ty etjen, kur Ti je Zoti i botëve?

(All-llahu do të) Thotë: Të ka kërkuar largimin e etjes rob i im, filani, ndërsa ti nuk e shërbeve atë me ujë. Sikur t'a shërbeje me ujë, do t'a gjeje atë tek Unë!

Çdo i sëmure është afër All-llahut xh.sh., ai stimulohet me anë të sëmundjes së tij, sepse kjo sëmundje do t'ia lehtësojë dënimet në ahiret. Atij do t'i lehtësohet për aq, sa ka duruar dhembjet gjatë sëmundjes së tij. Kjo duhet të kuptohet si një privilegj, sepse është një shpagim shumë i madh. Faktin, që është i stimuluar nga All-llahu i Lartëmadhëruar, njeriu duhet t'a pranojë me kënaqësi, ashtu siç çdo i sëmure i pranon me kënaqësi shërbimet e dikujt në këtë botë. Edhe këtyre shërbyesve, qofshin ata, familjarët e tij apo jo, do t'iu shpaguehet munda i përpjekjeve të tyre, për t'ia kthyer forcën e humbur të afërmit të tyre, nga sëmundja që e ka kapluar.

A është 'vepër e shëmtuar', krijimi i personit me aftësi të kufizuar

Tani të shohim se çfarë statusi i kap personat me aftësi të kufizuar. Le të marrim në konsideratë personat, të cilët kanë lindur të verbër, të çalë, të paralizuar në këmbë, apo diku tjetër. Krijimi i njerëzve të tillë, a nuk duhet të konsiderohet si një vepër e shëmtuar?

Atyre, të cilëve bëjnë pyetje të tilla, iu themi: ju nuk kuptoni asgjë nga urtësia e All-llahut xh.sh.. Kemi shumë gjëra, shumë më të mëdha se këto, që sikur të ndodhte që ato të përplaseshin, do të ndodhnin katastrofa të madhe. Sikur dielli të përplasej me planetet, ose p.sh. sikur ai të eksplodonte, do të shkatërrohej i tërë universi. Për këtë arsye, themi

se krijesat e Zotit janë të krijuara në formën më të përsosur, dhe me një precizitet shumë të lartë. Ato nuk shmangen nga preciziteti i tyre për asnjë sekondë të vetme.

Le t'a lexojmë thënien e All-llahut xh.sh., në Kuranin Kerim:

" لا الشمس ينبغي لها أن تترك القمر ولا الليل سابق النهار و كل في فلك يسبحون "

“(është caktuar që) **Dielli, mos t’a arrijë hënën, e as nata t’a parakalojë ditën; të gjithë lundrojnë nëpër univers** (secila nëpër orbitën e vet).”⁷⁴

Këtë gjithësi, All-llahu xh.sh. e krijoi si një sistem të përsosur, dhe të përkryer. Në këtë univers ekziston edhe jeta në tokë, e cila nuk përjashtohet nga ky sistem i përsosur, përderisa është brenda universit. Jetë njerëzore është ngritur mbi bazën e individit, fisit, kombit dhe bashkësive (ummeteve). Brenda tyre, ekziston një përqindje shumë e vogël njerëzish, që është prekur apo që vuan nga mungesa e disa aftësive normale, sikurse i kanë të tjerët. Disa nuk janë në gjendje të flasin, disa të tjerë nuk mund të lëvizin. Nëse këta i krahasojmë me të tjerët që janë normalë, do t’a shonim që ata dallojnë dhe ndryshojnë, por ne nuk e dimë arsyen absolute të ekzistencës së këtij ndryshimi. Por ne këtu, mund të paraqesim dy qëllime, që All-llahu xh.sh. dëshiroi të na i tregojë.

Qëllimi i parë, ka të bëjë me sprovimin e begative që All-llahu xh.sh. na ka dhuruar. Nëse dikush takon një njeri të verbër dhe e dëgjon atë duke thënë: Falënderoj All-llahun xh.sh. i cili më shpëtoi prej shumë gjërave, prej të cilave janë duke u sprovuar krijesat e Tij⁷⁵, atëherë ai e ndien se edhe pse njeriu që ka përpara është i verbër, ai e falënderon All-llahun për mirësitë e tjera që i ka dhënë, dhe kështu, këtij njeriu i jepet mundësia të pendohet prej mëkateve, duke ju falënderuar begatisë së tij, që nuk i mungon asgjë.

Kështu është edhe me personin e paralizuar, i cili nuk ka mundësi të lëvizë. Ai shërben si një shembull sprove për njeriun e shëndoshë. All-llahu e sprovon nëse ai do të kthehet apo jo drejt qiellit, duke i ngritur duart lart dhe duke thënë: Të faleminderit o Zot, që më krijove të aftë që të mund të lëviz. Por, nëse gjatë jetës tënde, nuk sheh askënd me të meta fizike, a do të të ishte kujtuar një falënderim i tillë ndaj All-llahut, që të ka begatuar me gjithë këto aftësi të mrekullueshme fizike? Sigurisht që jo. Sepse, në këtë jetë dinamike, do t’a kishe harruar këtë lloj mirësie. All-llahu të ka dhuruar ty plot mirësi, dhe kështu do të të shtohet imani kur të dalin parasysh këta njerëz, pasi ata do t’i përkujtojnë begatitë dhe do të të kthjellin për t’a falënderuar Atë.

Qëllimi i dytë ka të bëjë me vetë fizikun tonë. Me këtë, i Lartësuari, sikur do të na thotë se ogranet, të cilat i kemi, nuk funksionojnë me dëshirën tonë njerëzore, por ato funksionojnë dhe i nënshtrohen urdhërit të All-llahut për të vepruar.

⁷⁴ Kur’an, 36 / 40

⁷⁵ Kur i verbëri e ndien veten se është i privilegjuar nga All-llahu, sepse ai nuk po sprovohet sikurse janë duke u sprovuar ata që nuk janë të verbër. D.m.th. Nuk mëkaton syri e atij që nuk sheh, ashtu siç mëkaton syri i atij që sheh.(kom. i përkthyesit).

Ti thua se ‘unë shoh me sytë e mi’. Por, All-llahu të ka dërguar shembuj, që të bindesh se edhe të tjerët kanë sy, por nuk shohin, derisa ty të bëhet e qartë se ti sheh me Fuqinë e All-llahut xh.sh. që ia ka dhënë syrit tënd cilësinë e të pamurit.

Ti, gjithashtu, thua se je duke ecur me këmbët e tua. Për këtë arsye, i Lartësuari të ka dërguar shembuj, për të të dëshmuar se njeriu i paralizuar i ka këmbët, por nuk ecën dot. Kjo, gjithashtu, është bërë me qëllim që ti t’a kuptosh se je duke ecur me Fuqinë e All-llahut xh.sh., që u ka dhënë këmbëve të tua mundësinë e lëvizjes.

Fillimi i mohimit

All-llahu i Lartësuar, gjithmonë dëshiron t’a largojë mashtrimin nga njeriu. Sepse mashtrimi është fillimi i mohimit të All-llahut xh.sh. Kur njeriu mashtrohet, mendon se ai nuk ka nevojë për All-llahu xh.sh.. Kur ai të ketë arritur në këtë shkallë të të menduarit, ai nuk e ndien veten se duhet t’a respektojë dhe të kërkojë pëlqimin e Tij! Në fakt, pse t’a ndiejë atë nevojë, kur ai mendon se është në gjendje të bëjë atë, që ai dëshiron t’a bëjë.

I Lartësuari dëshiron, nga Mëshira e Tij, t’i mbrojë robërit e Tij nga mashtrimi, dhe kush largohet nga All-llahu xh.sh., Ai ia përkujton se gjuha nuk është në gjendje të flasë pa lejen e Tij, syri nuk mund të shohë pa lejen e Tij, dhe gjithashtu edhe këmbët nuk mund të ecin pa lejen e Tij.

Me këto janë marrë shumë shkolla filozofike, të cilat janë përpjekur t’a shpjegojnë këtë Fuqi të All-llahut. Njëra, prej këtyre shkollave, thotë: Fuqinë e të Madhërishmit nuk e vërteton askush, përveçse qëndrueshmëria, e cila mbështetet në sistemin e organizuar dhe shumë preciz, që nuk tronditet për asnjë sekondë.

Një shkollë tjetër thotë: universi, të cilin e ka krijuar All-llahu xh.sh., nuk mund të jetë ndryshe nga ai që është, sepse ai mbështetet në një precizitet dhe lidhshmëri zinxhirore të mahnitshme. Kjo është një lëvizje që ka një mekanizim të Lartë. All-llahu qëndron mbi të, dhe bën zëvendësime dhe ndryshime si të dëshirojë Ai vetë. Vullneti i All-llahut xh.sh., nuk mund të kushtëzohet me ligje dhe rregulla të tjera. Lëvizjet mekanike dhe mosndryshimet, në njërën anë, tregojnë se universi mbështetet në themele të shëndosha, kurse ndryshimet, nga ana tjetër, tregojnë prezencën e Fuqisë së All-llahut xh.sh. në univers.

Edhe pse teori të kundërta, All-llahu xh.sh. është Ai, i Cili ka krijuar edhe njërën edhe tjetrën. Krijoi *precizitetin* për universin e sipërm, ndërsa krijoi *ndryshimet* për universin e ulët. Këtë, Lartëmadhëria e Tij e bëri për të dëshmuar se, në të, ka *precizitet në krijim dhe njëkohësisht të Shfaqë Fuqinë e Tij, të dyja së bashku*.

Për këtë arsye, të gjithë këta, që i shohim me aftësi të kufizuar (apo handikapatë), janë pak në përqindje. Këto na japin argumentin e Shpalosjes së Fuqisë së All-llahut në univers, se Ai krijon çka të dëshirojë dhe se çdo gjë mbështetet në vullnetin e All-llahut të Lartësuar. Nëse dëshiron Ai të krijojë diçka e krijon atë, e nëse nuk dëshiron, nuk e krijon atë.

Disa njerëz mund të pyesin: cili është faji i tyre që vuajnë? Këtyre njerëzve iu themi: All-llahu xh.sh. ua plotëson atyre mirësitë, duke u dhënë dhunti të tjera shtesë dhe, me to, i bën të barabartë me ata normalët. Atyre iu jep fuqi jo të zakonshme, duke ua plotësuar mungesën, nga e cila vuajnë. Atyre, gjithashtu, ua hap zemrat me krijesat e tjera, dhe i bën të tjerët të kujdesen, duke i siguruar të gjithë. Për këtë thuhet: *Secili që posedon mangësi, ka një fuqi tjetër mahnitëse*. Sepse këtyre, All-llahu xh.sh., iu jep fuqi për t'a plotësuar vetveten. I bën të dallueshëm në disa gjëra, që normalët nuk janë në gjendje t'i bëjnë.

Shembuj të këtyre kemi shumë...p.sh. Timur Lengu, njihet në mbarë botën për luftërat dhe betejat e tij, e ai në fakt ka qenë i çalë. Edhe pse e kishte këtë mangësi, ai kishte një ushtri që ishte shembull, për të gjithë komandantët normalë, sepse ai i mundi dhe i mposhti të gjithë ata që ishin normalë.

Urtësia tek abnormalët

Edhe në këtë çështje, gjithashtu, do të ndalemi. Duam të dimë se si qëndron puna me abnormalët (budallenjtë). All-llahu xh.sh., e ka veçuar dhe e ka dalluar njeriun nga krijesat e tjera me anë e mendjes, ndërsa budallai nuk ka mend. Nëse bëjmë një krahasim midis njerëzve normalë, dhe atyre abnormalë themi: All-llahu xh.sh. dëshiron të na tregojë se mendja është krijuar nga All-llahu, e ajo nuk është produkt i trurit të vetë qenies njerëzore. Kjo mendje që trashëgon civilizime, dhe ka bërë qytetërime kaq të mëdha në botë, është rezultat i mendjes që i është nënshtruar njeriut me urdhër të All-llahut, e jo nga forca e tij personale. O njeri! Mos mendo dhe mos e mashtro veten se mendja është shkathtësia jote. Mos llogarit se, me mendjen që ke, mund të mëvehtësohesh nga All-llahu xh.sh., ose të sjellësh për veten tënde ligje më të mira, se ligjet e All-llahut.

All-llahu xh.sh. e krijoi mendjen të lirë, të ketë mundësi zgjedhjeje kur i paraqiten alternativat, por ai gabon, kur mendon se mund të planifikojë dhe të projektojë programin e vet njerëzor, e të ndahet përfundimisht nga programi i All-llahut të Lartëmadhëruar. Ai, duke menduar se është duke bërë një ndryshim të “madh” në botë, është duke dëmtuar jetën e tij në tokë. Madje, ç’është e vërteta, ai është duke shkatërruar çdo gjë.

Pyetjes se: cili është faji i budallait, që është lindur i tillë? – i përgjigjemi se: All-llahu xh.sh. e ka veçuar dhe ka privilegjuar atë, duke i mundësuar që mos të merret në pyetje në këtë botë dhe në ahiret, për asgjë. Njeriu abnormal, në këtë botë, mund të marrë goditje dhe të vuajë. Ai, gjithashtu, mund t'i provokojë njerëzit e tjerë, duke i goditur me gur, apo edhe bën veprime të tjera shumë të këqija, por e mira (favori) e tij është se ai nuk merret në pyetje për to. Ai, kur bën veprime të tilla, mbase qesh edhe vetë prej sjelljeve të tij. Ai i konsieron ato gjëra, sikur nuk kanë të bëjnë aspak me të, sepse ai nuk logjikon.

Ai mund të të provokojë me lloj-lloj gjestesh. Ai mund të t'i grisë rrobat, por ti mos u hidhëro, sepse ai nuk llogaritet në këtë botë. Secili njeri në botë do të përgjigjet, sepse e kap llogaria, me përjashtim të atij që e ka humbur mendjen. Ky nuk merret në pyetje për

asnjë vepër, sepse për të dhënë llogari, duhet që njeriu të gëzojë lirinë e zgjedhjes, kurse ai nuk e ka këtë mundësi, pasi ai nuk ka alternativa të tjera para vetes.

Këto ishin disa ligjërata, rreth hajrit dhe sherrit në univers. Këto na shpjegojnë precizitetin, mbi të cilin është ngritur kjo jetë. Kjo është një peshore shumë precize, është shumë e drejtë. Ai, që nuk e ka mendjen të humbur, e ka këtë ngarkesë të peshores. Çdo gjë, në këtë univers, ka detyrën dhe qëllimin e vet, pa marrë parasysh nëse e njohim dhe e kuptojmë atë detyrë, apo nuk e kuptojmë qëllimin e saj. Secila krijesë e kryen detyrën e vet në jetë. Ato nuk presin që ne t'i kuptojmë, apo të presin për t'a marrë pëlqimin tonë. Disa prej njerëzve që e kalojnë jetën me arrogancë, e bëjnë këtë ose nga injoranca, ose nga vazhdimësia e ngjarjeve që u janë përplasur nga ndodhitë e mëhershme, ose nga pasionet të cilat dëshirojnë t'i realizojnë. Këto, atyre, nuk do t'iu realizohen prej All-lahut xh.sh., për shkak të Urtësisë së Tij, që është e panjohur për ta.

Lumturia e vërtetë në jetë është atëherë kur njeriu është i kënaqur me Fuqinë e All-lahut. Kjo kënaqësi, është ajo që vendos lumturinë në jetën njerëzore. Ndërsa mospëlqimi, ndaj asaj që ka caktuar All-llahu i Lartëmadhëruar, shkakton dëshpërim dhe vuajtje të vazhdueshme.

Lexojeni hadidhin Kudsij, ku Zoti i Plotëfuqishëm thotë:

“ Robi im, Unë dua, por edhe ti do. Nëse ke pëlqyer për sa Unë dua, do të të pasuroj aq sa dëshiron, por, nëse nuk ke pëlqyer për sa Unë dua, do të të lodh për sa dëshiroj, pastaj do të bëhet ajo që Unë dua.”

Kështu pra, pëlqeve apo nuk pëlqeve, urdhëri i All-lahut do të zbatohet, por pëlqimi për sa të ka caktuar All-llahu xh.sh., të jep mirësi në këtë botë (dhe në ahiret).

Por, nëse e injoron caktimin e All-lahut xh.sh., do të pësosh dëshprime, vuajtje në këtë botë dhe në ahiret.

Ky është kuptimi i hajrit dhe sherrit, për sa i përket ngjarjeve në univers. Drejtësia e All-lahut xh.sh. nuk e dallon një njeri prej tjetrit, përveçse me vepra të mira. Ndërsa, për sa i përket mendimit tonë, në lidhje me atë që na ndodh ne, nëse ishte një e mirë, apo një e keqe, kjo duhet të konsiderohet si një paragjykim i gabuar dhe injorancë nga ana jonë.

All-llahu xh.sh. thotë:

" ان الله لا يظلم الناس شيئا و لكن الناس أنفسهم يظلمون "

“Pa dyshim se All-llahu, asnjë njeriu nuk i bën të padrejtë, por njerëzit e dëmtojnë vetveten.”⁷⁶

Kapitulli i gjashtë

E mira dhe e keqja në ahiret

E mirë është ajo që afron tek All-llahu. Çdo gjë, që vepron dhe nuk të afron tek All-llahu xh.sh., dhe për të cilën nuk shpërblehesh në ahiret, nuk është e mirë, sado që të jetë e shtrenjtë dhe sado që të shpaguehet në këtë botë. Çdo vepër, e cila nuk të afron tek All-llahu xh.sh., është e kotë, ndërsa jeta jote në këtë botë është e kufizuar, dhe dije se shumë shpejt do të përgjigjesh për të. Nëse ke investuar tërë jetën tënde sipas programit të All-llahut xh.sh., ke për të korrur sukses, por nëse ke investuar gabimisht në mëkate, dhe nuk e ke përfillur programin e All-llahut të Lartëmadhëruar, do të jesh humbës, dhe sigurisht që do të ndëshkohesh.

Për këtë, i Lartësuari xh.sh., thotë:

" فمن زحزح عن النار و أدخل الجنة فقد فاز "

"...kush do t'i largohet zjarrit (xhehennemit), dhe do të hynte në xhennet, ai ka arritur fitore ..."⁷⁷

Pra, sukses është vetëm atëherë, kur ke arritur të shpëtosh nga zjarri (xhehennemi). Ashtu siç thamë edhe më parë, jeta e kësaj bote nuk është qëllimi i fundit, por kjo është dera provuese (laboratori), që të shpie deri tek qëllimi. Ky është programi i mirë, dhe programi i keq në univers, ashtu si e ka paraparë i Lartëmadhëruari. Kështu e kanë shpjeguar edhe shumë hadithe⁷⁸, njëri prej të cilëve thotë:

(Do të vazhdojë të qëndrojë rob i seancës të Ditës së Gjykimit, derisa nuk do të përfundojnë së pyeturi atë për katër cilësi të tij: rininë ku e ka kaluar, jetën si e ka përfunduar, pasurinë si e ka fituar dhe ku e ka shpenzuar, dhe çfarë ka bërë me punën e vet.)

Nëse i kthehemi Kur'anit Kerim, do të shohim se, punët e mira duhen bërë shpejt, sepse aty është mirësia e All-llahut.

Le t'a lexojmë thënien e All-llahut të Lartëmadhëruar:

" و ما تقدموا لأنفسكم من خير تجدوه عند الله "

"...e çfarëdo të mirë t'a bëni për veten tuaj, do t'a gjeni atë tek All-llahu..."⁷⁹

⁷⁷ Kur'an, 3 / 185

⁷⁸ Hadithe- quhen të gjitha fjalët, pëlqimet dhe tradita e Muhammedit s.a.v.s.

⁷⁹ Kur'an, 2 / 110

Nëse lexojmë suren Ali Imran, për të parë se çfarë na thuhet dhe çfarë na mëson ajo, do të shohim se, i Lartësuari na tregon rrugën, në të cilën duhet të drejtohem, na tregon se si t'a falënderojmë, se si të afrohem Atij dhe si t'a njohim mirësinë e Tij.

Kështu, në Kur'an, thuhet:

"بِيدِكَ الْخَيْرُ أَنْكَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ"

"...e mira është në dorën Tënde, vërtetë Ti, për çdo gjë, je i Plotëfuqishëm."⁸⁰

Pra, e mira në tërësi është vetëm e All-llahut; prandaj e mira nuk mund të jetë në duart e dikujt tjetër, por veçse në duart e All-llahut xh.sh.

Le t'a lexojmë edhe thënien tjetër:

"وَمَا عِنْدَ اللَّهِ خَيْرٌ لِلْأَبْرَارِ"

"...dhe mirësitë, që gjenden tek All-llahu, janë për Ebrarët."⁸¹

Përderisa arritëm deri te ky rezultat, atëherë duhet të jemi të bindur, pa asnjë mëdyshje, se e mira është plotësisht në duart e All-llahut xh.sh. Veprat tona të mira janë ato, të cilat kanë pëlqimin e All-llahut. Çdo orë që kalon, duhet të jetë orë, në të cilën i kemi shërbyer të mirës, që ka pëlqimin e All-llahut xh.sh. Dije se ajo orë, në të cilën ti nuk i shërben së mirës, është orë e humbur për ty, nga jeta jote e shtrenjtë. Ke humbur një orë së koti, pa realizuar asgjë, një orë të jetës tënde!! Sado që të zgjasë jeta jote, ajo është e kufizuar, dhe secili moment, që të ka ikur, nuk kthehet më kurrë.

Imani është kusht për t'u pranuar veprat

A mund të konsiderohet e mira e kësaj bote, si e mirë absolute? Apo, ajo duhet të jetë e lidhur me imanin? Nëse ne bëjmë një të mirë, duke mos patur iman (besim) në All-llahun xh.sh., dhe duke mos i besuar të gjithë të dërguarit e Tij (pejgamberët), a na llogaritet kjo vepër si e mirë tek All-llahu i Lartëmadhëruar?

Kemi shumë njerëz që janë të angazhuar me veprime humane bamirëse. Si të tillë mund të përmendim, p.sh. shpikësit (novatorët), të cilët kanë zbuluar gjëra të ndryshme, prej të cilave ka dobi mbarë njerëzimi. Kemi prej tyre, që kanë shpikur barërat e disa sëmundjeve të rënda, prej së cilave vuajnë shumë njerëz. Dhe jo vetëm që i kanë shpikur, por ato ilaçe (barëra) i kanë dhënë donacione nëpër spitale, apo edhe kanë shkuar personalisht në vendet e rrezikuara prej sëmundjeve të rënda, për t'a dhënë kontributin e tyre humanitar. Dikush tjetër ka paraparë, që për të kontribuar me akte bamirësie, të bëjë aktivitete në nivel shoqatash, dhe në sajë të tyre ka arritur të bëjë grumbullimin e të mirave materiale, ushqimore etj, dhe ato i ka dërguar në vendet, ku është paraqitur

⁸⁰ Kur'an, 3 / 26

⁸¹ Kur'an, 3 / 198 – Ebrarët, janë besimtarët e pastër, që në këtë botë janë të dënuar padrejtësisht nga njerëzimi, ose të cilëve u janë bërë shpifje, etj. (All-llahu e di më së miri, Koment i përkthyesit).

skamja ekstreme, pra, aty ku njerëzit vdesin nga uria. Ose, ka njerëz që bëjnë veprave të tjera të mira, që All-llahu xh.sh. ua ka urdhëruar robërve të Tij besimtarë. Këtyre, i Lartësuari, u ka premtuar shpërblime (sevape) të mëdha në ahiret.

Nëse, këta që kanë bërë mirë, nuk e kanë bërë atë (mirësi) me ndjenjën e imanit, por ajo bamirësi ka rrjedhur nga logjika e tyre e ndjenjës humanitare (njerëzore), apo nga përpjekjet për t'ua zbutur dhembjet njerëzve, apo thjesht për t'i ndihmuar ata, atëherë cili është gjykimi për ta?

Përgjigja e kësaj pyetjeje është: të gjithë këtyre bamirësve, nuk iu shkruhet asnjë sevap tek All-llahu xh.sh., edhe pse ata kanë dhënë mundin dhe djersën e tyre për vepra bamirësie, por, ata, nuk e kanë bërë ato, në emër të All-llahut. Pra, puna e tyre nuk ka dalë si rezultat i imanit të pastër.

Për këtë, i Lartësuari, në Kuranin Kerim, thotë:

"وَمَنْ يَعْمَلْ مِنَ الصَّالِحَاتِ وَهُوَ مُؤْمِنٌ فَلَا يَخَافُ ظُلْمًا وَلَا هَضْمًا"

“Ndërsa kush bën vepra të mira dhe është besimtar, të mos frikësohet nga mizoritë (e mundshme), e as nga humbjet (e kompetencave).”⁸²

Pra, kusht për t'u pranuar një bamirësi, është imani. Së pari, duhet të kesh iman, e pastaj të drejtohesh drejt veprave bamirëse, në emër të All-llahut të Lartëmadhëruar. Së dyti, nëse dikush jep donacion, ndoshta një shumë të madhe parash për një shoqatë bamirëse, për shkak se, kryetarja e asaj shoqate, e ka burrin në një pozitë të lartë, duka shpresuar që të ndihmohet prej tij, gjithashtu, edhe kjo vepër, nuk është e pranuar tek All-llahu xh.sh.

Ose ai, që e jep pasurinë ose donacionin, me qëllim që të tjerët t'i thonë ‘bamirës i madh’, apo njeri bujar, apo takva⁸³, apo të ngjajshme me këto. Nëse ai e bën këtë vetëm me qëllim që t'i dalë (ngrihet) emri, dhe nuk e bën për hir të All-llahut xh.sh., ky njeri nuk ka për t'u shpërblyer tek All-llahu xh.sh.

Të gjithë ata, që bëhen bashkëpjesëmarrës me All-llahun, ndërsa qëllimet i kanë për përfitime të kësaj bote, atyre, kjo vepër, nuk iu regjistrohet si vepër e mirë. Ata, janë përpjekur që të arrijnë deri tek qëllimet e tyre, me anën e këtyre veprimeve. All-llahu i Lartëmadhëruar është më i pasur se të gjithë bashkëpjesëmarrësit, në një punë bamirësie.

Por, a i lë All-llahu këta persona pa sevape?

Nga drejtësia e Tij, Ai do t'u japë atyre sevape për aq sa ata kanë punuar. Ky sevap duhet të jetë i të njëjtit llojit, sikurse ai i punës së tyre. Pra, atyre sevapi do t'u shpaguehet në këtë botë, por, në ahiret, ata nuk do të gjejnë asnjë sevap, e as ndonjë vepër të mirë.

Për këtë arsye, shohim se Kur'ani Kerim thotë:

⁸² Kur'an, 20 / 112

⁸³ Takva – njeri që i frikësohet All-llahut

" من كان يريد العاجلة عجلنا له فيها ما نشاء لمن نريد ثم جعلنا له جهنم يصلاها مذموما مدحورا "

“Kush dëshiron (kënaqësi) të përshpejtuar (në këtë botë)⁸⁴, ia përshpejtojmë atë që Ne duam, dhe kujt të duam, më pastaj ia përgatisim xhehennemin, në të cilin do të digjet i turpëruar dhe i nënçmuar.”⁸⁵

Pra, këta që merren me bamirësi, por që nuk besojnë në All-llahun xh.sh., ose nuk kanë për qëllim që, atë vepër bamirësie, t’a bëjnë për hir të All-llahut xh.sh., atyre të mirat që bëjnë, iu shpaguhen në këtë botë. Emrat e tyre i sheh nëpër rrugët e qyteteve, ngrihen përmendore për hir të tyre, vendosen lapidare madhështorë nëpër qendrat e qyteteve, dekorohen me tituj të shumtë nderi, emrat e tyre mbeten në histori, jetëshkrimet e tyre mësohen nëpër klasa të ndryshme të shkollave, pra, ata bëhen të njohur e të famshëm. Ky do të ishte sevapi tyre (në këtë botë), pra do të jetë i të njëjtit lloj, sikurse ai i veprave të tyre.

All-llahu xh.sh. dëshiron që ne (besimtarët) të përballemi me ndodhitë e botës me ndjenjën ose fuqinë e imanit tonë. Të mos zemërohem dhe pikëllohem prej ndodhive të ndryshme, sado shtrenjtë që të na kushtojnë. Për këtë arsye, i Lartëmadhëruari, na ka dhënë standartet dhe normativat, me të cilat ne duhet t’i peshojmë ngjarjet dhe rëndësitë e tyre. Kjo, nuk do të thotë se, veprat tona i merr era. Ndodhitë, vërtet, na i mbushin zemrat plot zemërim dhe pikëllim, por në anën tjetër, All-llahu na ka dhënë standartet e vërteta, me të cilat ne duhet të punojmë, dhe ato, me të cilat ne duhet të masim.

Prej kërkesave të para të All-llahut xh.sh. ndaj nesh, është që të jemi shumë të kujdesshëm nga pasionet dhe emocionet e gjërave që na ndodhin në këtë botë. Ne ato duhet t’i marrim, si sprova. Pra, duhet t’a kuptojmë se jemi duke u sprovuar me to, drejtëpërdrejt nga All-llahut xh.sh.

Ne besojmë se këto ndodhi ishin të shkruara tek Ai, para se të krijohej toka dhe ç’ka në të. Se ato janë kadere⁸⁶ prej All-llahut, të cilat zbresin në kohëra të ndryshme. Për këtë arsye, prej nesh kërkohet, që ato të mos t’i përfetojmë me zemërim të thellë, mërzi apo vajtim, në mënyrë që me sjelljet tona prej besimtari, të mos t’a ç’ekuilibrojmë besimin tonë dhe, kështu, All-llahu të hidhërohet me ne. Gjithashtu, duhet edhe të mos gëzohemi shumë në raste të veçanta. Këtë gëzim duhet t’a shfaqim vetëm atëherë, kur e ndiejmë se do të marrim sevape prej All-llahu xh.sh. Ky pra, do të ishte një standart i vërtetë, në bazë të të cilit duhet t’i masim detyrimisht ndodhitë tona.

I Lartësuarit thotë:

" ما أصاب من مصيبة في الأرض و لا في أنفسكم الا في كتاب من قبل أن نبرأها ان ذلك علي الله يسير لكيلا تأسوا علي ما فاتكم و لا تفرحوا بما آتاكم و الله لا يحب كل مختال فخور "

⁸⁴ Me shprehjen – Kush dëshiron të përshpejtuarën-d.m.th. (shpagimin e të mirës, ose arritjen e qëllimit në këtë botë, do t’ia japim atë, por në ahiret, atij nuk i mbetet asgjë), shënim i përkthyesit.

⁸⁵ Kur’an, 17 / 18

⁸⁶ Kader – shiko fusnotën numër 56 të këtij libri

“Nuk e godet fatkeqësia askënd në tokë, e as juve, e të mos jetë (e shkruar) në libër, para se t’a zbatonim (në vepër). Ajo, njëmend, është e lehtë për All-llahun. Që ju t’a harroni atë, ç’ka ju ka kaluar (nga pikëllimi-mërzitja), por as të mos i gëzoheni tepër asaj, çka ju është dhënë (prej mirësive). All-llahu nuk i do lavdëruesit mendjemëdhenj.”⁸⁷

Pra, këto janë karakteristikat, të cilat i posedon njeriu i pajisur me iman. Këto cilësi dëshiron, All-llahu xh.sh., që t’i shohë prej nesh. Ai na ngacmon, ose na sprovon me lloj-lloj ndodhish, sepse kjo botë është botë mashtrimesh. Sot je i pasur, nesër bëhesh i varfër, sot ndjehesh i fuqishëm, nesër dobësohesh, sot je krenar, nesër mbetesh i poshtëruar...

Këto mashtrime naive janë prej cilësive të kësaj bote, prandaj ato duhet të pranohen ashtu siç janë. Nëse tani koha është e errët, nesër bëhet dritë. Nëse sot dita ishte e vështirë, nesër bëhet më e lehtë. Kështu duhen përjetuar ngjarjet, të gjitha gjërat ndryshojnë, por gjëja që nuk ndryshon është vepra, e cila bëhet për (t’u shpërblyer në) ahiret. Prandaj, i Lartëmadhëruari kërkon që ne t’i kushtojmë vëmendje kësaj. Kjo arrihet vetëm atëherë, kur mendjet tona preokupohen për bamirësitë që shpaguhën edhe në ahiret.

Ishte një herë një njeri i mirë, i cili sa herë që i shkonte lypsari për t’i kërkuar para, ose ushqim, ai e përgëzonte se do të merrte atë që kishte për t’ia dhënë. Ky njeri e priste atë (lypsarin) me shumë mirëseardhje. Atij i thoshte: mirëse erdhe o ti, që i bart të mirat e mia deri në ahiret. Ai ishte i bindur se shkuarja e lypsarit tek ai, ishte një e mirë e madhe për të. Ai e dinte se, pasuri e tij e depozituar ishte ajo, që ai ia jepte lypsarit, ndërsa pasuri të humbur ai e konsideronte atë, që e hante vetë, apo ato para që ai shpenzonte. Pra, sadakaja konsiderohet pasuri e depozituar, sepse këtë të mirë, njeriu shpreson se All-llahu do t’ia kompensojë shumëfish, në ahiret.

All-llahu xh.dh. na ka këshilluar që, ndodhive të ndryshme, të mos t’u japim ngjyrimë të shumta, të cilat zakonisht qarkullojnë brenda nesh. Ne duhet t’i lëmë ashtu siç janë, e mos t’i komentojmë me filozofira të ndryshme.

Për këtë, i Lartësuari, në Kur’anin Kerim, thotë:

ا

"و عسي أن تكرهوا شيئا و هو خير لكم "

““Ndodh që ju t’a urreni ndonjë gjë, por ajo (në realitet) është (përcaktuar të jetë) e mirë për ju.”⁸⁸

dhe ajeti tjetër:

" ف عسي أن تكرهوا شيئا و يجعل الله فيه خيرا كثيرا "

⁸⁷ Kur’an, 57 / 22-23

⁸⁸ Kur’an, 2 / 216

“...ndodh që ju t’a urreni ndonjë gjë, por All-llahu (në realitet) në të sjell të mira të shumta.”⁸⁹

All-llahu xh.sh. me këtë, sikur do të na japë realitetin imanor të ndodhisë, e cila po na përcjell. Nëse na ndodh diçka, që do të ishte e urryer për ne, ne menjëherë duhet t’i përkujtojmë këto ajete, dhe të themi: mbase, i Lartësuari ka paraparë me këtë ndodhi “të urryer”, diçka shumë më të mirë për ne. Nuk i dihet, sepse ndoshta kjo ngjarje e vështirë do të zëvendësohet me shumë ngjarje të tjera më të mira. Kjo formë e të menduarit ia lehtëson dhembjet qenies njerëzore, kur atë e godet një ndodhi tmerruese. Me këto ajete, Ai na bën, që të jemi gjithmonë optimistë në jetë. Gjithashtu, i Lartësuari, me këto ajete na bën të kuptojmë, se sjelljet tona e përcaktojnë të keqen.

Shumë pej njerëzve pyesin: a nuk është televizioni një e keqe e madhe? Njerëzit do të merren në pyetje, në bazë të veprave të tyre. Ata do të pyeten prej Zotit për namazin, lutjet, dhe veprat e tjera që bëjnë. Njerëzve që pyesin në lidhje me televizionin u themi: ne nuk mund t’a gjykojmë televizionin se është i keq, por mënyra se si e përdor njerëzimi atë, është e mirë ose e keqe.

Sikur televizioni t’u mësonte njerëzve fenë e tyre të vërtetë, t’iu sillte argumente se duhet të falen, se duhet të japin zeqatin⁹⁰, e të tjera prej dispozitave të Islamit, ai do të ishte i mirë. Por, nëse programi i televizionit mbushet me këngë, spektakle, apo me lojëra të diskotekave, apo me jetën e klubeve të natës, pra shkurt, me ato që e largojnë njeriun nga feja e tij, kuptohet së është i dëmshëm.

Pra, vetë televizioni nuk është as i mirë, e as i keq, por mënyra se si e përdor atë, ia jep atij, kuptimin dhe përgjigjen, njëkohësisht. Njëloj sikur thika. Me të, mund të bëhesh kriminel dhe, me të, mund shërbehesh në kuzhinë, për nevoja të ndryshme. Nëse atë e përdor për nevojat e kuzhinës, në të ka të mira, por nëse atë e përdor për qëllime kriminale, atëherë është e keqe.

All-llahu xh.sh., në Kur’anin Kerim, na ka dhënë shumë shembuj, që ne të bëhemi prej atyre, që secilit send t’i japim kuptimin e vet ekzistues.

I Lartësuari thotë:

" و من ثمرات النخل و الأعناب تتخذون منه سكرًا و رزقًا حسنًا ان في ذلك لآية لقوم يعقلون "

“Edhe prej frutave të hurmës dhe të rrushit, po nxirrni lëngun dehës, si dhe ushqim shumë të mirë. Vërtetë, në të ka argumente, për ata njerëz që mendojnë.”⁹¹

Me këtë, Lartëmadhëria e Tij, dëshiroi të na tregojë se kuptimin e së mirës apo së keqes, e jep përdorimi i një sendi, e jo vetë ai send apo mjet. P.sh. rrushin dhe hurmën, All-llahu xh.sh. i krijoi si risk të mirë për njeriun. Ato na shijojnë, na japin kalori, dhe kanë të tjera

⁸⁹ Kur’an, 4 / 19

⁹⁰ Zeqat- tatim që u jepet të varfërve për hir të Zotit

⁹¹ Kur’an, 16 / 67

mirësi për ne. Në to nuk ka ndonjë të keqe, dhe ato nuk janë të dëmshme për njeriun. Por çfarë bëri njeriu prej tyre?

Njerëzit i morën si risk të mirë dhe i shndërruan në risk jo të mirë, në alkool. Ata, prej tyre, nxorën verën, me anën e së cilës humbasin mendjen, dhe bëjnë veprime të tjera të dëmshme. Kjo konsiderohet prej veprave të këqija më të mëdha, sepse alkooli është themeli i të gjithë keqbërjeve në botë.

A mos vallë, All-llahu xh.sh., e krijoi rrushin dhe hurmën, për këtë qëllim? A i krijoi ato, që t'a ndihmojnë njeriun që të pijë alkool dhe të bëjë mëkate? Gjithësesi jo. Pra, kush ua humbi dhe ua ndryshoi vlerat dhe detyrat e tyre, nga ajo për të cilën ato ishin krijuar në këtë jetë? Kush i shndërroi prej riskut të mirë, në risk të keq?

Ishte vetë njeriu ai, i cili i mori këto begati dhe e shkatërroi veten e tij dhe vlerat e tyre. Me këtë, ai ndihmoi të keqen, e cila e çoi pastaj në mëkat dhe armiqësi, në vend se t'i përdorte për të mirën e vet këto të mira, dhe t'a falënderonte All-llahun xh.sh. për to.

E keqja dhe etjet (orekset) njerëzore

All-llah xh.sh. e krijoi diellin për t'a ndiçuar dhe për t'a ngrohur tokën. Ai i jep gjallëri bimëve, kafshëve dhe njeriut, dhe të gjithëve atyre që kanë nevojë. Kështu, ai e kryen detyrën e vet në univers. Me anën e dritës marrin frymë bimët, prej tyre del oksigjeni dhe kështu bëhet e mundshme jeta në tokë. Me anën e dritës, kafshët, gjithashtu, e kryejnë detyrën e tyre. Drita i jep gjallëri edhe njeriut. Ajo e nxit atë për punë, dhe kështu ai e ndërton dhe e rregullon planetin tokë. Prej tij (diellit), njeriu arrin të ngrohet, aq sa ka nevojë për jetën e tij. Por, ka pasur njerëz, që e kanë adhuruar atë, sepse dielli është një krijesë që i sjell të mira të mëdha njerëzimit. Për këtë arsye, dikush e shndërroi në sherr të vetvetes, sepse ai u bë shkak, që dikush prej njerëzve t'a mohojë All-llahun xh.sh. (dhe t'a adhurojë diellin)!

Dielli nuk i urdhëroi njerëzit, që t'a besonin. Kurrë ndonjëherë, ai nuk ka kërkuar që të adhurohet, po ashtu, kurrë ndonjëherë, nuk ka dërguar misionarë, që të kërkojnë prej njerëzimit që t'a adhuronin atë. Ai nuk ka dërguar as program, me qëllim që t'i tregonte njerëzimit mënyrën e adhurimit. Ai kurrë, nuk e ka kërkuar një gjë të tillë. Ai, vetë, është i nënshtruar dhe është falënderues, pasi vetë preciziteti dhe lëvizja, që ai bën në univers, e dëshmon këtë. Pra, njeriu, vetë i shkaktoi vetes bela.

Kështu është edhe me gurët. Prej tyre ka shumë të mira, por fatkeqësisht, një pjesë e madhe e njerëzimit, i shndërroi ata, në objekte të adhuruara, duke gdhendur me ta puta apo idhuj! Gjërat që gjenden në tokë (univers), nuk janë krijuar që t'i ndihmojnë shkatërrimit, por ato janë krijesa që synojnë të mirën. Secila krijesë e kryen detyrën e vet për mrekulli, në mënyrë të përsosur, por e keqja dhe shkatërrimi erdhi nga njeriu. Gjithashtu, edhe mohimi i Zotit, erdhi prej njeriut.

Duke u bazuar në këto sa thamë më sipër, ne, duhet patjetër t'a kuptojmë thelbin e jetës së kësaj bote, dhe jo t'a marrim atë mbi bazat e shthurjes, që vjen, apo shkaktohet prej njeriut. Kush i vendosi këto rregulla? Pa dyshim, është ai, i cili po shkakton shthurje në tokë dhe ai, i cili dëshiron të përfitojë vetëm për veten e vet. Është ai, i cili synon pushtetin për një periudhë kohore, dhe dëshiron të bëhet zot i saj. Pra, ai, i cili e përdor thikën për të vrarë, ka për qëllim që të arrijë të përvetësojë një pasuri, që nuk i takon atij. Ai, i cili i thërret të tjerët të besojnë diellin, ka për qëllim që të bëhet falltor i madh, dhe me këtë marifet, të marrë të mirat e të tjerëve, pa punuar. Ai, i cili i fton njerëzit që të adhurojnë putat, ka për qëllim që të bëhet vetë "zot", që t'i frikësohen të tjerët dhe, njëkohësisht, synon që masa t'i afrohet atij, sepse ai është "shërbëtori i Hyjnisë". Ndërsa, ai, i cili e fton njerëzimin në gjëra të kota, së pari hulumton që të përfitojë nga të mirat e kësaj bote, pastaj përpiket t'i shërbejë të kotës. Këto dobi ndoshta do t'a ngrënë atë, dhe ai do të mund të radhitet në një rresht me bosët e pasur, apo me pushtetarët politikanë, pra ai do të hyjë në radhët VIP-ave të kësaj bote (por në botën tjetër, ai do të jetë prej më të dëshpëruarve).

Ndërsa ai, i cili e thërret njerëzimin të besojë All-llahun xh.sh., ai investon nga buxheti tij për këtë thirrje, dhe nuk përfiton materialisht asgjë prej saj. Investimi në emër të All-llahut, këtë thirrje e bën të kënaqur dhe të privilegjuar, që i është dhënë mundësia të investojë edhe materialisht. Paguej prej pasurisë së vet, dhe është i lumtur. Ai është njeri që e ngarkon veten me mundime dhe e obligon veten me adhurim. Qëllimi i tij i vetëm është që All-llahu xh.sh. t'ia pranojë mundin dhe t'ia shënojë atë si vepër të mirë.

I Lartësuari, dëshiroi të na tregojë se standartet janë të ndryshme. Ai, për këtë, thotë:

"و لا يحسبن الذين يبخلون بما آتاهم الله من فضله هو خيرا لهم بل هو شر لهم"

"Le të mos mendojnë kopracët, se janë duke bërë mirë me atë pasuri, që jua ka dhënë All-llahu, jo, ajo për ta është e keqe..."⁹²

Investimi i pasurisë në këtë jetë, duhet të kuptohet kështu: detyra e shejtanit është, që sa më shumë t'i bindë njerëzit, që mos të investojnë në emër të All-llahut, duke i frikësuar ata me varfëri. Në lidhje me këtë, i Dërguari All-llahut, Muhammedi s.a.v.s. ka thënë:

"Pasuria nuk pakësohet nga sadakaja".

Pra, sadaka nuk e pakëson pasurinë, përkundrazi e siguron, dhe e bën më të begatë. Kur kemi pranë vetes begatinë (e dhënë nga All-llahu si shpërblim për dhënien e sadakasë, nga ana jonë), ajo vetvetiu jep më shumë se sa kemi menduar. Ose mund të japë më shumë të mira, se sa jep normalisht pasuria.

Dhënia është begati (bereketi), dhe këtë All-llahu ua mundëson besimtarëve të Tij. Kemi raste kur risku është i pakët, por me atë pak që kemi, i mbulojmë të gjitha nevojat tona. Ushqimi, i cili është i përgatitur për dy persona, është i mjaftueshëm për t'u ushqyer edhe pesë persona, madje edhe të ngopen. Por risku iu duket njerëzve i paktë, ngase sytë e tyre

⁹² Kur'an, 3 / 180

nuk ngopen. Ata nuk munden të paramendojnë, e as nuk e mundojnë veten të kuptojnë më shumë, se sa e kanë potencialin e tyre energjik të të kuptuarit. Qëllon që të shohësh një njeri, i cili kalon jetë të lumtur, të qetë dhe nuk mërzhitet për asgjë. Duket qartë se ai e ka shpirtin e qetë, sepse është gjithmonë i lidhur fuqimisht me All-llahun. Këtë person, All-llahu xh.sh., e mbron nga hidhërimet e jetës. Nëse p.sh., dikush prej të afërmeve të tij sëmuret, atij do t'i mjaftojë që t'i japë vetëm një kokër aspirinë dhe një gotë çaj, dhe ai ka për t'u shëruar. Ndërsa ai, i cili nuk ka dhënë sadaka, kur t'i sëmuret fëmija, dëshpërohet tepër, sepse edhe pse ka sjellë shumë mjekë dhe ka dhënë shumë para, mund të ndodhë që fëmija i tij të mos shërohet.

Njeriut i rritet risku i bereqetit, kur ai njeri, brenda mundësive që ka, kryen vepra bamirësie, të cilat bëhen shkak, që All-llahu t'i japë atij edhe më shumë pasuri. Nganjëherë, All-llahu e pasuron njeriun, kur ia largon atij shpenzimet që duhej të kryente. Shohim p.sh. se si djali i tij, korr suksese të njëpasnjëshme në shkollë, pa marrë mësim shtesë, ndërkohë që fëmijët e tjerë për të arritur deri tek sukseset e tij, iu duhet që prindërit e tyre të shpenzojnë qindra funta (ose euro) për mësim shtesë, dhe prapë se prapë nuk e arrijnë suksesin e tij, madje mund të ndodhë që edhe të mos kalojnë, apo të mos dalin tek më të mirët. Sheh se fëmijëve të tij nuk iu ndodh asnjë e keqe, dhe askush prej tyre nuk i afrohet bixhozit, as drogave, ose gjëra të kësaj natyre, që e shkatërrojnë trupin dhe pasurinë.

Sheh se si gruaja dhe fëmijët e këtij burri, edhe pse blejnë roba të lira dhe të thjeshta, gëzohen dhe ndihen të lumtur me to (pa u ndjerë aspak inferiorë, që teshat e tyre nuk u përkasin firmave të njohura).

Ndërsa, të tjerët, të cilët nuk janë të kujdesshëm ndaj pasurisë së tyre, nuk janë të lumtur dhe kanë një jetë të dëshpëruar. Do të shohësh se si, kur burri i blen një fustan shumë të shtrenjtë gruas së tij, ajo ia hedh fytyrës, mrrolet dhe shpreh pakënaqësinë e saj (sepse e dëshiron fustanin të jetë akoma më luksoz dhe i shtrenjtë). Ai, prej kësaj pasurie, nuk merr asgjë, përveç dëshpërimit dhe pakënaqësisë në këtë jetë.

Ne duhet t'a dimë se begati nuk është vetëm kur të dhurohet pasuri e shumtë, sepse ajo në të njëjtën kohë mund të të kthehet bumerang dhe të bëhet shkatërruese e jetës. Por pasuria, sado e vogël qoftë ajo, nëse e ka bekimin e All-llahut, është e mjaftueshme dhe e frytshme për jetën e secilit prej nesh. Kjo pasuri i mbulon nevojat tona, dhe sjell lumturi e të më mira të mëdha në jetën tonë.

Njeriu që ka para, e që nuk investon për t'a qarkulluar paranë, e as nuk jep sadaka prej saj, mendon se është duke i bërë vetes mirë, por në realitet ai është duke e dëmtuar vetveten. Me këtë mentalitet, ai i nuk afrohet All-llahu, madje edhe pse e di, se ajo pasuri nuk do t'i mbetet atij, sepse atë do ta lërë mbi tokë kur të vdesë.

Mosbesimi – kupola e të gjitha të këqijave në botë

Kulmi i të këqijave të mëdha në këtë jetë është mosbesimi. Nuk ka të keqe më të madhe se kjo. Nuk ka përgjegjësi tjetër, pas mosbesimit. Për shkak se, ky mohues, ka bërë mëkat aq të madh, saqë e ka detyruar All-llahun t'a përzerë nga Mëshira e Tij.

Për këtë arsye, i Lartëmadhëruari, thotë:

" ان الله لا يغفر أن يشرك به و يغفر ما دون ذلك لمن يشاء "

“Vërtet, All-llahu nuk e fal atë (njeri) që Atij i ka bërë shok, ndërsa i fal të gjithë të tjerët, që Ai dëshiron...”⁹³

Ai, i cili i ka bërë shok All-llahut, ose e ka mohuar Atë, edhe sikur t'i jepej e tërë pasuria e botës, ajo do të ishte e dëmshme për të. Sado që ai të marrë dhe të rrëmbejë prej kësaj bote, të mirat e saj janë të vogla dhe të përkohshme. Po ashtu, sado të ketë pasuri, mirëqenie dhe pushtet, ai, një ditë, do të ndahet prej tyre.

Për këtë shkak, i Lartësuari, thotë:

" ان شر الدواب عند الله الذين كفروا فهم لا يؤمنون "

“Prej krijesave më të këqija tek All-llahu janë ata, të cilët e kanë përgënjeshtruar (mohuar All-llahun) sepse ata nuk besuan.”⁹⁴

Ne e dimë se kafshët nuk logjikojnë⁹⁵, ato, pra, nuk mendojnë. Ato nuk mund t'i parashikojnë gjërat, prandaj jetojnë në mënyrë instiktive. Instikti i ka reagimet shumë të sakta. Kur ndonjë kafshe i ofron ushqim, dhe përpiqesh që t'a mashtrosh, ajo do të refuzojë, për shkak se kundërpërgjigjet me anë të instiktit, të cilin e ka shumë të saktë. Instikti i mjafton kafshës, vetëm sa për nevojat e veta.

Për sa u përket kafshëve, gjithashtu, shohim se ato nuk kanë marrëdhënie shoqëruese me kafshët e tjera dhe se ato kujdesen për ruajtjen e llojit të vet. Kur kafsha femër mbarësohet, ajo nuk lejon që kafsha mashkull t'i afrohet përsëri. Por, ata që e kanë mohuar All-llahun, ata janë cilësuar si më të këqij, se kafsha.

Ata janë më të këqij se kafsha, për arsye se kafshët nuk logjikojnë. Ato (kafshët) i kanë detyrat e tyre në këtë botë, dhe edhe pse nuk logjikojnë, ato, megjithatë, i kryejnë detyrat e tyre me përpikëri. Ato bartin pesha të rënda, i japin ato (të mira dhe begati) për të cilat janë krijuar dhe kryejnë gjithçka ju kërkohet (që është brenda natyrës dhe mundësisë së tyre).

Ndërsa njeriu, të cilit All-llahu i ka dhënë lirinë e zgjedhjes, edhe pse e ka mbushur stomakun dhe është i ngopur, mendja e vet i thotë se: duhet t'a provosh edhe këtë

⁹³ Kur'an, 4 / 48

⁹⁴ Kur'an, 8 / 55

⁹⁵ Kur'ani flet për dabetul erd (autori e ka fjalën për dabe- kafshët, por këtu, fjala 'kafshë' ka kuptimin e të gjitha gjallesave që lëvizin, me përjashtim të njeriut. Shënim i përkthyesit)

ëmbëlsirë, ose shijoje edhe këtë lloj ushqimi tjetër. Ai nuk i kushton aspak kujdes faktit se All-llahu i ka urdhëruar njerëzit, që të përmbahen prej të tepruarit në ngrënie, por, përkundrazi, ha tepër dhe e rëndon stomakun aq shumë, saqë nuk mund të lëvizë dot nga vendi. Ndërsa seksin e shndërron në prostitucion, dhe nuk interesohet fare për ruajtjen e dinjitetit dhe të vazhdimësisë së llojit të vet.

All-llahu njeriun e dalloi me mendje. Atij i mundësoi që t'i shohë dhe t'i shqyrtojë argumentet në univers, dhe të besojë se ky univers ka Krijuesin e vet. Por fatkeqësisht, në vend të kësaj, ai abuzon me këtë të mirë (mendjen) që All-llahu i ka dhuruar, dhe e mohon All-llahun xh.sh. Pra, ai bëhet ateist, dhe vazhdimisht largohet prej All-llahut të Lartëmadhëruar. Gjeneratë pas gjenerate, ky mëkat vazhdon të trashëgohet. Si duket, ai (njeriu) e ka shlyer veçorinë e tij më të rëndësishme (përdorimin e mendjes), që All-llahu ia ka dhuruar njeriut. Por jo vetëm kaq, por ai e përdor atë, për të vepruar kundër obligimit që ka, dhe me këtë e poshtëron vetveten në nivelin e një gjendjeje jonjerëzore, madje në një nivel më të ulët se atë të kafshës.

Për t'a përbyllur, në vija të përgjithshme, do të themi: Kuptimi i vërtetë i fjalës 'hajr' dhe 'sherr' në këtë botë dhe në ahiret, nga pikëpamja e fesë, është: vepër e mirë, është ajo e cila ka për qëllim kënaqësinë e All-llahut dhe për të cilën njeriu shpreson se do të shpërblehet në ahiret. Përveç kësaj, njeriu duhet t'a dijë, se çdo gjë që vjen prej All-llahut xh.sh. është hajr, dhe çdo gjë, që bëhet për hir të All-llahut, është e mirë – hajr.

Ndërsa, sherri, në universin tonë, ka ardhur prej sjelljeve të vetë njeriut. Ai me të, po e shkatërron universin dhe jetën e vet. Ai është duke i shkatërruar ligjet, në emër të së "mirës", ndërsa e vërteta është se ai është duke e shkatërruar botën. All-llahu xh.sh. na ka mundësuar shumë gjëra të dobishme dhe begati të shumta, por ja që, ne jemi duke i shkatërruar ato dhe po ia kundërvëmë qenies sonë njerëzore. Njeriu është duke vuajtur nga zgjedhjet e gabuara të tij. Kjo botë është e bollshme dhe e mjaftueshme për të gjitha krijesat që ka krijuar All-llahu, që prej Ademit a.s., e deri në Ditën e Fundit. Por, fatkeqësisht, egoizmi është duke u bërë shkatërruesi i çdo sendi. Kjo ka bërë që disa njerëz t'i shkatërrojnë të mirat e Zotit, në vend se t'ua jepnin atyre, që kanë nevojë urgjente për to.

Kjo botë është rruga, nëpërmjet së cilës fitohet ahireti. Me të, ose shkohet në xhennet, ose në xhehennem (All-llahu na ruajtë prej tij). Kur njeriu në këtë botë, devijon nga detyra e vet, dhe vlerat i konsideron antivlera, ndërsa antivlerat vlera, atëherë këto cilësi trashëgohen duke sjellë çregullime, mjerim dhe shkatërrim të forcës mendore dhe të logjikës njerëzore, gjë që sjell hidhërimin e Zotit mbi të, dhe në fund, njeriu nuk do të fitojë asgjë prej kësaj bote.

E mira është në atë, që All-llahu e ka pëlqyer për ne. Njeriu nuk posedon dituri të gjerë, e as njohje të përgjithshme, që të bëhet gjykatës i ndodhive të veta, sepse ai nuk është në dijeni të së ardhmes së tij, në mënyrë që të dijë dhe të gjykojë rezultatin e ngjarjes së sotme.

Urrejtja ndaj disa gjërave, nuk duhet të bëjë që të ngutemi dhe të japim konkludimin përfundimtar se ato (ndodhi apo sende) janë të dëmshme për ne, për shkak se ne e urrejmë ato. Ato mund të kenë mirësi të shumta, të cilat janë të panjohura për ne. Dhe mund të ndodhë, që ne ta duam një send, por realiteti i tij, të jetë i hidhur dhe i keq për ne.

Nëse ne duam lumturinë e kësaj bote dhe të botës tjetër, patjetër duhet të pëlqejmë atë, që All-llahu i Lartëmadhëruar ka caktuar për ne, sepse caktimi (kaderi) i All-llahut, gjithmonë, është i mirë. Ai, i cili pajtohet me të, është i udhëzuar në rrugën e drejtë.

Falendrim

E falënderoj All-llahun xh.sh, i Cili më mundësoi që t'a përfundoj përkthimin e këtij libri të çmuar. Shpresoj se, ky libër, do të jetë një ndihmesë e madhe për popullin tonë, që t'a kuptojë më qartë dhe më bindshëm fenë e vet islame.

E lus All-llahun e Lartëmadhëruar që të më ndihmojë mua dhe të gjithëve juve, që të jemi modestë. Mundin e përkthimit të këtij libri ia dedikoj së pari All-llahu xh.sh. që më dhuroi mendjen dhe shëndetin, pastaj babait tim i cili më la pasuri për të mos u preokupuar shumë me ekzistencën dhe së fundi nënës sime të shtrenjtë e cila vazhdimisht lutet për të gjithë, por gjithashtu edhe për mua.

Dubaj: 22 janar 2005

Përmbajtja

Kapitulli i parë

1. E bukura në univers
2. Në fillim ishte natyrshmëria
3. Ç'kuptojmë me fjalën zhvillim
4. Ç'kuptim ka fjala Halif
5. Sekreti i së bukurës në univers

Kapitulli i dytë

6. E shëmtuara në univers
7. Bota e shfrenuar kryen detyrën e vet
8. Mungesa e mendjes së njeriut
9. Programi ka zbritur me Ademin
10. Mëkati nuk u ndërpe

11. Muhammedi a.s.- mëshirë për besimtarët dhe mosbesimtarët

Kapitulli i tretë

- 12. I supozuari dhe i drejti
- 13. Jeta e vërtetë
- 14. Shkaqet e largimit të begative
- 15. Pasuria është punësim në jetë
- 16. Pasuria dhe shoqëria janë begati apo sprovë?

Kapitulli i katërt

- 17. Çfarë është ‘e mirë’ dhe çfarë ‘e keqe’
- 18. E mira absolute
- 19. Njeriu dhe ngjarjet në univers
- 20. Ambiciet për pasuri të mirë

Kapitulli i pestë

- 21. Shkatërruesit në tokë
- 22. Gjërat që mendja s’i kupton
- 23. Personat me aftësi të kufizuar a konsiderohen sherr – e keqe
- 24. Fillimi i mohimit
- 25. Urtësia tek abnormalët

Kapitulli i gjashtë

- 26. E mira dhe e keqja në ahiret
- 27. Imani është kusht për t’u pranuar veprat.....
- 28. E keqja dhe ngacmimet njerëzore.....
- 29. Kulmi i të këqijave në këtë botë është mosbesimi.....

Muhamed Mutevel-li al Sharavi
E mira dhe e keqja

Redaktore gjuhësore:

Mimoza Sinani

Korrektor:
Muhamed Jusufi

Përgaditja kompjuterike
.....

Botimi parë

Botoi:

Shoqata Kulturore “Zëri Ynë” – Prishtinë
Rr. 19 Bulevardi i Dëshmorëve D1-III-1 – Prishtinë
Tel: ++381 38 228 414, ++377 44 144476
Email: kajolli5@hotmail.com
www.albanur.net

Shtypi:
“Mozaiku”
++377 44 300 205

Për Kopertinën e pasme

Libraria Islame – Sharaviu

I dashur lexues,

Këtë libër...

U nxorr prej vjeljeve tona të njëpasnjëshme prej Hirësisë së tij, imamit dhe akademikut Muhammed Muteveli Sharavi, i cili shkrepri inspirime të reja, të cilat po e shndrisin edhe më shumë rrugën e të udhëzuarve, po i udhëzojnë të hamendurit dhe po e pasurojnë mbarë njerëzimin me dituri dhe njohuri fetare, të cilat i kishte mbuluar pluhuri.

Vërtet, “Libraria Islame – Sharaviu” është njëra prej atyre, që ua jep këtë mundësi, pasi pasohet me botimet e “Shoqatës- Informacione të Përditshme”. Kjo shoqatë ka botuar një sërë librash, që kanë të bëjnë me prezantimin dhe sqarimin e shumë pyetjeve, ndaj çështjeve të ndryshme fetare, që janë shumë të rëndësishme për secilin musliman dhe muslimane. Këto libra iu hapin, atyre, sytë dhe iu japin vizione të reja.

Ky libër është i mbushur përplot mirësi, që rrezatojnë prej kryeimamit të thirrësve. Kjo mirësi përcillet me një gjuhë, e cila del nga imani i tij i thellë dhe nga frymëmarrjet e zemrës së pastër. Ai shndërrit rrugën për të udhëzuarit, dhe ndriçon shtegun për të hamendurit dhe për të humburit.